Në vetëvete, në shumicën e rasteve, gripi nuk është sëmund rendë, por merr karakter shumë serioz për shëndetin e popullit here kur nuk ndiqet dhe nuk mjekohet si duhet. Kjo ndodh për të ndërlikimeve të ndryshme, që mund të ngjasin si gjatë risë të vëtë gripit ashtu dhe pas kalimit të tij. Ndërlifikimet të shpeshta janë ato bronkopneumonike për të cilat folëm më lart, ndërlifikimet e tjera serioze duhen përmëndur nefropatitë, otitet, encef për fat të mirë i rrallë etj. Në rastet të studjuar prej nesh, ndërlifikat përfundojnë me shpërndarë siç shihet në pasqyrën nr. 7.

Pasqyra †

Epidemi e vitit	Nefropati	Encefalit	Meningizëm	Psikoreak
1970	13(16,7%)	1(1,2%)	—	—
1972-1973	6(15,7%)	—	—	—
1974	1(2,5%)	—	1(2,5%)	—
1975	—	—	—	—
1975-1976	3(5,1%)	—	—	1(1,6%)

Nga të shtruarit në spitalin klinik nr. 1 Tiranë (2) rezulton se epideminë e gripit 1969-1970, nefropatitë u vunë re në 17% të rasteve ndërsa në atë të viteve 1972-1973 (8) në spitalin ushtarak, nefropatitë u hasën në 4,8%, të rasteve.

Përsa u përket ndërlikimeve të sistemit nervor, ka autorë (3) mendojnë se gjatë epidemisë së gripit në një përqindje të të sëmi dukën manifestime nga një herë të rënda dhe vdekjeprurëse të encefaliti apo meningo-encefaliti. Mendohet se këto janë rezultat i anëve dhe i kongestionit të provokuar nga ndërlifikimet bronkopulmonare autorë të tjerë (4) mendojnë se këto ndërlikime janë rezultat një superinfeksioni të ndodhur gjatë gripit, meqë virusi frenon me kanizma ende të panjohura mirë fagocitozën. Të tre ndërlikimet takuar prej nesh u vunë re në të sëmurët me pneumoni.

FORMAT E PNEUMONIVE SIPAS RËNDIMIT TË SËMUNDJES

Rëndimi i sëmundjes së pneumopative gripale ka qënë i ndryshme nga viti në vit dhe kjo sigurisht në vartësi të virulencës së shtamës dëshmi të një seri faktorësh të tjerë, siç janë: mosha, sëmundjet e tjave mëparshme, mjekimi paraprak i gripit, koha e shtrimit etj.

Në epideminë e gripit 1970 u vunë re 16 raste formash të rinë atë të vitit 1972-1973 - 5 raste, në epideminë e vitit 1974 u 7 raste, në të vitit 1975 u panë 3 raste dëshmi së fundi në atë të vitit 1975-1976 në 15 raste. Në pneumopatitë e vitit 1970 patëm një vjeçë të sëmurë me stenozë mitrale dëshmi së fundi, në vitin 1972-1973 një vjeçë me fibrilacion atrial, në vitin 1975-1976 një vjeçë të sëmurë me insuficencë të ventrit të majtë.

Të sëmurët me pneumopati të epidemive gripale të shtruar gjatë viteve 1970-1976 21

PNEUMOPATITË NË SËMUNDJET KRONIKE

Në shumicën e rasteve, infekzioni gripal kalon mjaft lehtë, por ai është i frikshëm për ndërlifikimet e rënda që mund të shkaktoj në persona me sëmundje të tjera kronike, veçanërisht ato të sistemit kardiovaskular dëshmi të respirator. Në këtë drejtim, në radhë të parë, janë ndërlifikimet bronkopulmonare, të cilat edhe pse në formë të lehta, mund të janë vdekjeprurëse. Në e kemi ndjekur këtë problem dëshmi, përfat të mirë, vëmëre se me përjashtim të rastit me afeksion mitral, rastet e tjera kanë kaluar mjaft mirë. Në pasqyrën nr. 8 jepen pneumopatitë në të sëmurë kronikë.

Pasqyra nr. 8

Sëmundja kronike	Rastet sipas viteve				
	1970	1972-1973	1974	1975	1975-1976
Tuberkulozë	1(1,3%)	1(3,6%)	—	—	6(10,1%)
Cor pulmonar	10(12,9%)	6(15,8%)	1(2,5%)	—	8(13,5%)
Kardiosklerozë	12(15,5%)	4(10,5%)	2(5,1%)	3(11,1%)	—
Nefropati	1(1,3%)	2(5,2%)	2(5,1%)	1(3,7%)	—
Kardio. reumat.	1(1,3%)	1(2,6%)	—	—	1(1,7%)
Azëm bronkiale	1(1,3%)	—	—	—	—

TERAPIA

Për mjekimin e ndërlikimeve bronkopulmohare të gripit, terapia përdorur ka qënë e gjërë. Në radhë të parë janë përdorur antibiotikë të ndryshëm, qoftë të veçuar qoftë të kombinuar. Zgjatja e terapisë ka të ndryshëm, qoftë të veçuar qoftë të kombinuar. Përsëri përdorimit të kombinimeve të ndryshme qënë e ndryshme. Përsëri përdorimit të tijera si dëshmi të kohëve të antibiotikëve dëshmi të medikamenteve të ndryshme të përdorimit të tyre, nuk mund të japim një skemë të gjithë vlefshme, por dëshmi të kufizohëmi rië të dhëna të përgjithshme, duke u munduar të nxjerrim në pah kombinimet më efikase. Në vija të përgjithshme, kombinimi më i shpeshtë ka qënë penicilinë-streptomycinë, ndërsa në raste të tijera janë përdorur edhe tetraciklinë, eritromicinë dherëve, penicilina 29,9%, eritromicina 2,5% dherëve, kombinime antibiotikësh 54,5% të sëmurëve. Deltakorteni 11,6% të sëmurëve. Në epideminë e vitit 1970, penicilina 13,1% të sëmurëve, tetraciklina 7,8%, eritromicina 2,6% dherëve, kombinimet 76,3%. Deltakorteni 2,6% përdorur 1974, penicilina 12,8% të sëmurëve, tetraciklina 23,77%, eritromicina 20,5% dherëve, kombinimet 43,5% të sëmurëve. Deltakorteni 2,5% të sëmurëve. Në epideminë e vitit 1975, penicilina 7,4%, tetraciklina 33,3%, eritromicina 7,4%, rovamicina 7,4%, dherëve, kombinime antibiotikësh 44,4%. Në epideminë e vitit 1975-1976 penicilina 5,1% të sëmurëve, streptomycinë 2,1%.

1,7%, tetraciklina në 18,4% dhe kombinimet e antibiotikëve në 7 Deltakorteni u përdor në 3,4% të të sëmurëve.

Përdorimi i antibiotikëve u bë pér kohë të ndryshme, duke parasysh si shërimin klinik ashtu dhe atë radiologjik. Duke stu reagimin e të sëmurëve me pneumopati gripale kundrejt terapisë biotike të përdorur mund të vëmë në dukje se efektin më të mirë pasur tetraciklina në këto përqindje:

Në epidemini e vitit 1970 në 42,8% të të sëmurëve, në atë të 1972-1973 në 34,2%, në të vitit 1975 në 51,9%, në të viteve 1975-1976 28,8% dhe në epidemini e vitit 1974 efektin më të mirë e ka pasur e micina në 30,7% të të sëmurëve dhe pastaj tetraciklina në 23,07% sëmurëve.

PERFUNDIME:

1) Epidemia e gripit të vitit 1970 ka qënë më virulente dhe, s'dhim, edhe të sëmurët me pneumopati të shtruar në spital, në këtë kanë qënë në përqindje më të lartë dhe me kuadër kliniko-laboratori-radiologjik më të rëndë.

2) Në epidemini e gripit të vitit 1970 u vu re një mbizotërim i pneumopative në qytet me 70,1%, ndërsa në epidemitë e tjera, raporti i-fshat ishte i përafertë.

3) Marrja e masave paraprake dhe mjekimi racional ka bërë të ndur që pneumopatitë të janë në një përqindje përkrahësish të vogla krasim me kontigjentin e populatës së prekur nga gripi dhe shëmëria të jetë shumë e ulët.

4) Në sajë të trajtimit racional, ndërlikimet e pneumopative gjanë qënë fare të ulta. U vunë re 4 raste absedimi. Si një nga ndëmet më të rënda, encefaliti u vu re vetëm në një i sëmurë, që përfshirë shërim.

5) Në trajtimin e pneumopative, në përqindjen më të madhe përdorur kombinimet pas përdorimit të vecuar të një antibioticu.

6) Tetraciklina është treguar si një nga antibiotikët më efikasë 28,8% deri në 51,9% të të sëmurëve nga njëra epidemi në tjetren

Dorëzuar në Redaksi më 10 shkurt

BIBLIOGRAFIA

- 1) Adhami J.: Sëmundjet e aparatit të frysëmarrjes. Traktati i sëmundj brendshme. Tiranë 1974, vol. I, fq. 434.
- 2) Adhami J.: Të sëmurët me komplikacione gripi nga virus A₂, Hong-Kong shtruar në spitalin nr. 1 gjatë epidemisë 1970. Buletini i UT — Seria i shkencave mjekësore 1972, 1, 15.
- 3) Colonello F., Signorini C.: Studio eziologico delle nevrasiti in corso di infezione da virus A₂ Hong-Kong, con isolamento del virus dal liquore e dall'encefalo nelle malattie infettive e parassitarie 1970, 22, 9, 612.
- 4) Calonghi G. F. et al.: Isolamenti di virus influenzale A₂, Hong-Kong dal liquore cerebrale di due pazienti affetti da meningoencefalite. Giornale di medicina infettive e parassitarie 1970, 22, 9, 620.
- 5) Meli H.: Komplikacionet pulmonare të gripit nëntor 72 — janar 73. Buletini i K.M.U. 1973, 3, 55.

Të sëmurët me pneumopati të epidemive gripale të shtruar gjatë viteve 1970-1976 23

- 6) Miti L. e bp.: Fisiopatologia e clinica delle infezioni dell'apparato respiratorio. Minerva Medica 1976, 67, 22, 1436.
- 7) Ndroqi Sh.: Mbi pneumopatitë atipike. Buletini post Universitar i Ministrisë së Shëndetësisë 1969, 1, 1.
- 8) Nova I.: Bronkopneumonitë gripale në spitalin e Lushnjës gjatë epidemisë së vitit 1972-1973. Buletini i UT — Seria shkencat mjekësore 1976, 2, 135.
- 9) Shulcav G. P.: Pneumonia dhe komplikacionet renale gjatë gripit të janarit 1975 (Përkthim). Klin. Medicina 1975, 12, 23.

Summary

PATIENTS WITH PNEUMOPATHY DUE TO INFUENZA DURING THE EPIDEMICS OF 1970-1976.

The paper describes the cases of pneumopathy observed during the period between 1970 and 1976. In the course of five epidemics of influenza, 240 patients with pneumopathy were admitted to the district hospital of Kruja. After a detailed clinical and laboratory investigation, the author finds that the highest frequency of pneumopathy occurred in 1970 and coincided with the most virulent epidemic of influenza. Three of the cases of that epidemic developed lung abscesses and one encephalitis, while of the other epidemic only one case of lung abscess was observed in 1974.

The paper finds also that of antibiotics used, the most efficient was tetracycline, which in the different epidemics was used in 28.8 to 51.9 percent of the cases.

It is pointed out also that early adequate treatment of influenza has brought a significant reduction in the incidence of pneumopathy among the population affected by influenza.

Other questions discussed in the paper include the incidence of pneumopathy, the clinical and laboratory examinations, the radiological findings, the complications in the various systems other than the lungs, pneumopathy in chronic diseases, the treatment and its results.

Résumé

A PROPOS DES PNEUMONIES PROVOQUÉES PAR LES ÉPIDÉMIES DE GRIPPE DES ANNÉES 1970-1976

Dans cette communication l'auteur décrit divers cas de pneumonies provoquées par les épidémies de grippe des années 1970-1976. Au cours de ces cinq épidémies 240 patients souffrant de pneumonies ont été admis à l'hôpital de Kruje. Après l'étude clinique et de laboratoire de ces cas, il a été relevé que la plus haute fréquence des pneumonies se rapportait à l'épidémie de 1970, qui a été aussi la plus virulente. Au cours de cette épidémie, l'auteur n'a constaté que 3 cas d'abcès pulmonaires et un seul cas d'encéphalite, alors que durant les autres épidémies de grippe il n'a observé qu'un cas d'abcès pulmonaire en 1974.

Par ailleurs, l'auteur relève que l'antibiotique le plus efficace a été la tétracycline, qui fut employée dans 28.8-51.9% des cas. Le traitement immédiat et rational des malades influe positivement sur l'incidence de la pneumonie parmi la population atteinte de grippe.



Foto 1. — I sëmuri I. M. me pneumoni centrale të djathtë. Radiografia e datës 31 janar 1970. Hije masive, e pakufizuar, e paqartë. Zona supraklavikulare e lirë.



Foto 2. — I sëmuri I. M. Zona apikale dhe bazale e pulmonit djathtë e pastërt. Në lobin e mesëm shihet një hije me madhësi sa një ftua, intensive, me konture të qarta.



Foto 3. — I sëmuri S. B. me pneumoni lobi superior të djathtë. Radiografia e datës 26 janar 1970. Në lobin superior

të djathtë shihet një sa një ftua me kont poshtëm të rrumbulla qartë, intensiv, jo gjen.



Foto 4. — Radiografia e datës 2 1970. Në lobin superdjathtë shihet një pulmonar i eskavuar.



Foto 5. — I sëmuri M. G. Abces monar i zhvilluar nga pneumoni bazale sinist cor pulmonale kronik. Diografia e datës 10 q 1974 tregon abces në dhësi 6×6 cm. pa likuidi.

TROMBEMBOLIZMI PULMONAR

(Studim i nekropsive të viteve 1957-1973)

— Doc. ÇESK RROKU — ENGJELL TELEGRAFI —

Trombembolizmi pulmonar përbën një nga problemet e shumta bashkëkohore të mjekësisë për shpeshtësinë, ndërlikimet e rënda shpesh vdekjeprurëse, si dhe për disa aspekte të parandalimit dhe mjekimit të tij. Nga trombembolia pulmonare çdo vit në SHBA vdesin 50.000 vetë (8). Sipas po këtij autori, trombembolizmi pulmonar është gjetur në 25% të rasteve në nekropsitë e kujdeshme, por jo vetëm si shkak vdekje. Në një studim të materialit nekropsik, trombembolizmin pulmonar vdekjeprurës, autorë të tjerë (5) e kanë gjetur në 3.52% në persona mbi 20 vjeç. Një autor (cituar nga 7) trombembolitë i ka gjetur në 2,11% të rasteve të nënshtruara nekropsisë, nga të cilat 1,96% si shkak vdekje.

Studimi i trombembolive pulmonare lidhet ngushtë me përcaktimin e zanafilës së embolive, me përcaktimin e sëmundjes bazë, që mbart me vete faktorin e rrezikut, që nëpërmet mekanizmave të ndryshme, nganjëherë shumë të ndërlikuara, çonjë në formimin e trombit dhe rrjedhimet e tij, si dhe me shpeshtësinë. Paraqitura e materialit të studjuar prej nesh ka për qëllim të jepë një kontribut në disa nga këto probleme.

Punimi që po paraqitim eshtë nxjerrë nga analizimi i nekropsive të viteve 1957-1973, të kryera pranë Shërbimit të Anatomisë Patologjike të spitaleve Tiranë. Materiali përfshin nekropsitë e të gjitha shërbimeve, ndërsa të shërbimit kirurgjikal vetëm për vitet 1957-1959 dhe të vitit 1973.

Shpeshtësia. — Gjatë viteve 1957-1973 u kryen 4942 nekropsi, ndërmjet të cilave u gjetën 184 raste me trombemboli pulmonare, që përbëjnë 3,73% të të gjithë rasteve. Në 94 raste, trombembolia pulmonare ka qënë vdekjeprurëse, që përbëjnë 52,7% të rasteve me trombemboli dhe 1,96% të të gjithë shkaqeve të vdekjeve.

Mosha, sëmundshmëria dhe vdekshmëria. — Në grafikët 1 dhe 2 jepen sëmundshmëria dhe vdekshmëria në funksion të grup-moshave.

Siq shihet në grafikun nr. 2, vdekshmëria fillon ngritjen e saj të theksuar, ashtu si dhe sëmundshmëria, pas moshës 40 vjeçare. Nga mosa 0-40 vjeç janë vetëm 27 raste, ndërsa mbi 40 vjeç janë 70. Numri i trombembolive vdekjeprurëse rezulton të jetë 97. Po nga grafiku del se numri më i madh i vdekjeve nga trombembolitë ka qënë në grup-moshën 60-70 vjeç në 30 raste (30,9%), kurse mbi moshën 70 vjeç, vdekshmëria bie, po ashtu si dhe numri i rasteve me trombemboli.

Duke bërë lidhjen ndërmjet grup-moshave dhe sëmundjes bazë, ai i grup-moshave mund të ndahet në 4 intervale në funksion të sëmundjes bazë:

Në intervalin e parë, 0-10 vjeç, 3 raste kanë pasur si sëmundje bazë bronkopneumoninë dhe një rast sepsis.

Në intervalin e dytë, 11-40 vjeç, vërehen 23 raste me endokardit kronik postreumatizmal, 9 raste me sëmundje infektivo-septike, 4 me zemër mushkërore kronike, 3 raste me sëmundje psikike, 3 më procese

malinje (2 leucemi dhe një karcinomë) dhe nga një rast me pernodoz, gjendje postoperatorre dhe bronkektazi.

Ngjitja që pëson grafiku në intervalin 11-40 vjeç shkaktohe endokarditi postreumatizmal kronik. Në grup-moshën 21-30 vjeç, sia e femrave shpjegohet me numrin më të madh të tyre me endo dhe sëmundje infektivo-septike (2 aborte septike).

Në intervalin e tretë, 41-70 vjeç, kemi pasur 33 raste me mushkërore kronike, 22 me endokardit postreumatizmal kronik, 1 ste me procese malinje, 15 me miokardiosklerozë aterosklerotikë miokardiopati të tjera dhe infarkt miokardi, 9 raste me sëmundje infektivo-septike, 6 me sëmundje të SNQ, 4 raste me pneumopati, 2 me sëmundje renale, 2 me gjendje postoperatorre dhe me nga një raste të trombotike, pelagra, periarteriti nodoz dhe vena varrikoze. Në interval mbizotërojnë rastet me zemër mushkërore mbi endoka kronik postreumatizmal, por si total sëmundjet e aparatit kardiovaskular përbëjnë 38 raste, që edhe në këtë interval zënë vendin e parë. Sia e meshkujve në grup-moshën 61-70 vjeç shpjegohet me numri të madh të meshkujve me zemër mushkërore dhe me procese më. Po kështu shpjegohet edhe epërsia e meshkujve ndaj femrave gjithë intervalin 41-70 vjeç, që është 61 meshkuj dhe 57 femra.

Në intervalin e katërtë, mbi 70 vjeç, vërehen 8 raste me miokardiosklerozë aterosklerotike, 3 me zemër mushkërore kronike, 2 me sëmundje të SNQ, 3 me procese malinje, një me pneumopati akute dhe një mboflebit. Gati gjysma e rasteve u përkasin rrjedhimeve të aterosklerozës, ndërsa raporti mashkull/femër është i përafertë 8:10. Në interval vërejmë gjithashtu edhe rënien e shpeshtësisë së trombeve në përgjithësi, sepse sëmundjet bazë, që japid më shpesh mbemboli, si sëmundjet e aparatit kardiovaskular dhe atij të farrues, janë më të rralla.

Origjina e trombit. — Vendi i lokalizimit parësor të trombit, që bëre burim i trombembolisë, është gjetur në 94 raste. Në pasqyrën paraqiten vendet e burimeve të gjetura.

Pasqyra

Origjina e trombit	Nr. i rasteve	Përqindje
Zemra e djathë	47	50%
Plekset venoze periprostatike, perivesikale dhe periuterine	21	22,3%
Të kombinuara	12	17,7%
Venat e anësive të poshtme	6	6,3%
Vena kava inferior	2	2,1%
Venat e mëdha të pelvisit	2	2,1%
Arteriet pulmonare	2	2,1%
Venat jugulare	1	1,06%
Venat e murit të barkut	1	1,06%
S h u m a	94	100%

Shpërndarja e embolive. — Në pasqyrën nr. 2 jetet shpërndarja e trombembolive në pemën arteriale pulmonare në rastet kur nuk kanë pasur kohë dhe kushte të favorshme për të dhënë infarkt pulmonar. Nga pasqyra rezulton se raste të tilla janë 38 (20,6%), nga të cilët nga trombembolia kanë vdekur 28 (15,2%).

Pasqyra nr. 2

Lokalizimi i embolit	nr. i rasteve	shkak vdekje
Trungu i arteries pulmonare	3	3
Tromb kalorës	2	2
Arteria pulmonare e djathë	7	4
Trungu i arteries pulmonare të djathë	3	2
Degët e lobit të sipërmë	1	—
Degët e lobit të mesém	1	1
Degët e lobit të poshtëm	2	1
Arteria pulmonare e majtë	7	4
Trungu i arteries pulmonare të majtë	4	3
Degët e lobit të sipërmë	1	—
Degët e lobit të poshtëm	2	1
Arteriet pulmonare bilaterale	19	15
Degët ekstrapulmonare	11	11
Degët intrapulmonare	8	4
S h u m a	38	28

Lokalizimi dhe madhësia e infarktit. — Në pasqyrën nr. 3 janë paraqitur të dhënat e madhësisë së infarktit. Si infarkte të vegjël kemi konsideruar ato me përmasa nën 3 x 3 cm, mesatare ato deri në 5 x 5 cm dhe të mëdhenj ato mbi këto përmasa. Përcaktimi i përmasave është bërë në mënyrë arbitrale.

Pasqyra nr. 3

Lokalizimi i infarktit	Masiv	Shkak vdekje	Mesatar	Shkak vdekje	i vogël	shkak vdekje
Mushkëria e djathë	26	18	20	4	9	—
Mushkëria e majtë	9	6	11	2	10	—
Bilaterale	28	28	17	7	16	5
S h u m a	63	52	48	13	35	5

Pasojet lokale të infarktit. — Në infarktet pulmonare të materialit tonë janë vërejtur 36 raste me ndryshime lokale. Nga këto: 7 raste me reaksion fibrinöz mbi infarkt, 4 me organizm të infarktit, zbutje e infarktit në një rast, 9 raste me pneumoni në terren të infarktit, 11 raste abscedimi dhe 2 raste me gangrenizm të infarktit.

DISKUTIM

Në formimin e trombit në ndonjë nga venat dhe që e kërçnjeriun me trombemboli pulmonare me të gjitha rrjedhimet e kontribuojnë kaq shumë faktorë ndërveprues saqë ndoshta në kol sotme është ende e pamundur një ndarje e përpiktë ndërmjet të sëi me një rrezikshmëri të lartë për trombozë dhe atij në të cilin depoz i fibrinës në venat e mëdha ka filluar tashmë.

Përveç faktorëve kryesorë, pra faktorëve bazë të rrezikut të mbozës, të dhënat që konsistonjë në ngadalësimin e qarkullimit të kut, dëmtimin e pareteve të vazave dhe rritjen e koagibilitetit të g. (triada e Virchow), ekzistojnë edhe një seri faktorësh, të tjerë të zikut për të bërë trombozë (2, 6). Këta faktorë veprojnë në tërësi sémundjes bazë, të cilat lozin gjithnjë rolin kryesor (5, 6, 8). Mëndësishmit janë: mosha, imobilizimi dhe regjimi i zgjatur i qënd në shtrat, trombembolizmi i mëparshëm venoz, pamjaftueshmëria riale, ajo e zemrës, shoku, sepsis grammnegativ, traumat, proceset linje, inflamacioni i venave dhe ndryshime të tjera të enëve të g. policitemia, kontraceptivët, shtatzënia, grupet e gjakut, përdorimi i e gjenieve dhe i digitalikëve, dhjamosja e tepertë (obeziteti) etj. (2,


Kryesoria, ajo që na orienton më mirë mbi rrezikun e bërë trombozës dhe përkrahësish të trombembolisë, është sémundja bazë, dihet, nga përvuja e gjatë mjekësore, se trombozat ngjasin më sh me sémundjet kongjesteive të zemrës, sémundjet e venave, në infaku të miokardit dhe në proceset malinje (1, 2, 3, 5).

Në materialin tonë, të përbërë nga 4942 nekropsi, u gjetën 184 me trombemboli pulmonare ($3,75\%$). Në burimet e literaturës së sultuar, shpeshtësia e trombembolive pulmonare jepet në përqindje ndryshme dhe kjo edhe në vartësi të faktit se me çfarë materiali ë punuar, me material thjeshtë kirurgjikal, të sémundjeve të brends apo material të përzjerë. Kështu autorë të ndryshëm (cituar nga duke punuar me material me prejardhje të ndryshme, përqindjen e mbembolive e japid në $2,11\%$, përqindje kjo e përafertë me at nxjerrë prej nesh. Autorë të tjerë (6) këtë përqindje me material kropsik të përzjerë mbi moshën 20 vjeçare e japid në $3,52\%$.


Në grafikun nr. 1 të materialit tonë, ku jepet sémundshmëria vartësi të moshës, vihet re se dukuritë trombembolitike janë më shpeshta në moshat e rritura, veçanërisht pas 40 vjetëve.

Nga 184 raste trombembolia ka qënë shkak kryesor i vdekjes 97 të sémurë ose $52,6\%$. Duke analizuar grafikun nr. 2, rezultoi vdekshmëria më e lartë është gjetur në grup-moshën 60-70 vjeç $29,9\%$ të rasteve. Një autor (5) vdekshmërinë më e lartë e ka gjitë në grup-moshën 51-60 vjeç me $63,5\%$ të rasteve. Gjithnjë sipas graf nr. 2, në materialin tonë rezulton se vdekshmëria më e lartë nga mbembolia është hasur mbi moshën 40 vjeçare me $72,1\%$. Siguri që kjo vdekshmëri e lartë është e lidhur ngushtë me faktorë të noshëm, por kryesisht me sémundjen bazë, pasi kryesisht kësaj mos përket shumicë e sémundjeve kongjesteive të zemrës, që përbëjnë re vuarin kryesor të trombembolive, si dhe proceset malinje. Në një shtrim përgjithësues të sémundjeve bazë vemë re se sémundjet e sëmit kardiovaskular zënë vendin e parë me 74 raste, ku endokarditi

**TABELA Nr 1
SEMUNDSHMËRIA**



**TABELA Nr 2
VDEKSHMËRIA**



nik postraumatizmal (veseve reumatizmale të zemrës) i takojnë 45. Vendi i dytë u përket sëmundjeve të aparatit të frysëmarrjes me ste, ku vetëm zemrës mushkërore kronike i përkasin 40 raste. I tretë përbëhet nga procese malinje, ndër të cilët karcinoma br gjene me 8 raste, karcinoma e stomakut 5, ato të mëlcisë 4 dhe m një rast karcinoma e ovareve, pankreasit, osteosarkoma dhe tumori malinj. Në 3 raste me procese malinje (karcinomë bronkogjene, e kreasin dhe e mëlcisë) u gjetën tromboza të përgjithësuara, pra një tezë trombotike. Vendin e katërtë e zenë sëmundjet infektivo-septil 16 raste, nga të cilët 13 u përkasin septikopiemive dhe aborteve se.

Një përgjithësim tjetër është ai se femrat mbizotërojnë me end ditin postreumatizmal dhe miokardiosklerozën aterosklerotike, sëmu infektivo-septike dhe ato të SNQ, ndërsa meshkujt me zemrën mure kronike, infarktin e miokardit dhe proceset malinj.

Në 184 rastet me trombemboli, 93 ishin meshkuj dhe 91 femra het qartë se nuk ka asnjë ndryshim të dukshëm si total ndëri gjinisë.

Ndryshimi më i madh vihet re në grup-moshën 60-70 ku mbizotëru meshkujve shkaktohet nga zemra mushkërore kronike. Femrat zotërojnë në grup-moshën 20-30 vjeçë për arsyen të shpeshtësisë n madhe, ndër to të veseve reumatizmale të zemrës. Nga 97 rasi vdekur nga trombembolia, 55 janë meshkuj dhe 42 femra. Disa ai (4, 5) jepnë mbizotërim të gjinisë femërore. Ata e shpjegojnë me përdorimin e gjirë të antikonceptive në vendet kapitalistizante, që, sipas tyre, vendimtar është shtimi i kontributit të gjemërore në trombembolimin pulmonar. Përvendin tonë një dukuri llë as që mund të mirret fare në konsideratë, pasi përdorimi i prek teve të tilla bëhet vetëm për qëllime terapeutike, pra duke qënë kontrollin e vazhdueshëm injektorë. Më lart paraqitëm arsyet pse materialin tonë në disa grup-mosha mbizotërojnë femrat.

Numri më i madh i trombembolive haset në të sëmurë me mundje të brendshme sesa në ato kirurgjikale (3, 5, 7), por ka au (8), që flasin për shpeshtësinë më të madhe në të sëmurët kirurgjik.

Në vdekjet nga trombembolitë, vendin e parë e zënë gjithashtu sëmundjet e aparatit kardiovaskular me 45 raste, të dytin sëmuni e aparatit të frysëmarrjes me 26 raste dhe të tretin proceset malinje 13 raste. Të marra si sëmundje të veçanta, vendin e parë e zënë v reumatizmale me 29 raste, të dytin zemra mushkërore kronike me 23 të tretin proceset malinje me 13 raste. Në këtë vdekshmëri, infarkt miokardit përfaqësohet me 8,3%, e përafertë me shpeshtësinë 7,9% dhëne nga disa autorë të tjera (2). Në 7 raste të tjera të infarktit, mbembolizmi ka kontribuar në vdekje.

Zanafilla e trombit është gjetur në 94 raste (51,08%). Në raste tjera nuk është gjetur dhe kjo për arsyen të ndryshme, pasi trombi shkëputur mund të lerë një gjurmë fare të vogël në intimën e vësë interesuar dhe kështu shpeshherë i shpëton ekzaminimit makroskopik. Gjetja e zanafilës vështirësuhet ende më shumë për faktin se shperëtë trombet nuk kanë shenja klinike, sipas të cilave të mund të ori tohet morfologi, pasi ai nuk ka gjithmonë mundësi të bëjë një diseks me qëllim në rrjetin venoz shumë të gjërë. Vendin e parë në zanafillën e trombembolit e zë zemra e djathë (shih pasqyrën nr. 3) me 47

ste (50%), vendin e dytë plekset periprostatike, perivesikale dhe periuterine me 21 raste (22,3%) dhe të tretin ato të kombinuara me 12 raste (12,7%), ku janë përfshirë ato raste, ku tromboza ka qënë e shumëfishëtë si në zemër dhe në anësitë, zemër dhe plekset e tjera. Vendin e katërtë e zenë ato të anësive të poshtme me 6 raste (6,3%), shifër kjo shumë më e ulët se ato të dhëna nga disa autorë (1, 5, 6). Kjo sigurisht edhe përfaktin se në materialin tonë kemi pak raste kirurgjikale. Poredhut të theksojmë se edhe të dhënat e literaturës mbi shpeshtësinë e gjetjes së zanafilës së trombit, në këtë apo atë sektor, janë mjaft në kundërshtim njëra me tjetren. Nuk është fare bindëse përqindja që jepnë disa autorë (5, 7) mbi gjetjen e zanafilës së trombit në zemrën e djathët vetëm në 1,4% të rastevë, kur dihet se sëmundjet kongjesteve të zemrës, përfshirë këtu edhe miokardiopatitë idiotipike, karakterizohen nga shpeshtësia e trombeve aurikulare dhe, në përgjithësi, të zemrës së djathët dhe ku fibrilacioni atrial, i shpështët në këtë sëmundje, konsiderohet si një nga faktoret më të rëndësishëm të shkëputjes së trombit, pra i trombembolisë.

Problemi i shpeshtësisë së formimit të infarktit pulmonar dhe i pjesëmarrjes së tij në shkaktimin e vdekjes është shumë i ndërlikuar. Disa autorë (6) thonë se 90% e trombembolive nuk jepnë infarkt dhe një nga arsyet e shumta është se trombembolitë masive jepnë vdekje të menjëherësime pa lënë kohë përfomimin e infarktit. Një ndër arsyet e tjera të shpeshtësisë së pakët të formimit të infarkteve është edhe ajo se okluzioni i arterieve pulmonare nuk bëhet i plotë dhe se mushkëritë kanë kolaterale të pasura bronkopulmonare, që pengojnë formimin e infarktit dhe, veçanërisht, në ato raste kur zemra e majtë është në gjendje të mire funksionale. Është përfaktë se trombembolitë interesojnë më shpesh arteriet e vogla sesa ato të mëdhatë (8). Në materialin tonë (shih pasqyrën nr. 3) infarktet pulmonare janë gjetur në 146 raste (79,3%) të trombembolive dhe nga këto, në 70 raste (47,9%) kanë qënë shkaktarë të vdekjes, pa llogaritur këtu embolet vdekjeprurëse pa infarkt. Tromboembolitë pa infarkt janë gjetur në 38 raste (20,65%), nga të cilët vdekjeprurëse kanë qënë në 28 raste (15,2%). Në 19 raste (50%) trombembolit ishin bilaterale, nga këto, 7 (18,3%) të mushkërisë së djathët dhe po aq të mushkërisë së majtë, ndërsa trungu i arteries pulmonare përfaqësohet me 3 raste.

Në shpërndarjen e infarkteve pulmonare u vu re se në 61 raste (41,9%) ato ishin bilaterale, 55 të mushkërisë së djathët dhe 30 të së majtës. Shumica e infarkteve, 66 raste, kanë qënë të lokalizuar në lobet e poshtme, çka është në përputhje me fiziologjinë e qarkullimit, pasi embolet shkojnë zakonisht në arterien lobare të poshtme, veçanërisht në të djathët, pasi ka drejtimin e favorshëm të boshtit të qarkullimit.

Në qoftë se nuk shpie në vdekje përfaktë të shkurtër, infarkti pulmonar u nënshtronet ndryshimeve dhe ndërlikimeve të shumëllojshme. Si ndërlikime më të shpeshta të infarktit pulmonar, një autor (7) radhit abscedimin, pleuritin akut, empiemën dhe gangrenën. Ndryshime të tilla ne kemi gjetur në 36 raste, nga të cilat abscedemimi dhe gangrenizimi vijnë në radhë të parë. Këto ndryshime ngjasin veçanërisht në ato raste kur trombemboli shkaktar i infarktit mbart me vete mikroorganizma patogjene.

Në materialin tonë, ndërlikimet më të shpeshta kanë ndodhur në

rastet kur sëmundja bazë ka qënë endokarditi postreumatizmal kë (në 11 raste), aterosklerozë me rrjedhimet e saj në 5 raste, sepsis septikopiemia në 10 raste, sëmundjet nervore në 2 raste, sëmundje rre dhe zemra mushkërore kronike në 2 raste. Është interesante të përmë se në një rast me miokardiosklerozë u vërejt organizimi dhe rekлизimi i trombit të arteriave pulmonare të djathtë. Abscedimi dhe grenizimi është vërejtur më shpesh në gjendje septiko-piemike në 7 rastës, ndërsa në 5 raste u vërejt pneumonia në veset reumatizmale të zërave.

PERFUNDIME

1) Nga materiali ynë del se trombembolia pulmonare përbën 3, të të gjithë patologjive dhe 1,96% të të gjithë shkaqeve të vdekjeve.

2) Kufiri i moshës, që shënon ngritjen e ndjeshme të numri rasteve me trombemboli pulmonare, është përtej moshës 40 vjeçë grup-moshë, numri më i madh i rasteve gjendet në grup-moshën -70 vjeç. Po kështu ndodh edhe me vdekshmërinë.

3) Nga 184 raste të trombembolisë pulmonare, 97 raste kanë vdekjeprurëse, në 17 raste ka kontribuar në mënyrë të dukshme, ndërsa në 70 raste të tjera ose ka kontribuar pak më vdekje ose ka qënë e stësishme.

4) Numri më i madh i rasteve me trombemboli pulmonare u rejt në sëmundjet kardiovaskulare me 74 raste, pastaj në atë të apertit të frymëmarrjes me 46 raste, proceset malinje me 24 raste, sëmundjet infektivo-septike me 16 raste dhe sëmundjet e SNQ 11 raste.

5) Si burim embolesh, vendin e parë e zë zemra e djathtë 47 raste (50%), të dytin plekset periprostatikë, perivesikale dhe peririne me 21 raste (22,3%). Venat e anësive të poshtme përbëjnë 6 rastë (6,36%).

Dorëzuar në Redaksi më 25 korrik 1

BIBLIOGRAFIA

- 1) **Clain A.** : The veins including pulmonary embolism. Emergency surgery 1972, 1, 11.
- 2) **Field E. S., Kokkar V. V., Nicolaides A. N.** : Deep veins thrombosis after myocardial infarction, prostatectomy and fracture of femoral neck. Edinburg London 1972, 117.
- 3) **Franc N.** : Aid for prompt recognition of pulmonary embolism. JAMA 1974, 227, 125.
- 4) **Friend J. R., Kokkar V. V.** : Deep vein thrombosis in obstetric and gynecological patients. Edinburg and London 1972, 131.
- 5) **Juhasz G.M., Dones G.** : Smjertelnaja embolija ljugocnijih arterii po sekcijskim za 20 ljet (1938-1957). Archiv Patologii 1961, 7, 28.
- 6) **Gibson J., Sabiston D., Spencer P.** : Chest surgery. Philadelphia 1970, 502.
- 7) **Saphir O.** : A text on systemic pathology. New York and London 1958.
- 8) **Spittell J. and Coll.** : Peripheral Vascular diseases. Philadelphia 1972.

Summary

PULMONARY THROMBOEMBOLISM

A study was carried out of the cases of pulmonary thromboembolism from a survey of 4942 necropsies performed between 1957 and 1973 which included all the age groups.

The survey showed that pulmonary thromboembolism constituted 3.73% of all the pathological conditions and 1.96% of the causes of death. The proportions increase strikingly over the age of 40 and reach their peak at the age of 60-70. A similar trend is observed in the death rate. Of 184 cases, in 97 thromboembolism was the direct cause of death, in 17 it was an obvious accessory to death and in 70 cases it had little or no connection with the cause of death.

In studying the links between thromboembolism and other diseases it was observed that thromboembolism coincided more frequently with cardiovascular diseases (74 cases), followed by respiratory diseases (46 cases), malignant tumours (13 cases), septic infectious diseases (16 cases) and affections of the central nervous system (11 cases).

As regards the particular nosologies, first comes the rheumatic affection of the heart with 45 cases, second the chronic heart and lung diseases with 40 cases.

The origin of the thrombus was found in 94 cases; in these the first place is occupied by the right heart with 47 cases (50%) the second by the periprostatic, perivesicular and periuterine plexuses with 21 cases (22.26%). The veins of the lower limbs accounted for only 6 cases (6.36%).

Of the 184 cases with pulmonary thromboembolism, pulmonary infarction was found in 146 or 79.3%, of which 94 were fatal. In the distribution of the infarctions it was found that most of them were bilateral (41.9%), followed by those of the right lung. Thromboembolism without infarction was found in 20.65% of the case of which 15.2% were fatal.

Résumé

LA THROMBO-EMBOLIE PULMONAIRE

Il est question d'une étude concernant la thrombo-embolie pulmonaire, étude fondée sur l'analyse de 4942 autopsies effectuées pendant la période allant de 1957 à 1973 et comprenant tous les groupes d'âge.

Cette analyse a montré que la thrombo-embolie pulmonaire représente 3.73% des cas pathologiques et 1.96% des motifs de décès. Le nombre des thrombo-embolies croît extrêmement au-dessus des 40 ans, en atteignant son point culminant à l'âge de 60-70 ans. On observe une tendance analogue quant au taux de mortalité. Sur 184 cas de thrombo-embolie, 97 ont été mortels, 17 ont contribué clairement à l'issue fatale et 70 on influé insensiblement ou fortuitement à la mort du patient.

En étudiant les liaisons entre la thrombo-embolie et les autres maladies, il ressort que la thrombo-embolie coïncide très fréquemment avec des affections cardio-vasculaires (74 cas), puis avec des affections de l'appareil respiratoire (46 cas), avec des tumeurs malignes (13 cas), des infections septiques (16 cas) et des affections du système nerveux central (11 cas).

En ce qui concerne les nosologies particulières, en premier lieu vi ffection rhumatismale avec 45 cas puis les maladies chroniques du coeu poumons avec 40 cas.

L'origine du thrombus a été identifié dans 94 cas; de leur nombre, mière place revient au coeur droit avec 47 cas (50%), la deuxième au péricardiaques, périvésiculaires et périutérins avec 21 cas (22,36%). Les membres inférieurs ne représentent que 6 cas (6,36%).

Sur 184 cas de thrombo-embolie, on a identifié 146 cas d'infarctus du (79,3%), dont 94 mortels. En ce qui concerne la répartition des infar auteurs ont constaté que tout d'abord viennent les infarctus bilatéraux et ensuite les infarctus du poumon droit. La thrombo-embolie sans inf été relevée dans 20.65% des cas, dont 15.2% était responsable des décès

VDEKSHMËRIA PERINATALE NË LINDJET BINJAKE

(Rahim Gjika - Spitali i rrëthit - Peshkopi)

— RAHIM GJIKA —

(Spitali i rrëthit - Peshkopi)

Një nga faktorët kryesorë, që ndikon në rritjen e vdekshmërisë perinatale janë dhe lindjet binjake. Sipas publikimeve të shumë studjuesve, kjo vjen thjesht për dy arsyre kryesore dhe pikërisht për përqindjen e lartë të lindjeve parakohe dhe të vendosjeve patologjike të fetuseve; për pasojë edhe të kryerjesh së një numri të madh ndërhyrjesh kirurgjikale në këto raste (3,9).

MATERIALI YNË

Ne kemi marrë në studim 116 binjakë të lindur në repartin përkatesë të rrëthit Peshkopi për periudhën dhjetëvjeçare 1964-1973 me një sasi të përgjithshme lindjesh 4408. Në këtë punim kemi vënë për detyrë të sqarojmë disa veçori të lindjeve binjake dhe ndikimin e tyre në vdekshmërinë perinatale.

Shpeshtësia e lindjeve binjake. — Përgjithësisht shpeshtësia e lindjeve binjake lëkundet nga 1-20% e lindjeve të përgjithshme. Nga të dhënat e autorëve ajo paraqitet 1.2% (3, 5); 1.87% (7), ndërsa në materialin tonë ka qenë në masën rrëth 2.3%.

Sipas moshave të nënave, rastet tona i kemi paraqitur në pasqyrën nr. 1, ku vihet re mbizotërimi i moshës 26-30 vjeç, në masën 33.7%.

Pasqyra nr. 1

Lindjet binjake sipas moshave të nënave

Mosha e nënave	Numri	Përqindja
deri 20 vjeç	6	5.1
20 - 25	24	20.7
26 - 30	39	33.7
31 - 35	24	20.7
36 - 40	22	18.9
41 - 45	1	0.9
	116	100.0

Lidhur me reportin që ekziston ndërmjet shpeshtësisë së lind binjake dhe paritetit të paraqitur në pasqyrën nr. 2 del se rastet më shumta takohen në pluriparet dhe sidomos nga fëmija e tretë deri të pestin. Një fakt të tillë e pohojnë edhe të dhënrat e disa autot (3, 6).

Pasqyra

Lindjet binjake në raport me paritetin

Pariteti	Numri	Përqindja
I	9	7.7
II	15	13.0
III	18	15.5
IV	16	13.7
V	18	15.5
VI	13	11.2
VII	8	7.5
mbi VII	19	16.4
	116	100,0

Vdekshmëria perinatale, në lindjet binjake, është përkrahësia lartë, duke u lëkundur nga 19.3 (cituar nga 3) deri në 14.1% (9). Në materialin tonë, vdekshmëria perinatale ka qenë në masën 17.2% (në fëmijë të lindur binjakë, 41 prej tyre lindën të vdekur ose vdiqën në ditën e 7-të të pas lindjes).

Sipas periudhës në të cilën kanë ndodhur vdekjet fetale, ato paraqitur në pasqyrën nr. 3. Në materialin tonë, vdekjet më të janë takuar në periudhën para dhe pas lindjes deri në ditën e 7-të, përkojnë pak a shumë edhe me të dhënrat e autorëve të tjera (5, 7).

Pasqyra

Vdekshmëria perinatale në lindjet binjake sipas periudhës së lindjes

Periudha e lindjes	Binjaku I	Binjaku II	Numri i përgjithshëm
Para lindjes	5	12	17
Gjatë lindjes	1	3	4
Pas lindjes	4	16	20
	10	31	41

Përgjithësisht përsye tanimë të njoitura, vdekshmëria perinatale është më e lartë në fetusin e dytë, ku në materialin tonë, rapporti dy fetuseve është gati trefish (12.9% në fetusin e dytë dhe 4.3% parin). Edhe nga të dhënrat e literaturës mbizotëron vdekja e fetusit dytë: 19% me 11% (2), 20.42% me 17.32% (3).

Lindjet para kohe, duke futur këtu fetuset me peshë ndën 2500 gr. në lindjet binjake, janë në përqindje të larta dhe në materialin tonë, ato zënë 56% të rasteve.

Pesha mesatare e fëmijëve të lindur binjakë në materialin tonë ishte në masën 2408; ndërsa sipas të dhënave të literaturës del 2337 gr. e 2395 gr (cituar nga 9).

Në lindjet binjake, vendosjet jotipike janë të shpeshta dhe në materialin tonë përfshin e parë janë 31% dhe përfshin 42.2% dhe nga të dhënrat e autorëve të tjera paraqiten: 26.4% me 47.1% (3); 22.2% me 47.9% (6); 18.6% me 35.6% (9).

Mënyra e vendosjeve fetale në mënyrë të hollësishme është paraqitur në pasqyrën nr. 4, ku më shpesh takohet kombinimi kokë-kokë, kokë-podium dhe podium-kokë.

Pasqyra nr. 4

Mënyra e vendosjeve të fetuseve në binjakët

Vendosjet fetale	Numri	Përqindja	
Fetusi I	Fetusi II		
Kokë	kokë	45	38.8
Kokë	podiume	22	18.1
Podiume	kokë	19	16.4
Podiume	Podiume	9	7.7
Kokë	Transversal	13	11.2
Transversal	kokë	—	—
Fetusi I	Fetusi II		
Podiume	Transversal	3	2.5
Transversal	Podiume	—	—
Transversal	Transversal	5	4.3
		116	100,0

Përqindja e përfundimit të lindjeve me rrugë ndërhyrje obstetrikuale në lindjet binjake është përkrahësia e lartë, duke mbizotëruar ajo në fetusin e dytë dhe pikërisht në rastet tona ajo paraqitet 36.2% me 57.4%. Pak a shumë të dhëna të njëjtë jepin edhe autorë të tjere përfshinë: 26.6% me 41.8% (3), 30.5% me 69.5% (6). Në materialin tonë, përfundimi i lindjeve paraqitet në pasqyrën nr. 5.

Në pasqyrën nr. 6 është paraqitur raporti që ekziston ndërmjet vdekjeve fetale dhe mënyrës së përfundimit të lindjeve në binjakët, ku midis ndërhyrjeve kirurgjikale, vdekjet fetale më të shpeshta janë takuar në rrotullimet e fetuseve.

Pasqyra nr. 5

Mënyra e përfundimit të lindjeve	Fetusi I	Fetusi II
Lindje të vetëvetishme	74	49
Forcepsë e vakum	3	3
Ekstraksion me dorë	20	13
Ndihma sipas Bracht	4	4
Rrotullim fetal	2	14
Prerje cézariane	3	3
	116	116

Pasqyra

Vdekshmëria perinatale sipas mënyrës së përfundimit të lindjeve në binjakët

Mënyra e përfundimit të lindjeve	Numri i fetuseve
Lindje të vetëvetishme	21
Forcepsë e vakum	—
Ekstraksion me dorë	6
Ndihmë sipas Brachtit	1
Rrotullim fetal	9
Prerje cézariane	4
	41

Intervali midis fetusit të parë dhe të dytë është paraqitur në pasqyrën nr. 7 dhe në materialin tonë, rrëth 37% e lindjeve binjakë pasur një interval rrëth 10 minuta ndërmjet dy fetuseve.

Pasqyra

Intervali deri në lindjen e fetusit të dytë

Koha në minutë	Numri	Përqindja
0-10	43	37
11-20	27	23.3
21-30	15	12.9
31-40	2	1.7
41-50	6	5.2
51-60	—	—
mbi 60	23	19.9
	116	100.0

Vdekjet e fetusit të dytë, në raport me intervalin e lindjeve të janë dhënë në pasqyrën nr. 8, ku del qartë se fëmijët që lindin intervalit 30 minuta kanë një vdekshmëri mjaft të lartë.

Pasqyra n

Vdekshmëria e fetusit të dytë në vartësi nga intervali i lindjes së

Koha në minutë	Numri i fëmijëve të lindur	Numri i fëmijëve të vdekur	Përqindja
0-10	43	10	23.2
11-20	27	5	18.5
21-30	15	4	26.6
31-40	2	—	0.0
41-50	6	3	50.0
51-60	—	—	0.0
mbi 60	23	9	39.1

Vdekshmëria perinatale në lindjet binjake

Si ndërlikime më të shpeshta në gratë me shtatzëni binjake, në rastet tona, kemi takuar toksikozat e vonëshme në 11 raste (9.2%), hidramnion 6 raste (5.1%) dhe anemi në 2 raste (1.7%).

Gjatë lindjes kemi takuar këto ndërlikime kryesore në zhvillimin e lindjeve binjake: plasje e parakohëshme e cipave amniotike në 10 raste (8.9%), pararënie e kordonit të kérthizës dhe e dorës në 5 raste (4.5%), dobësi të aktivitetit të lindjes në 4 raste (3.4%) dhe ngatërrim fetal në një rast.

DISKUTIM

Sipas të dhënave të literaturës, shpeshtësia e lindjeve binjake lëkundet në shifrat 1-2%. Në materialin tonë, kjo shpeshtësi është në masën 2.3%. Kjo përqindje përkrahësish e lartë shpjegohet për arsyenë se në institucionin tonë grumbullohet pothuajse e gjithë patologjia obsterrike e rrëthit.

Lidhur me vdekshmërinë perinatale, sipas të dhënave të literaturës, ajo lëkundet nga 14.1% në 19.3%, ndërsa në materialin tonë në lindjet binjake, vdekshmëria perinatale ka qënë në masën rrëth 17.2%. Ndërmjet fetuseve të binjakëve, në rritjen e vdekshmërisë perinatale, një rol të rëndësishëm lot fetusi i dytë, ku në materialin tonë është në masën 12.9%. Kjo shpjegohet me faktin se vendosjet patologjike, në këtë të fundit, janë më të larta (42.2%) dhe, për pasojë, edhe ndërhyrjet obsterrike përfundimin e lindjeve janë më të shpeshta. Faktori tjeter i rëndësishëm në rritjen e vdekshmërisë perinatale në lindjet binjake janë edhe lindjet e fetuseve me peshë 2500 gr., ku në materialin tonë janë në masën rrëth 56%. Të dhëna të përaferta jepin dhe autorë të tjerë: 58.8% (2), 59.1% (9).

Përsa i përket intervalit midis lindjeve të dy fetuseve në binjakët dhe ndikimit të tij në vdekshmërinë perinatale, ka autorë (8) që shprehin mendimin se ky interval është në përpjesëtim të drejtë me kohën që kalon nga lindja e fetusit të parë. Si kohë optimale e lindjes së fetusit të dytë pas të parit konsiderohet ajo 10-20 minuta (3,9). Lidhur me zgjatjen e kohës së lindjes së fetusit të dytë, disa autorë (1) kanë publikuar një rast, ku fetusi i dytë kishte lindur 81 orë e 30 minutë pas fetusit të parë. Sipas autorit tjetër (cituar nga 3), fetusi i dytë mund të mbahet brenda mitre në se ekzistonë shenjat e sigurta të jetës së fetusit, kur ky i fundit ende nuk është pjekur dhe për aq kohë sa cipat fetale janë të pacënuara. Në pasqyrën 7, ku është paraqitur raporti ndërmjet intervalit të lindjes së fetusit të dytë dhe vdekshmërisë perinatale në materialin tonë rezulton se ato që kanë një interval kohe mbi 30 minuta, kanë një vdekshmëri të lartë në krahasim me ato që kanë lindur brenda 30 minutave. Të dhëna të përaferta jepin edhe autorë të tjerë (3, 6, 9).

PERFUNDIME

1) Gjatë periudhës 10 vjeçare (1964-1973) në shtëpinë e lindjes të Peshkopisë kanë lindur 116 binjakë me një shpeshtësi në raport me lindjet e përgjithshme rrëth 2.3%. Sipas moshës së grave, këto lindje

më tepër janë takuar midis 26-30 vjeç dhe sipas paritetit, më shi në pluriparet.

2) Në materialin tonë, në lindjet binjake, vdekshmëria perinatale qënë në masën 17.2%; sipas fetuseve, ajo e fetusit të dytë ka që rreth trefish më i lartë sesa në të parin (12.9 me 4.3%).

3) Pesha mesatore e fëmijëve të lindur binjakë, në materialin tonë, ka qënë në masën 2409 gr. Lindja e fëmijëve me peshën në 3500 gr. ka qënë në masën rreth 56% të rasteve.

4) Vendosjet jo tipike të fetuseve në binjakët kanë qënë në shumë larta, por sidomos ato të fetusit të dytë kanë qënë ende më larta. Mënyra e përfundimit të lindjeve me ndërhyrje obstetrikale që binjakët kanë përkrahësish e shpeshtë, por në fetusin e dytë ka që edhe më e shpeshtë (57.4%).

5) Intervali i lindjes së fetusit të dytë nga i pari, në 37% ka që brenda 10 minutave; me zgjatjen e intervalit tej 30 minutave, vdel fetusi kanë qënë në një përqindje më të lartë.

Dorëzuar në Redaksi më 15 nëntor 1979.

B I B L I O G R A F I A

- 1) Alessandrescu D., Dumitrescu P., Filipescu I.: Das problem Reaktivität des Uterus in der Zwillingsschwangerschaft, Zentralbl für Gynakologie 1963, 85, 1682.
- 2) Hagen L.: Perinatale Mortalität und Zwillingsschwangerschaft. Zeitschrift für Ärztlche Fortbildung 1971, 24, 1290.
- 3) Holtorf J.: Über Kindliche Mortalität bei Zwillingssgebäuten. Zentralblatt für Gynakologie 1964, 86, 1529.
- 4) Langer H.: Perinatale Mortalität der Zwillingssgebäuten. Zentralbl für Gynakologie 1972, 94, 1268.
- 5) Orozi L.: Vdekshmëria perinatale nga prematuranca në barrën shumë fëmijë. Morboziteti dhe Mortaliteti perinatal dhe neonatal Tiranë 1976.
- 6) Ristedt I., Kraubig H.: Der Zweite — Zwillingsschicksal und folgerungen für die Geburtshilfe 1968, 90, 449.
- 7) Thompson P., Jones and Carl E. Johnson : Survival und Management of the second-born Twin. Obstetrics and Gynecology 1966, 27, 8.
- 8) Weidl E.: Neue Erfahrungen über die Mehrlingsgebäuten-in Schwangerschaften der Frauenheilkunde und Geburtshilfe 1964, 1, 378.
- 9) Weidenbach A., Klose B.J.: Geburtsleitung und Überlebenschance 2-zwillings. Geburtshilfe und Frauenheilkunde 1970, 9, 795.

S u m m a r y

PERINATAL DEATH RATE AMONG TWINS

The paper gives some clinical and statistical data on twin birth for a period of ten years (1964-1973) at the maternity of Peshkopia. Twins were born in 2.3 percent of the deliveries and their perinatal death rate was 17.2 percent.

The paper also points out the comparatively high body weight of the newborn twins and discusses the medical care for twin births in general and the duties of the women's consultations in their treatment of twin pregnancies.

R é s u m é

MORTALITE PRENATALE CHEZ LES JUMEAUX

Dans cet article l'auteur fournit des données cliniques et statistiques relatives à la naissance de jumeaux pendant une période de 10 ans (1964-1973) à la maternité de Peshkopi.

De ces données il ressort que les naissances de jumeaux concernent 2,3% des cas et cela avec une mortalité pré-natale de 17,2%.

Ensuite l'auteur relève le poids relativement élevé des jumeaux, il traite en général le problème de la naissance des jumeaux et les tâches qui se posent aux centres de consultation par rapport à ce problème.

HIGJIENE DHE EPIDEMIOLOGJI

DINAMIKA E FLORËS DERMATOFITIKE TË VENDIT TONE
PËR PERIUDHËN 1967-1979

- MINELLA PAPAJORGJI -

(Instituti i Higjienës dhe Epidemiologjisë)

Shëndetësia jonë popullore, e orientuar në baza profilaktike dhe törësishët në shërbim të popullit, ka arritur suksese të njëpasnjëshme në luftën kundër sëmundjeve ngjitëse. Në këtë kuadër, çrrënjosja e dermatofitozave me origjinë humane në fund të vitit 1980 është një nga detyrat e rëndësishme, që ka marrë përsipër shëndetësia jonë gjatë këtij pesëvjeçari. Lufta kundër këtyre infeksioneve mikotike mund të mbështetet mbi themele shkencore atëhere kur njihet flora dermatofitike e vendit. Studimi i florës ka rëndësi të madhe pasi ve në dukjet e infeksioneve mikotike që mbizotërojnë dhe aspektet epidemiologjike, të cilat kanë rëndësi për luftimin e këtyre infeksioneve. Ky studim duhet të jetë i vazhdueshëm për arsyen e ndryshimeve të rëndësishme, shpeshherë rrënjosore, që mund të pësojë ajo nga një periudhë në tjetrën.

Flora dermatofitike botërore numëron rreth 35 lloje dermatofitesh patogenë për njerëzit dhe kafshët. 20 prej tyre bëjnë pjesë në gjininë *Trichophyton*, 14 në gjininë *Microsporum* dhe vetëm 1 në gjininë *Epidemophyton* (3).

Dermatofiti patogenë më i ri, i izoluar nga njerëzit e sëmurë me dermatofitoza është *Trichophyton proliferans-Stockdale Phyllus* – 1968 (3). Dermatofitet e gjinisë *Arthroderma* dhe *Nannizzia* janë stendet e shumëzimit seksual të dermatofiteve të gjinive *Trichophyton* dhe *Microsporum*.

Në vendin tonë, studimet mbi njohjen e florës dermatofitike kanë filluar në vitin 1955 (6), 1960-1964 studojhet për qytetin dhe rrithin e Tiranës (2) dhe për vitet 1964-1968 për rrithin e Durrësit (7). Nga ana jonë ky studim ka filluar qysh nga viti 1967 në të gjithë rrithet e vendit dhe është ndjekur në dinamikë.

MATERIALI DHE METODA

Studimi që paraqesim mbështetet në analizën e 7895 shtameve dermatofitesh të izoluar në të gjithë rrithet e vendit tonë për periudhën 1967-1979.

Materiali patologjik është grumbulluar nga ne në bashkëpunim me D.H.E të rrtheve. Ky material u ekzaminua drejtëpërdrejt në mikroskop dhe kampionet pozitivë u kultivuan në terrenin standart agar-glukozë

Sabouraud me kloramfenikol. Inkubimi i kulturave u krye në termo 28°C për tri javë. Llojet e dermatofiteve u përcaktuan mbi bazë strukturës morfologjike. Për shtamet e dyshimta u përdorën mikroturat sipas metodës Ridell të ngjyrosura me PAS si dhe provat bi gjike në minj të bardhë.

Emërtimi i llojeve të dermatofiteve është bërë në bazë të klifikimit të Ajello L 1968 (1).

Materiali paraqet të dhënat për dermatofitet e izoluar nga të murët me *Tinea Capitis*, *Tinea corporis*, *Tinea unguium* dhe *Tinea bar-*

REZULTATET

Nga 7895 shtamet e dermatofiteve të izoluar në periudhën 1967-1 rezulton se në vendin tonë gjënden 12 lloje dermatofitesh.

Pasqyrat

Llojet e dermatofiteve të izoluar

Llojet e dermatofiteve	Numri i shtameve	Përqindj
1) <i>Trichophyton violaceum</i>	6595	83.44
2) <i>Trichophyton tonsurans</i>	266	3.37
3) <i>Trichophyton schoenleinii</i>	410	5.19
4) <i>Trichophyton rubrum</i>	63	0.80
5) <i>Trichophyton verrucosum</i>	464	5.87
6) <i>Trichophyton mentagrophytes (gypseum)</i>	36	0.46
7) <i>Trichophyton mentagrophytes (quinckeanum) 3</i>	36	0.46
8) <i>Trichophyton mentagrophytes (kaufmann-Wolf)</i>	1	0.01
9) <i>Trichophyton megninii</i>	4	0.05
10) <i>Microsporum ferrugineum</i>	5	0.06
11) <i>Microsporum gypseum</i>	12	0.15
12) <i>Epidermophyton floccosum</i>	3	0.04
S h u m a	7895	100.00

Siq shihet, *Trichophyton violaceum* është dermatofiti kryesor izolohet në vendin tonë (83.44%), pastaj vijnë *T. schoenleinii* (5.19%) *T. verrucosum* (5.87%) dhe më rrallë dermatofitet e tjerë.

Shtamet e dermatofiteve janë izoluar në të gjithë rrëthet e vendit t (shih pasqyrën nr. 2).

Në të gjithë rrëthet ekzistojnë dermatofitet: *T. violaceum*, *T. schoenleinii*, *T. verrucosum* dhe *T. tonsurans*. Në rrëthin e Korçës, gjatë kët 13 vjetëve, nuk kemi izoluar asnjë shtam *T. schoenleinii*, që është shkaktar i favusit. Në rrëthin e Beratit në rajonin e Urës-vajgurore 2 ra dhe të Durrësit (Ishëm 3 raste) janë izoluar 5 shtame *M. ferrugineum* vitet 1967-1969. Ky dermatofit, i njohur më parë si *Trichophyton ferrugineum* nuk ka mundur të përhapet dhe mungesa e izolimit të tij në v pasardhëse tregon se ai është eliminuar. Nga të dhënat e florës deritofitike rezulton se infeksioni mikrosporik nuk ekziston në vendin ton

Nga 7895 shtamet e izoluara rezultoi se dermatofitet antropofile janë shkaktarë kryesorë të dermatofitozave (gjithsej 7335 shtame ose 92.91%), dermatofilet zoofilë 6.94% -548 shtame dhe dermatofitet geofilë 0.15% -12 shtame.

Në pasqyrën nr. 3 jepim dermatofitet e izoluar nga format e ndryshme klinike të dermatofitozave.

Forma më e shpeshtë e lokalizimeve klinike është *T. capitis* me 89.97% të rasteve, pastaj *Tinea corporis* me 6.84% . Siç shihet, *T. violaceum* është shkaktari kryesor i të gjithë formave klinike të dermatofitozave në vendin tonë. *T. verrucosum* izolohet më shpesh në format inflamatore të këtyre mikozave (në radhë të parë në Kerion Celsi).

Nga dermatofitet e izoluar në *Tinea capitis*, rëndësi të veçantë paraqet izolimi i *T. rubrum* (shumë i rrallë në kokë), shkaktar i zakonshëm i epidermofitise.

Të dhënat mbi ndryshimet e florës dermatofitike po i paraqesim në pasqyrën nr. 4.

Prirja e përgjithshme e florës dermatofitike në vendin tonë nuk është në ndryshimin e infeksionit mikotik (trikofiti, favus, mikrospori), por në uljen e infeksionit dermatofitik nga *T. violaceum* në mënyrë të vazhdueshme dhe dalja më në pah e *T. verrucosum*, i cili nga 1.95% në vitin 1969 arriti në 24.02% më 1979. Dermatofitet e tjerë si *T. tonsurans*, *T. mentagrophytes (gypseum)*, *T. mentagrophytes (quinckeanum)*, *M. gypseum* jepin rrallë dermatofitoza në njerëz. Ulja e infeksionit me origjinë humane dhe dalja më në pah e atij zoofil po bëhet me ritme të shpejtë, sidomos pas vitit 1977, kur filloj në mënyrë masive mjekimi i vatrave të infeksionit në të gjithë vendin.

Ndryshimet e florës dermatofitike vihen më mirë në dukje kur studjohet ajo në forma të veçanta klinike të sëmundjes.

Në pasqyrën nr. 5 dhe 6 paraqesim etiologjinë e *T. capitis* dhe *T. corporis* çdo tre vjet për periudhën 1967-1979.

Edhe në këto pasqyra shihet qartë dalja në pah e *T. verrucosum*. Nga 1.36% më 1967 arrin në 17.22% më 1979 në *T. capitis*. Nga ana tjetër në *T. corporis* ky dermatofit nga 9.68% më 1967 arriti 82.61% më 1979.

Në vëndin tonë, këto ndryshime të rëndësishme nuk po ndodhin në të gjithë rrëthet në mënyrë të barabartë. Në rrëthet bregdetare si Sarandë, Vlorë, Durrës e deri në Shkodër, këto ndryshime janë të përendësishme dhe infeksioni human vazhdon të jetë në $85-95\%$ të florës, ndërsa në rrëthet Korçë, Përmet, Pogradec, Tropojë, Kukës infeksioni zoofil, në të kundërtën, arrin në $65\%-95\%$. Gjithashtu ndryshime të rëndësishme po ndodhin edhe në rrëthet Peshkopi, Berat, Librazhd, Pukë, Skrapar e Gramsh, ku origjina zoofile e infeksionit dermatofitik po arrin në $30-50\%$ të florës dermatofitike.

DISKUTIM

Dermatofitet janë parazitë kozmopolitë. Shpeshtësia dhe dinamika e tyre varen nga struktura social-ekonomike e një vendi, nga faktorët sjeografikë klimatike si dhe nga kultura e përgjithshme dhe sanitare e një populli.

Në vendin tonë, dermatofitet e gjinisë *Microsporum* nuk ekzistojnë ndërsa dermatofitet *T. schoenleinii* (shkaktari i favusit). *T. tonsurans* janë drejt eliminimit.

T. violaceum dermatofit antropofil është drejt uljes së vazhdunë vendin tonë, ndërsa dermatofitet zoofil si *T. verrucosum* dhe më *T. mentagrophytes* janë ata që po dalin në pah në florën dermatofite gjithë frekuencën e vogël të tyre.

Nga ky studim rezulton se në vendin tonë mbizotërojnë dermatofitet e gjinisë *Trichophyton*. Dermatofitet e gjinisë *microsporum gypseum* janë geofilë dhe gjënden zakonisht në tokë. Nuk jemi në gjë të shpjegojmë me përpikmëri mungesën e *microsporis*, megjithëse shkaktohet nga shtame miaft virulente (*M. Ouduini*, *M. canis*, *M. felineum*) dhe që kanë vazhdimisht prirje të mbizotërojnë në florën dermatofitike të Evropës (12, 13). Në Evropë, dermatofitet *microsporum* hyrë nga lëvizja e popullsisë gjatë luftrave botërore. Kështu gjatë I së parë Botërore ka hyrë *M. ouduini*, ndërsa *M. ferugineum* gjatë II së Dytë Botërore (3). Pas vitit 1955 *M. canis* po hapet me ritën shpejtë në shumicën e shteteve të Evropës (10). Në Ballkan përtë parë *microsporia* është diagnostikuar më 1923 në Rumani (*M. Oci* (3), në Jugosllavi më 1927 (5), në Bullgari pas vitit 1964 (11) dhe më 1938 (12). Nga dermatofitet e gjinisë *Trichophyton*, që gjëndet Ballkan, në vendin tonë nuk janë izoluar *T. Equinum*, *T. gallinae*, *T. violaceum* ze 83,44% të florës dermatofitike, që një autor (2) përtë 1961-1965 përtir Tiranën e ka gjetur në 81,7% dhe një tjetër (7) përtirin e Durrësit në 90,2% përtir vitet 1964-1968. Në pellgun e Mesdjevës ky dermatofit është miaft i shpeshtë dhe veçanërisht në Evropën Lindore. Kështu në Bullgari ishte dermatofiti kryesor (13), në Rumania 22,9% më 1950 u ul në 1,4% më 1978 (3), në Greqi në 87% (12). Portugali nga 4764 shtame dermatofitesh të izpluar në vitet 1959-1970 vend të parë ishte *T. violaceum* me 1439 shtame të izoluar (12). Afrikë e Veriut dhe Azinë e Vogël, ky dermatofit është në vend të parë *T. schoenleinii* (13).

Tinea capititis, në shumicën e rasteve, është e shkaktuar tek ne *T. violaceum*. Në këtë mikozë kemi izoluar edhe 21 shtame *T. rubrum*. Ky dermatofit i përhapur në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore Lindja e largët dhe SHBA (4) rrallë shkakton mikozë në lëkurën flokë. Përtirës së parë *T. rubrum* është izoluar nga flokët e një fër 5 vjeçë në Japoni (cituar nga 4), pastaj autorë të tjera (3, 12, 13) raportojnë përtirastë të izolimit të këtij dermatofiti nga të sémurët me *capitis*.

Nga të sémurët me *T. capititis cronica* ne kemi izoluar 333 shtame dermatofitesh, prej të cilëve 296 (90%) *T. violaceum* dhe më rrallë *T. tonsurans* 16 shtame e *T. schoenleinii* 16 shtame dhe vetëm 5 *T. verrucosum*. Siç shihet, kjo mikozë kronike, që është burimi më i rëndëshëm i infeksionit dermatofitik në vendin tonë, shkaktohet kryesisht i dermatofitet antropofile *T. violaceum* e më rrallë *T. tonsurans* e *T. schoenleinii*.

Infeksioni zoofile mbizotëron në shumicën e shteteve të Evropës në Hungari (13), Itali (10), Poloni (13), Francë (12).

Në vendin tonë, infeksioni dermatofitik zoofil është i përhapur domos në gjethë (viçë). Nga një studim i bërë më 1972-1974 (9) n

pikofitozën e gjedhit rezulton se nga 38 ekonomi me 14.852 krerë të kuzaminuar me trikofitozë ishin 5,8% e tyre dhe nga 190 shtame të zoluar rezultoi se ishin të gjithë *T. verrucosum*. Sot nga shumë autore (13) është vërtetuar origjina geofile e *T. verrucosum*. Kjo flet për ciklin parazitizmit të këtij dermatofiti tokë-kafshë-njeri.

Në materialin që trajtojmë, nga pikëpamja epidemiologjike, rëndësi të veçantë kanë 36 shtame *T. quinckeum* të izoluar kryesisht në *T. corporis* (31 raste) dhe më rrallë në *T. unguim* (4 raste) dhe një rast vetëm *T. capititis*. Si rregull, në kokë ky dermatofit zoofil paraziton shumë rrallë. Më 1962 në Bullgari (11) është përshkruar një vatrë e rëndësishme *T. capititis* me 72 të sémurë të shkaktuar nga ky dermatofit dhe të infektuar nga minjtë e fushave, që vërvshuan në zonën e banuar në stinën e dimrit. Ky dermatofit u izolua edhe nga minjtë.

Nga shtamet e studjuara, 12 janë *M. gypseum*, dermatofit geofil i izoluar kryesisht nga të sémurë me *T. cutis* (10 raste) dhe vetëm në dy herë në *T. capititis*. Infektimi i njerëzve nga toka, si rregull, është shumë i rrallë. Megjithatë qarkullimi i këtij dermatofili në tokë-kafshë-njeri përbën bazën e epidemiologjisë së tij. *M. gypseum* është izoluar në shumicën e shteteve të botës në tokë (12, 13).

Më poshtë po ndalem i karakteristikat kryesore epidemiologjike të dermatofiteve më të rëndësishëm të izoluar. *T. violaceum* është shkaktare kryesore të dermatofitozave në vendin tonë. Ai është dermatofit stabël dhe pak i ndryshueshëm në florën dermatofitike me prirje të pakësotet në mënyrë graduale. Nga të dhënat e literaturës që kemi mundur të konsultojmë, ky dermatofit nuk është izoluar asnjëherë nga toka. Kjo specie është adaptuar vetëm në jetën parazitare (3). Megjithëse është e mundur origjina zoofile e këtij dermatofiti (10), ai duhet konsideruar kryesisht si dermatofit antropofil. Burimi më i rëndësishëm i infeksionit të shkaktuar nga *T. violaceum* janë të sémurët me trikofiti, në mënyrë të veçantë të rriturit me forma kronike të infeksionit. Në zonat endemike të trikofitës së shkaktuar nga *T. violaceum*, karakteri familjar është më i rëndësishëm nga pikëpamja epidemiologjike.

T. verrucosum është dermatofit zoofit. Është shkaktarë i vetëm i trikofitozës së gjedhit në vendin tonë. Përbën 5,87% të florës dermatofitike, izolohet në të gjithë rrethet, rrallë jep infeksione të lëkurës me flokë. Ai ka prirje të vihet gjithnjë më në pah në vendin tonë. Burimi infeksioni janë kafshët e sémura me trikofitozë. Paraziti bën ciklin tokë-kafshë-njeri.

T. schoenleinii është dermatofit antropofil dhe përbën 5,19% të florës dermatofitike të vendit përtir vitet 1967-1979. Është shkaktare e vetme e favusit tek ne. Ka prirje të ulet vazhdimisht drejt çrrënjosjes së plotë. Në vitin 1979 në të gjithë rrethet janë vënë re vetëm 15 raste me favus.

PERFUNDIME

1) Shkaktarët kryesore të dermatofive në vendin tonë janë dermatofitet antropofile më 92,91% të rasteve. Dermatofitet zoofile izolohen më 6,94% të të sémurëve, ndërsa dermatofitet geofile shumë rrallë shkaktojnë mikozë 0,15%.

2) Nga 7895 shtame dermatofitesh të izoluar gjatë viteve 196 rezulton se *Trichophyton violaceum* përbën 83,44% prej tyre. I tofitët e tjerë janë:

<i>Trichophyton verrucosum</i>	5,87%
<i>Trichophyton schoenleinii</i>	5,19%
<i>Trichophyton tonsurans</i>	3,37%
<i>Trichophyton rubrum</i>	0,8%
<i>Trichophyton mentagrophytes (gypseum)</i>	0,46%
<i>Trichophyton mentagrophytes (quinkeanum)</i>	0,46%
<i>Trichophyton mentagrophytes (Kaufmann-Wolf)</i>	0,01%
<i>Trichophyton megnimi</i>	0,05%
<i>Microsporum gypseum</i>	0,15%
<i>Microsporum ferrugineum</i>	0,06%
<i>Epidermophyton floccosum</i>	0,04%

3) Prirja e përgjithshme e florës dermatofitike është drejt së vazhdueshme të dermatofiteve antropofile nga 96,43% më 196 75,08% në 1979 dhe drejt rritjes së dermatofiteve zoofile nga 3,2% 1969 më 24,77% më 1979.

Trichophyton violaceum nga 86,99% që izolohej në vitet 196 është ulur në 76,38% në vitet 1976-1979, ndërsa *Trychophyton* cosum ka prirje të dalë më në pah dhe nga 1,95% më 1967 më është izoluar në 24,02% si shkaktar i dermatofiteve të vendit

Dorëzuar në Redaksi më 10 mars 1980.

BIBLIOGRAFIA

- Ajello L.: A taxonomic review of the dermatophytes and related species. *Bourraudia* 1968, 6, 147.
- Caridha M.: Trikomikozaat në qytetin dhe rrithin e Tiranës 1961-1965. 1974.
- Cojocaru A.: Éléments de dermatomycologie. Edit. Medicale. Bucarest 197.
- Conant F. N., Smith T. D., Baker D. R.: Manual of clinical mycology 1972.
- Cekic J., Popovic D.: La lutte contre les maladies mycosiques et leur curation dans la R.S. de Serbie. Archives de l'Union Médicale Balkanique Tom. II, nr. 5-6.
- Kerçiku K., Kakariqi Z.: Dermatomikozaat në Shqipëri. Buletini për sh. Natyrore 1955, 3, 39.
- Nakuçi M.: Dermatomikozaat. Tiranë 1974.
- Papajorgji M.: Flora e dermatofiteve në vendin tonë. Shëndetësia po 1972, 1, 35.
- Papajorgji M., Cuci A.: Mbi etiologjinë e trikofitozës së gjedhit në Sh. Buletini i Higjenës dhe Epidemiologjisë 1975, nr. 2.
- Pinetti P., Lostia A.: Studio clinico, micologico ed epidemiologico delle tofizie da *Microsporum canis* osservate alla clinica dermatologica della università di Cagliari tra il 1947 ed il 1969. *Rassegna medica Sarda* 1973, Vol. 11.
- Popchristov P., Balabanov V., Filkov T.: Les mucoses. Archives de l'Un. Médicale Balkanique 1964, Tom II, nr. 5-6.
- Comptes rendus de communication. V-e Congrès de la société Internationale de mycologie humaine et animale. Paris 1971.
- International Symposium of Medical Mycology. Bucarest 1973.

Dinamika e florës dermatofitike të vendit tonë

Prasqyrat nr. 2

SHTAMET E DERMATOFITEVE TË ZBULUARA SIPAS RRËTHEVE GJATË VITEVE 1967-1979

Nr.	Rrethet	T. violaceum.	T. tonsurans.	T. choeruriens.	T. rubrum.	T. gypseum.	T. verrucosum.	T. quinckeanum.	T. rozae.	M. gypseum.	M. ferrugineum.	T. k. wolfi.	E. floccosum.	T. k. wolfi.	E. floccosum.	Shuma
1	Berat	1742	80	99	17	7	80	10	1	2	2	2	2	2	2	2
2	Durrës	541	14	19	6	3	9	-	1	2	3	-	-	-	-	597
3	Hibasan	125	3	5	-	-	8	8	-	-	-	-	-	-	-	142
4	Ersekë	28	2	1	-	2	21	-	1	-	-	-	-	-	-	326
5	Fier	298	7	9	-	-	11	-	-	-	-	-	-	-	-	100
6	Gramish	81	1	1	-	-	-	5	-	-	-	-	-	-	-	18
7	Gjirokastër	12	0	1	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	136
8	Korçë	51	6	63	-	1	77	1	2	-	-	-	-	-	-	296
9	Krujë	250	12	20	1	1	1	9	1	-	-	-	-	-	-	285
10	Kukës	254	5	7	1	1	19	8	-	-	-	-	-	-	-	172
11	Lezhë	157	1	5	1	1	27	3	-	-	-	-	-	-	-	146
12	Librazhd	101	11	6	1	1	1	1	-	-	-	-	-	-	-	84
13	Lushnje	67	5	9	1	1	1	1	-	-	-	-	-	-	-	79
14	Mat	74	2	1	1	1	1	1	-	-	-	-	-	-	-	41
15	Mirditë	39	-	2	-	-	-	-	12	-	-	-	-	-	-	144
16	Peshkopi	121	3	7	-	-	-	-	26	-	-	-	-	-	-	156
17	Përmet	124	1	4	-	-	-	-	12	-	-	-	-	-	-	48
18	Pogradec	26	1	1	9	1	1	3	1	-	-	-	-	-	-	74
19	Pukë	63	4	4	3	3	1	1	1	-	-	-	-	-	-	324
20	Sarandë	308	1	5	1	1	1	1	9	-	-	-	-	-	-	229
21	Skrapar	172	18	18	4	4	1	1	6	28	1	-	-	-	-	272
22	Shkodër	186	9	9	75	1	1	1	1	1	-	-	-	-	-	163
23	Tepelenë	148	4	4	7	1	1	4	4	-	-	-	-	-	-	1.375
24	Tiranë	1104	67	78	35	14	14	14	48	19	1	8	-	-	-	52
25	Tropojë	19	3	8	19	1	1	1	22	-	-	-	-	-	-	542
26	Vlorë	304	6	19	1	1	1	1	11	1	-	-	-	-	-	789
	Shuma	6595	266	410	63	36	464	36	4	12	5	1	3	1	1	7.895

Dermatosifet e izoluqqa nē format e retrvhme klinike sa sənumda

Diagnose klinike		H. vol.	T. tons.	T. vertu	T. schoo-	T. ruber	T. mycop.	T. m. aquin	T. m. K-Wolf	T. m. meg.	M. ferrug-	M. ferum	M. gyipseum	H. floccosum	Schuma
<i>Tinea capitis</i>															
<i>T. capitis superfic</i>		5870	158	275	388	21	21	1	—	—	2	5	2	—	6743
<i>Kerion Celsi</i>		12	1	13	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	27
<i>T. capitis cronica</i>		296	16	5	16	—	—	—	—	—	—	—	—	—	333
<i>Tinea corporis</i>															
<i>T. corporis cronica.</i>		233	63	157	4	16	9	31	—	2	—	—	10	3	528
<i>T. corporis</i>		10	2	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	12
<i>Tinea unguium</i>		5122	13	7	2	26	—	4	1	—	—	—	—	—	175
<i>Tinea barbae</i>		33	11	3	—	—	5	—	—	—	—	—	—	—	52
<i>T. capitis + T. corporis</i>		15	1	4	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	20
<i>T. capitis + T. corporis + T. unguium</i>		4	1	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	5
Shuma		6595	266	464	410	63	36	36	1	4	12	3	7895		

Dinamika e florës dermatofitike të vendit tonë

Shtamet	1967-1969			1970-1973			1974-1976			1977-1979			% %
	1967	1968	1969	1970	1971	1973	1974	1975	1976	1977	1978	1979	
Dermatofitet e izoluar cdo 3 vjeti per periudhen 1967-1979													
T. violaceum	2828	86.99	1197	85.68	1011	83.48	1559	76.38					
T. tonsurans	148	3.42	45	3.22	56	4.72	54	2.75					
T. schoenleinii	43	1.32	68	4.87	78	6.45	116	5.78					
T. rubrum	63	1.95	10	0.72	5	0.41	5	0.24					
T. verrucosum	22	0.68	8	0.57	—	—	288	14.11					
T. mentagrophytes (Gypseum)	17	0.55	—	—	—	—	—	—	—	6	0.29		
T. mentagrophytes (quinkkeanum)	32	18	—	—	—	—	—	—	—	5	0.25		
T. mentagrophytes (kaufmann-wolf)	4	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—		
T. megninii	5	0.15	—	—	—	—	—	—	—	—	—		
M. ferrugineum	9	0.28	—	—	—	—	—	—	—	—	—		
M. gypseum	37	1.00	—	—	—	—	—	—	—	—	—		
E. floccosum	1	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—		
Shuma	3251	100	1397	100	1210	100	2037	100					

Pasqyra nr 5

Etiologja e Tinea capitis në vitet 1967, 1970, 1973, 1976, 1979							
Vjet	T. violaceum	T. tonsurans	T. schoenleini	T. verrucosum	T. ment. gypseum	T. ment. quinckeana	T. rubrum
1967	1012	24	33	15	112	—	3
1970	310	15	31	16	31	100	4
1973	362	5	19	4	—	—	—
1976	300	26	29	20	—	—	—
1979	440	11	17	98	1	1	1
Etiologja e Tinea corporis në vitet 1967-1970, 1973, 1976, 1979							
Vjet	T. violaceum	T. tonsurans	T. verrucosum	T. ment. gypseum	T. ment. quinckeana	T. men. gypsem	T. schenckii
1967	40	8	6	2	3	1	2
1970	57	3	3	3	3	—	—
1973	8	6	5	9	—	—	—
1976	5	4	57	—	2	1	—
1979	—	—	—	—	—	—	—

Summary

DYNAMICS OF THE DERMATOPHYTIC FLORA IN ALBANIA
IN THE PERIOD 1967-1979

A trend of continuous reduction is observed in recent years in the incidence of dermatophytic infections, particularly of tinea capitis, and the prospect of their full eradication is in sight.

Data on the dermatophytic flora for the period between 1967 and 1979 were collected from all the districts of the country.

Anthropophile dermatophytes were predominant as agent of ringworm with 92.91 percent of the cases, while zoophile and geophile dermatophytes were represented with 6.94 and 0.15 percent respectively.

Of 7895 strains isolated during that period, 83.44 percent were *Trichophyton violaceum*.

The general picture of the dermatophytic flora shows a tendency towards a continuous reduction of anthropophile strains with a relative increase of zoophile strains, particularly of *Trichophyton verrucosum*, which from 1.95 percent in 1967, was isolated in 24.02 percent of the cases in 1979.

In Albania *Trichophyton schoenleinii* has become exceptional. Of the genus *Microsporum*, only *Microsporum gypseum* is encountered (rarely), while the remaining species seem to have disappeared.

Résumé

LA DYNAMIQUE DE LA FLORE DERMATOPHYTIQUE DE NOTRE PAYS DANS LA PÉRIODE 1967-1979

Au cours de ces dernières années la fréquence des infections dermatophytiques, et particulièrement du Tinea capitis, s'est continuellement réduite et dans le futur ces infections seront liquidées totalement.

Dans cette communication, l'auteur fournit des données sur la flore dermatophytique relatives à la période 1976-1979, données qu'il a recueilli dans tous les districts du pays.

Selon l'auteur, les principaux responsables des infections de la peau sont les dermatophytes anthropophiles (92,91%), les dermatophytes zoophiles (6,94%) et les dermatophytes géophiles (0,15%).

Au cours de cette période ont été isolées 7.895 souches et de leur étude, l'auteur ressort que *Trichophyton violaceum* en constitue 83,44%.

Le tableau général de la flore dermatophytique indique une tendance générale vers la diminution constante des souches anthropophiles avec une accroissement relatif cependant des souches zoophiles, en particulier de celle à *Trychophyton verrucosum*, laquelle est passée de 1,95% des cas en 1967 à 24,02% des cas en 1979.

Ces dernières années, le dermophyte *Trichophyton schoenleinii* est devenu très rare. En ce qui concerne l'espèce *Microsporum*, on a rencontré très rarement *Microsporum gypseum* alors que les autres représentants de cette espèce ont disparu.

**MIKROFLORA E INFKESSIONEVE PIOGJENE NË LËKURË
DHE NDJESHMËRIA E TYRE NDAJ ANTIBIOTIKEVË**

— MANTHO NAKUÇI — PAULINA GJURAJ — PETRIKA TROJA — LIRI KASA —

(Katedra e Higjenës dhe sëmundjeve ngjitëse, Klinika e Dermatologjisë
spitali nr. 1 — Tiranë)

Sëmundjet qelbzuese zënë një vend me rëndësi në strukturën e përgjithshme të sëmundjeve të lëkurës, qofshin këto në punën e përditshme ambulatore dermatologjike, qofshin në punën e përditshme të mje-
kut të përgjithshëm në fshat apo në qytet si edhe të mjekut të ndërmarrjes.
Nga përvoja e punës ambulatore dermatologjike del e qartë se rrëth
25-30% e të sëmurëve të paraqitur në poliklinikën qëndrore të Tiranës,
në repartin e dermatologjisë janë kryesish me piödermitë.

Ka autorë që flasin për një rritje progresive të infeksioneve stafilo-
koksite në fëmijë dhe të rritur (1). Stafilokokët faktoritativë patogenë
janë mjaft të përhapur në natyrë dhe vazhdimisht i gjejmë në lëkurë dhe
mukozat e njerëzve (8). Kur tërësia e këtyre mbulesave prishet, stafilo-
kokët mund të depertojnë në brendësi të indeve dhe, kur gjejnë kushte
të përshtatshme apo dëhe kur ulet rezistenca e makroorganizmit, mund të
shkaktojnë procese inflamatore (2). Infeksionet stafilokoksite takohen
më shpesh në persona të disa profesioneve, gjë që lidhet me mikrotraumat
apo me veprimin iritues të disa substancave (4).

Në vendet kapitalisto-revisioniste, sipas vetë të dhënave të tyre
dë te plota, ka një rritje gjithnjë e më të madhe të infeksioneve piogjene.
Tek ne, në sajë të rritjes së vazhdueshme të nivelit ekonomiko-shoqëror
e kulturor të masave tonë punonjëse dhe sukseseve që ka arritur mje-
kësia jonë në vitet e Pushtetit Popullor (7), kemi një ulje të numrit të
rasteve me piödermi. Për këtë flasin qartë të dhënat e piödermiteve
pranë klinikës së dermatologjisë në vitet e mëposhtme: në vitet 1932-
1944 ka qenë 18.7%, 1945-1954 ka qenë 10.7%, në 1955-1959 ka qenë
14.6%, dhe në 1976 ka qenë 5.9% (7).

Mbi rëndësinë e stafilokokut patogen, përhapjen e tij, infeksionet
që shkakon, etj. është folur në punime të tjera të mëparshme (9, 10).

QELLIMI I PUNIMIT

Në këtë punim duam të bëjmë një thellim të mëtejshëm në infek-
sionet patogene të lëkurës, të cilin jemi munduar ta arrijmë, duke u
ndalur në këto çështje: 1) Cila është flora bakteriale në të sëmurët me
piödermitë të shtruar në klinikën e dermatologjisë (44 raste); 2) cila
është flora bakteriale e piödermiteve në fëmijët me shkallë të ndryshme

të distrofisë të shtruar në spitalin distrofik «Justina Shkupi» (303) studimi i florës bakteriale në 10 fëmijë të kopshteve me pëc 4) cila është flora bakteriale e personelit të çerdhes distrofike (70).

MATERIALI DHE METODAT

Në radhë të parë si material studimi u përdorën 44 të sën shtruar pranë klinikës dermatologjike, nga të cilët në 30 prej tyre quan stafilokokë të artë. Në materialin e marrë nga fëmijët e kop në 10 fëmijë me piödermit, në 7 u veçuan stafilokokë të ar çerdhen distrofikë, materiali u muar nga 30 fëmijë që vuanin në dermi të ndryshme. Nga ky kontigjent u veçuan 24 shtame staf të artë. Si rezultat i një numri të lartë të piödermiteve në këtë i cion u bë e nevojshme të merrej si material studimi edhe nga pe i shërbimit shëndetësor, duke marrë material nga hunda, fytë dhe (materiali u muarr nga mjekë, infirmierë, kujdestare e punonjëse vanterisë). Nga 70 veta personel u veçuan 2 shtame stafilokokë të.

Nga të gjithë të sémurët që janë marrë në studim, materiali marrë dhe studjuar në këtë mënyrë: nga të sémurët me piödermit eshtë marrë me ansë bakteriologjike dhe pastaj eshtë m drejtpërdrejt në terrenin agar-gjak të përgatitur me 5% gjak da defibrinuar. Po kështu janë bërë mbjelljet edhe në terrenin agar-qu (të përgatitur me 30% qumësht).

Materiali nga fytë dhe nga hunda eshtë marrë me tampo eshtë mbjellë në terrenin agar-gjak ose agar-qumësht, në fill tampon dhe pastaj me ansë bakteriologjike. Materiali i marrë nga e personelit në fillim eshtë mbjellë në terren të lëngët, bujon n glukozë, duke u lënë për 24 orë në termostat në 37°C dhe pastaj rimbjellë në terrenet agar-gjak dhe agar-qumësht.

Metodika e punës ka qënë si vijon: për shtamet patogjene vënë re formimi i zonës hemolitike për rreth kolonisë bakteriale; për provën e plazmo-koagulazës eshtë vepruar në këtë mënyrë: eshtë mbjellja e shtamit në plazmë lepuri të citruar me 5% citrat natriun të holuar me tretësi fiziologjike, në raport 1 : 4. Leximi i kësaj eshtë bërë në intervalle prej 1 orë, 2 orë, 4 orë dhe 24 orësh. Si s patogjene janë konsideruar ato shtame, që koagulimin e plazmës në bërë deri në orën e katërtë të inkubimit të tyre në termostat në

Antibiograma eshtë kryer sipas metodës me disqe të ngopur prakisht me antibiotikë. Janë përdorur disqe me diametër 5 m ngopur me antibiotikët e ndryshëm, p.sh. disqet me penicilinë kar 10 unite/disk, kurse për antibiotikët e tjera janë përdorur disqe me mbajte të antibiotikut 50 gama/disk. Lëximi i rezultateve eshtë pas 24 orëve. Si shtame të ndjeshëm janë konsideruar ato mikrobi që njoë zonë inhibicioni (të pengimit të rritjes bakteriale) mikrobi madhësi më shumë se 3 m/m gjérësi.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Rezultatet e ekzaminimeve laboratorike të sipërmëndura para në pasqyrën nr. 1. Në të shohim se nga 302 ekzaminime të materi të marrura në studim, janë veçuar 113 shtame, nga këto 95 janë si

patogjene, prej të cilëve 85 janë stafilokokë të artë, 5 janë stafilokokë të artë dhe streptokokë beta hemolitikë (si dhe një shtamë *pyocianus*), 5 janë streptokokë beta hemolitikë, 10 janë stafilokokë të bardhë dhe 8 janë sterilë. Pra gjithë janë veçuar 95 shtame patogjene, ku vendin kryesor e të stafilokoku i artë me rreth 89.4% të rasteve.

Nga 84 ekzaminime të kryera në të sémurë me piödermi, janë izoluar 71 shtame patogjene (domethënë janë veçuar 61 shtame stafilokok i artë, 5 shtame stafilokok i artë dhe streptokok beta hemolitik dhe 5 shtame streptokok beta hemolitik. Nga këto ekzaminime, stafilokoku i artë eshtë veçuar në 85.9% të rasteve. Megjithatë, krahas shtameve patogjene, një rëndësi të veçantë kanë edhe stafilokokët fakultativë patogjene, të cilët janë shumë të përhapur në natyrë dhe gjenden vazhdimisht në lëkurë dhe në mukozat e njeriut (3). Nga 218 ekzaminime në pjerëz të shëndoshë, të kryer me material nga duart, hunda, fytë, perlënat, çarçafët, janë veçuar 24 shtame stafilokokë të artë. Pra eshtë e qartë se një mjedis i tillë krijon mundësi për infeksione stafilokoksike (5) dhe sidomos në një çerdhe distrofike, ku kemi fëmijë me një gjendje mbrojtjeje të ulët. Në materialin e marrur nga 30 fëmijë me piödermi, në 24 rezultuan me stafilokokë të artë.

Shtamet patogjene stafilokoksike të veçuar nga të sémurët e shtruar në klinikën e dermatologjisë, nga fëmijët e çerdhes distrofikë, nga kopshket si dhe nga personeli i shërbimit shëndetësor më tej u ekzaminuan edhe për ndjeshmërinë bakteriale ndaj antibiotikëve të ndryshëm si p.sh. ndaj penicilinës, streptomicinës, tetraciklinës, eritromicinës, kloramfenikolit, gabromicinës, kanamicinës, neomicinës. Pra u kryen edhe antibiogramat përkatëse.

Nga pasqyra nr. 2 shohim se kemi një rritje të rezistencës bakteriale ndaj antibiotikëve të ndryshëm. Gjithashtu vëmë re se rezistenca e shtameve të veçuar nga të sémurët me piödermi, që janë shtruar në klinikën e dermatologjisë dhe në spitalin distrofik, eshtë më e lartë për antibiotikët Penicilinë, Streptomicinë, Tetraciklinë, Eritromicinë, Kloramfenikol. Krejt ndryshe paraqitet rezistenca ndaj antibiotikëve Gabromicinë, Kanamicinë e Neomicinë. Për shtamet e veçuar nga të sémurët klinikës së dermatologjisë, rezistenca bakteriale ka qënë si vijon: nga 30 shtame të veçuar kanë qënë rezistentë për penicilinën 25, për streptomicinën 19, për tetraciklinën 18, për eritromicinën 11, për kloramfenikolin 29, kurse për Gabromicinën kanë qënë 7 shtame rezistentë, Kanamicinën 6 dhe Neomicinën 6.

Nga studimi i të gjithë shtameve patogenë të stafilokokut të artë, rezistenca bakteriale ka qënë si më poshtë:

Penicillina	55.3%	Gabromicina	16.4%
Streptomicina	67%	Kanamicina	10.5%
Tetraciklina	58.8%	Neomicina	8.2%
Eritromicina	72.9%		
Kloramfenikoli	98%		

PERFUNDIME

- 1) Gjatë studimit të këtij materiali del në pah mikroflora e infek neve të lëkurës dhe ndjeshmëria e tyre ndaj antibiotikëve të ndryshër
- 2) Infeksionet qelbzuese nga stafilokoku i artë janë mjaft të hapura dhe jo rrallë jepin edhe përhapje epidemike.
- 3) Nga kontigjenti i shtameve të ekzaminuar, 89.4% kanë q stafilokok i artë.
- 4) Stafilokoku i artë vëçohet edhe nga personeli i shërbimit si detësor dhe këto jo rrallë shërbejnë edhe si burim infekzioni.
- 5) Nga antibiograma e shtameve të vëçuara doli në pah edhe se biliteti i tyre ndaj antibiotikëve të ndryshëm.

Dorëzuar në Redaksi më 5 shkurt 1

BIBLIOGRAFIJA

- 1) Baer G. J. : Pathogenic Organisms and Infectious Diseases-Staphylococ infections. CIBA-Geigy, Basle 1971, 30.
- 2) Cruicshank R. : Médical Microbiology. Oxford 1970, 729.
- 3) Ćistović G. N. : Epidemiologija i Profilaktika Stafilokokovij Infekci. Lenin 1969, 10.
- 4) Bernard D. D., Renato D., Herman N. E., Harold S. G., Barry W. : Wood — crobiology — Staphylococci. New York 1970, 728.
- 5) Gaçe P., Gorica F., Jorgaqi P., Shehu T. : Studim mbi infeksionet post opera duke u bazuar në gjendjen e tyre në klinikën e parë të spitalit nr. 2 të ranës. Buletini i Studentit të Mjekësisë 1973, 1, 13.
- 6) Karagojozi P. : Mikroflora e ajrit dhe e dyshemesë së sallave të kirurgjisë. Letin i UT — Seria shkencat mjekësore 1963, 1, 48.
- 7) Nakuci M., Milo S., Hatibi Sh., Balla S. : Aspekte shqërore të sëmundjeve lëkurës. Studime dermatologjike. Tirane vol. VIII, 5.
- 8) Plaka Dh. : Përhapja e stafilokokut patogen ndërklinikat e spitalit nr. 1 Tirane. Shëndetësia Popullore 1968, 3, 32.
- 9) Plaka Dh. : Kontrolli i sallave të operacionit nga ana e laboratorëve bakteri gjikë. Shëndetësia Popullore 1971, 2, 61.
- 10) Troja P., Papajorgji M., Fito E. : Mbi florën, bakteriale brenda spitaleve. I tini i UT — Seria shkencat mjekësore 1977, 1, 75.

Pasqyra nr. 1

Ma erjali i marrë nga:	Numri i rasteve	Stafilokokus aureus	Staph. aur. bast. pyoc.	Streptococcus beta-hemolyticus	Staphyl. albus	Steril	Patogen	Shuma
Të sëmurë të klinikës dermatologjike	44	30	1	1	4	8	2	45
Fëmijë të kopshteve	10	7	4	1	2	—	12	14
Fëmijë sëmundjeve lëkurës	11	30	24	—	—	6	24	30
Ergjë Shumë	84	61	5	5	10	8	71	89
Ergjë person. distrik.	70	11	—	—	—	1	11	11
Ura e Dibart	70	7	—	—	—	—	7	7
Hunda	70	3	—	—	—	—	3	3
Fytit	—	—	—	—	—	—	—	—
Pelena	—	—	—	—	—	—	—	—
Carcafe	3	1	—	—	—	—	1	1
Shendështëse	—	—	—	—	—	—	—	—
Shuma	218	24	—	—	—	—	24	24
TOTAL	302	85/89.4%	5 + 1 pyo	5	10	8	95	113

Stafil. aureus te vecuar nga	Numri rastevje	REZISTENCA BAKTERIALE										Pasqyra nr.2					
		Penicillin		Streptom.		Tetraciklin		Eritromicin		Kloramfenikol		Gambromicinë		Kana.		Neomyc.	
		R	S	R	S	R	S	R	S	R	S	R	S	R	S	R	S
Të sëmuri nga klinik dermatologjike	30	25	5	19	11	18	12	11	19	29	1	7	23	6	24	6	24
Fëmijë te çerdhes distrofike	24	2	22	18	6	17	7	23	1	24	—	4	20	3	21	1	23
Fëmijë kopshesh	7	7	—	3	4	2	5	4	3	7	—	—	7	—	7	—	7
Personeli: Duar	11	7	4	9	2	5	6	11	—	11	—	—	11	—	11	—	11
Hunda	7	4	3	5	2	3	4	7	6	7	6	1	6	—	7	—	7
Fyti	3	—	3	—	3	2	1	3	—	3	—	—	3	—	3	—	3
Pelenat	3	2	1	3	—	3	—	3	—	3	—	2	1	—	3	—	3
Shuma	85	47	38	57	28	50	35	62	23	84	1	14	71	9	76	7	78
Përgindje	53.3%	67%	58.8%	72.9%	98%	98%	98%	98%	98%	98%	98%	16.4%	10.5%	10.5%	8.2%	8.2%	8.2%

Të dhënët e antibiotogramës jepen nëta tabelë Nr. 2

Summary**THE FLORA OF PYOGENIC SKIN INFECTIONS AND THE SENSITIVITY OF THE ORGANISMS TO ANTIBIOTICS.**

In view of the growing importance of staphylococcal infections in general and skin infections in particular, the authors have undertaken a study of the pyogenic bacterial flora of the skin. Examinations were carried out on patients with pyoderma, on patients at the hospital for hypotrophic children, on healthy children in nurseries and kindergartens and on the medical staff of the dystrophic hospital.

The isolated strains were tested for sensitivity to a series of antibiotics.

In conclusion the authors point out the need of intensifying the study of skin infections on the part of the dermatologists and microbiologists.

Résumé**LA MICROFLORE DES INFECTIONS PYOGÈNES DE LA PEAU ET LA SENSIBILITÉ DES ORGANISMES À L'ÉGARD DES ANTIBIOTIQUES**

Considérant l'importance accrue des infections à staphylocoques en général et des infections de la peau en particulier, les auteurs ont étudié la flore bactérielle pyogénique de la peau. A cette fin des investigations ont été effectuées chez des patients ayant des infections de la peau, parmi les enfants admis à l'Hôpital des dystrophiques, ainsi que chez les enfants sains des jardins et crèches d'enfants et le personnel sanitaire de l'Hôpital des dystrophiques.

Les souches isolées ont été soumises au test de la sensibilité à l'égard d'une série d'antibiotiques.

Et pour conclure, les auteurs indiquent que les microbiologistes et dermatologues doivent mener des études plus approfondies en ce qui concerne les infections de la peau.

the following morning, and the first day was spent in the same way. The second day was also spent in the same way, except that a long walk was made up the valley, and a number of specimens were collected. The third day was spent in the same way, except that a number of specimens were collected, and a number of photographs were taken. The fourth day was spent in the same way, except that a number of specimens were collected, and a number of photographs were taken. The fifth day was spent in the same way, except that a number of specimens were collected, and a number of photographs were taken.

WAN AN DE RECHTSOL. WERKSTADT HETT ANDORTS/DE AL
GEMEENTE PLEINEN. EN HIER HETTEKOMMEN VAN DE
WAN AN DE RECHTSOL.

to, incógnito no suspenderán la ejecución de las normas que el presidente estableció en el decreto que establece la prohibición de vender, en todo el territorio del país, todo tipo de armas y municiones y así, todo tipo de explosivos y artillería. Aunque el decreto cumple con lo establecido en la Constitución, el presidente tomó la decisión de no aplicar la medida porque no cumplió con los criterios establecidos en la ley para su aplicación.

NIVELI I MBROJTJES NDAJ FRUTHIT NË VITE PAS APLIKIMIT TË VAKSINËS SË GJALLË SHUMË TË DOBËSUAR

- EDUARD KAKARRIQI - ASPASIA BIFSHA -

(Instituti i Higjienës dhe Epidemiologjisë — Tirane)

Qysh nga viti 1971 né vendin toné éshtë vendosur vaksinimi i rregullt e i detyrueshém pér të gjithë fëmijét qysh nga mosha 9 muaj e jetës. Nga ana tjetër, që nga ky vit nuk éshtë vërejtur asnjë rast me fruth, ndonëse janë hequr masat karantinore, që nuk do të lejonin hyrjen e infeksionit nga jashtë. Po ashtu éshtë karakteristik fakti, që pothuaj téré kontigjenti, që përfshin grup-moshat 1956-1977 éshtë i mbrojtur vetëm në saje të vaksinimit, qoftë masiv gjatë epidemisë së vitit 1970-1971, qoftë të rregullt e të detyrueshém në vitet pasuese. Të tre këta momente, domethënë vaksinimi sistematik i planifikuar, prania pér 22 grup-mosha e mbrojtjes ndaj fruthit pothuaj vetëm në sajë të imunizimit aktiv dhe mungesa e qarkullimit të infeksionit natyral pas korrikut 1971, në ditët e sotme në vendin toné, krijojnë një situatë epidemiologjike disa të veçantë, që nxjerrë në pah një problem shumë të rëndësishém: ndjekjen e pandëprerë në vite të ecurisë së mbrojtjes pasvaksinale si-pas grup-moshave të ndryshme.

MATERIALI DHE METODA

Studimi ynë bazohet mbi ndjekjen pesëvjeçare (1975-1979) të nivelit të mbrojtjes pasvaksinale të grup-moshave 1956-1977 (22 grup-mosha). Gjatë kësaj periudhe janë grumbulluar dhe analizuar 5.069 serume, të ndarë sipas grup-moshave 1956-1977 nga 16 rrethe të vendit (Tiranë, Vlorë, Berat, Kukës, Dibër, Korçë, Pogradec, Gjirokastër, Sarandë; Gramsh, Tropoë, Pukë, Librazhd, Fier, Lushnjë, Shkodër).

- Për analizimin e serumeve u përdor reaksiioni i inhibimit të hemaglutinimit (RIA) i adaptuar si mikrometodë (8).

REZULTATET

Rezultatet e studimit të viteve 1975-1976, 1977, 1978 dhe 1979 iepen përkatësisht në pasqyrat nr. 1, 2, 3 dhe 4.


Në bazë të këtyre rezultateve le të shohim ecurinë e mbrojtjes për se cilin grup-moshe në vëganti në vazhdimesinë e viteve pas vaksinimit.

Grup-moshat 1956-1969, në studimin e viteve 1975-1976, për secilin grup në veçanti, paraqit mbrojtje në përgjithësi mbi 90%, ndërsa si mesatari e ponderuar, mbrojtja rezulton në nivelin 95,4%. Në nivel i tillë i lartë i mbrojtjes, në vitet pasuese të studimit (1977-1979), na lejoi që tërë këtë kontigjent ta marrim në studim si një grup të vetëm, «në tufë», duke pasur parasysh, megjithatë, një ndarje proporcionale të serumeve

sipas grup-moshave të përfshirë në të. Dhe ecuria e mbrojtjes rezulton nivelet 90,0%, 93,0% dhe 91,3% përkatësisht më 1977, 1978 dhe 1 (grafiku nr. 1).

Grup-mosha 1970, më 1975-1976 rezulton në mbrojtje 75,5%, nky që më 1977 ulet në 66,1%. Një shkallë të tillë disi të ulët të mbrojtj

Grafiku Nr.1 NIVELI I MBROJTJES NË % PËRKATËSISHT NË VITET E STUDIMIT 1975-1979



VITET E STUDIMIT


ECURIA E NIVELIT TE MBROJTJES NDAJ

FRUTHIT PER GRUP-MOSHAT

1956 - 1969

konsideruam si indikacion për rivaksinimin e kësaj grup-moshe. Për pa sojë, më 1977-1978 kryhet rivaksinimi i datëlindjes 1970. Niveli i mbrojtjes pëson një ngritje të dukshme; ai rezulton në 98,0% më 1978 dhe 90,3% më 1979 (grafiku 2).


Grafiku Nr.2



ECURIA E NIVELIT TE MBROJTJES NDAJ FRUTHIT PER GRUP-MOSHEN 1970

(Efekti i rivaksinimit më 1977)

Grafiku Nr 3



ECURIA E NIVELIT TE MBROJTJES NDAJ FRUTHIT PER GRUP-MOSHAT


~~~~~ 1971

--/-/-/- 1972

xxxxxx 1973

Për grup-moshat 1971, 1972 dhe 1973 vërehen luhatje të nivelit të mbrojtjes në një diapazon jo të vogël për rrethe të ndryshëm në të njëj-n vit studimi. Kështu më 1975-1976 për datëlinjen 1971, mbrojtja ihatet në nivelet 50,0% dhe 95,0%, me një mesatare të përgjithshme 7,0%; për atë 1972 në 45,0% dhe 85,0% me një mesatare të përgjithshme 69,0% dhe për grup-moshën 1973 në 46,0% dhe 82,0% me një

Grafiku Nr 4



### ECURIA E NIVELIT TE MBROJTJES NDAJ FRUTHIT PER GRUP-MOSHAT

~~~~~ 1974

--/-/-/- 1975

..... 1976

mesatare tē përgjithëshme 73,5%. Nga ana tjetër, nē vitet pasuese të s dimit (1977-1979) pér tē tri këto grup-mosha rezulton një prirje rritje tē nivelit mbrojtës, ndonëse janë tē pranishme luhatje tē ndjesh tē këtij niveli pér rrethe tē ndryshëm. Kështu më 1979, përqindja e mbi tjes pér grup-moshat 1971 dhe 1972 është nē rrëth 80,0% dhe pér 1973 nē 87,5%.

Studimi i gjendjes mbrojtëse pér grup-moshat 1974 dhe 1975 fil më 1978, vit nē tē cilin përqindja e mbrojtjes pér to rezulton si satare e përgjithshme nē nivelet përkatësish 82,0% dhe 88,3%. Më 1 këtë nivele u ulën nē vlerat 78,0% dhe 80,0% (grafiku nr. 3).

Grup-mosha 1976, e vaksinuar më 1977, nē studimin e vitit 1978 - 1979 ka dhëne vlera tē mbrojtjes specifike ndaj fruthit përkatësi 94,0% dhe 93,3%. Dhe ajo 1977, e vaksinuar më 1978, nē studimin e vitit 1979 rezulton me mbrojtje 96,8% (grafiku nr. 4).

Vlen tē theksohet se edhe pér datëlindjet 1974-1977 paraqiten luhatje tē niveleve mbrojtës pér rrethe tē ndryshëm nē tē njëjtin vit tē studimit, ndonëse diapazoni i këtyre luhatjeve nuk është aq i theksuar sa lartpërmëndur pér datëlindjet 1971-1973, ndërkohë, që pér tërësinë grup-moshave 1956-1969 tē tilla luhatje janë tē paspikatura, tē papërshtme.

DISKUTIM

Nga studimi i periudhës 1975-1979 rezulton se ecuria e nivelit i satar mbrojtës si Republikë pér kontigjentin e grup-moshave 1956-1 është pa luhatje tē mëdha dhe, nē përgjithësi, mbi 90,0%. Ishte përisht ky kontigjent i moshave 15 - 1 vjeç nē nëntor tē vitit 1970 pragu i shpërthimit të epidemisë së fruthit, që u përfshi nē vaksinë masiv (1). Mos vallë vetëm vaksinimi masiv është shkaku kryesor një nivel tē tillë tē lartë tē mbrojtjes? Mos vallë nga ky fakt duhej nxjerrim përfundimin se vaksina janë jep mbrojtje mbi 90,0% e 9 vjet pas aplikimit tē saj? Pér t'i dhëne një përgjigje mohuese pyetjet dytë nuk disponojmë tē dhëna tē sigurta. Ndërsa pér faktin real mbajtjes nē një shkallë tē lartë tē mbrojtjes specifike së grup-mosha 1956-1969, mendojmë, se duhet t'i drejtohem qarkullimit të virusit tē tē fruthit pér rrëth 7 muaj pas përfundimit të vaksinimit masiv (epidemia e vitit 1970-1971 u ndërpren nē korrik 1971 (1)), i cili, nē tē gjy subjektet e imunizuar nëpërmjet vaksinimit, luajti rolin e një përcuesi tē mbrojtjes, e një «rapeli» natyror, rol tē cilin nuk mund ta vëndësojë asnjë rivaksinim me vaksinën e gjallë shumë tē dobësuar fruthit.

Grup-mosha 1970 u përfshi nē vaksinimin masiv nē nëntor i takikë kjo plotësisht e justikuar dhe e drejtë pér situatën e në epidemiologjike kundrejt fruthit në pragun e shpërthimit të epidemisë. Por pér këtë grup moshe, ky vaksinim nuk dha efektin e duhur mbi (10), pér shkak tē nivelit ende tē lartë tē antikorpeve amësore nē fém e kësaj datëlindjeje, me moshë nën 6 muaj nē atë kohë. Prandaj vaksinohet më 1973 dhe megjithatë 3 dhe 4 vjet më pas, mbrojtja e saj grup-moshe rezultoi nē 75,5% dhe 66,1%, nivel ky i fundit, kërkoi një rivaksinim tē dytë më 1977-1978 pér tē rritur mbrojtje nē mbi 90,0%. A mos vallë nga ky fakt duhet tē nxjerrim përfundi

se vetëm 4 vjet pas vaksinimit me vaksinën tonë mbrojtja bie nën 70%?

Si përgjigje ndaj kësaj pyetje, jipim faktin se më 1979, mbrojtja pér grup-moshat 1974-1975 rezultoi nē rrëth 80%; pra pér këto dy grup-mosha, respektivisht 4 dhe 3 vjet pas vaksinimit, ndonëse nē kushte tē mungesës së kontaktit me infekzionin natyror, mbrojtja rezultoi nē rrëth 80%, nivel ky i kënaqshëm. Nga ana tjetër, datëlindjet 1971-1973, më 1979 rezultuan me mbrojtje respektivisht nē nivelet 84,3%, 80,8%, 87,5%, domethënë përkatësish 7, 6, 5 vjet pas vaksinimit, ndonëse po ashtu nē kushtet e mosqarkullimit tē virusit tē egër tē fruthit. Megjithatë, pér këto grup-mosha përmëndëm luhatjet e mëdha tē niveleve mbrojtës pér rrethe tē ndryshëm nē tē njëtin vit studimi, si dhe një prirje pér rritjen e nivelit mbrojtës nē raport me vazhdimesinë e viteve tē studimit (1975-1979). Këto luhatje dhe këtë prirje mund t'i shpjegojmë me rastësinë e tē hasurit tē kolektivave fëmijënore tē së njëjtës grup-moshe me shkallë tē ndryshme tē efektshmërisë së vaksinimit tē kryer nē tē njëjtën kohë, ç'ka pasqyron praninë eventuale tē defekteve nē vaksinim. Në veçanti pér grup-mosha 1973, shqyrtimi i kartelave tē vaksinimit jep praninë e një rivaksinim më 1976, i cili justifikon plotësisht nivelin mbrojtës prej 87,5% tē saj më 1979.

Në këtë studim ne kemi qëllim tē paraqesim ecurinë e mbrojtjes së grup-moshave tē ndryshme nē vite pas vaksinimit. Rezultatet e përfshitura, që paraqiten në pasqyrat 1, 2, 3, 4, dhe grafiqet 1, 2, 3, tregojnë kryesisht pér grup-moshat 1970-1975, luhatje tē mëdha tē niveleve mbrojtës, që flasin pér boshlliqe dhe defekte nē vaksinim. Prania e këtyre luhatjeve, si dhe natyra pak e veçantë e imunititet pasvaksinal tē grup-moshave 1956-1969, nuk na jipin mundësinë e përcaktimit me përpikmëri tē kohë-zgjatjes nē vite tē mbrojtjes pas aplikimit tē vaksinës nē raport me nivelin nē përqindje tē kësaj mbrojtje. Efektshmëria e një vaksine përcaktohet nga reaktogeniteti rezidual i saj dhe është e lidhur me fuqinë patogjene reziduale tē virusit vaksinal (4). Vaksina jönë kundër fruthit është e bazuar mbi një shtam tē gjallë shumë tē dobësuar, i cili ka një reaktogenitet tē ulët, por nga ana tjetër dhe një imunogjenitet jo tē lartë (8). Vaksina tē tjera simotra tē saj (nga shtame vaksinale tē natyrës shumë tē dobësuar), nē krashtsim me të, jipin reaksione klinike pasvaksinale disi më tē shprehura, por kanë dhe një aftësi imunogjene më tē madhe, tē spikatur jo nē drejtim tē përqindjes së serokonversionit pozitiv, por tē nivelit tē antikorpeve pas vaksinimit. Megjithatë, nē studimet me to, vlerat e përfshitura tē raportit ndërmjet kohë-zgjatjes nē vite tē mbrojtjes pasvaksinale me nivelin nē përqindje tē kësaj mbrojtjeje nuk janë tē njëjtë, madje dhe me tē njëjtën vaksinë kur studimi është planifikuar sipas metodës së «zgjedhjes së rastit». Kështu me shtamet shumë tē dobësuar L-16 dhe ESHC, antikorpet kanë qëndruar nē nivele mbrojtës nē mbi 60% (12) apo nē mbi 90% tē tē vaksinuarve (3) 7-8 vjet pas vaksinimit. Studime me shtamin shumë tē dobësuar Schwarz kanë treguar qëndrueshmëri tē antikorpeve nē nivele tē lartë 4 vjet (11) apo 6 vjet (5, 7) pas vaksinimit. Ndërsa, me po këtë shtam vaksinal, kur studimi nuk ka qënë planifikuar sipas metodës së «zgjedhjes së rastit», por me zgjedhje tē përcaktuar dhe nē një kontigjent shumë tē vogël fëmijësh, antikorpet kanë rezultuar nē nivelin 92% deri 14 vjet pas vaksinimit nē kushte tē mungesës së plotë tē kontaktit me infekzionin natyral gjatë tërë kësaj periudhe kohe (9).

Në dallim nga grup-moshat 1970 e pas, qëndrueshmëria e mbrojtjes në nivele të larta mbi 90% e tërësisë së grup-moshave 1956-1969 9 vjet pas vaksinimit, në studimin tonë, vërteton dyshimet në lëme vlerën me afat të gjatë të vaksinës së gjallë shumë të dobësuar reduktohet apo eliminohet efekti «rivaksinues» i ekspozimeve të përitura natyrore (2). Në infeksionin natyral, apo në përgjithësi, në kont me virusin e egër të fruthit, stimuli antigenik është më intensiv gjatë vaksinimit për shkak të përhapjes së virusit në të gjithë orë zmin. Për pasojë, në krijimin e mbrojtjes marrin pjesë më shumë c' imunokompetente (4, 6). Përveç kësaj, shumëzimi i virusit, në pje ndryshme të trupit, shkakton një përqëndrim më të lartë lokal të korapeve (7). Pra, ka një farë ndryshimi ndërmjet mbrojtjes pasvaks dhe asaj pas kalimit të sëmundjes apo pas kontaktit me virusin virus ndërkohë që vetë mbrojtja pasvaksinale, e përfstuar prej çdo lloj va me virus të gjallë të zbutur, pavarësisht nga shkalla e zbutjes së mbetet cilësisht e njëjtë.

PERFUNDIME

1) Për periudnën pesëvjeçare (1975-1979) është ndjekur ecu mbrojtjes pasvaksinale për grup-moshat 1956 deri 1977 nëpërmjet e zimit në total të 5.000 serumeve nga 16 rrethe të ndryshme të vendit.

- 10) Shipman Th. L.: Cas d'irradiation mortelle par surexposition, accidentelle massive à des neutrons et à des rayons gamma. Në «Diagnostic et traitement des radiolésions aiguës». Genève 1964, 131.
- 11) Upton A. C., Lushbuagh C. C.: The pathological anatomy of total body irradiation. Në «Atomic medicine. Baltimore 1969, 154.

Summary

PATHOLOGIC CHANGES IN EXPERIMENTAL ACUTE RADIATION DISEASE

The macroscopic and microscopic pathologic changes were studied in 54 animals (dogs) in which acute radiation disease was induced by exposure to doses of 400r (21 dogs), 500r (15 dogs) and 600r (18 dogs). The following conclusions were drawn:

- 1) The lesions caused by radiation were mainly of a diffuse hemorrhagic nature and were found in most of the body organs and systems; they could develop into pericarditis, lung edema, bleeding ulcers etc., which were observed by the authors.
- 2) The larger the dose of radiation, the shorter was the survival of the animals.
- 3) The longer the course of the illness, the more pronounced in size and number were the hemorrhagic lesions.

Résumé**MODIFICATIONS ANATOMO-PATHOLOGIQUES DANS
LES MALADIES EXPERIMENTALES DE L'IRRADIATION AIG**

Les auteurs du présent article ont étudié les modifications macro- et microscopiques chez 54 animaux (chiens), qui avaient manifesté la maladie de l'irradiation aiguë par suite de l'application de doses de 400 r (21 chiens), 500 r (15 chiens) et 600 r (18 chiens). Ils ont dégagé les conclusions suivantes:

- 1) Les lésions provoquées par l'irradiation sont constituées principalement par l'hémorragie diffuse dans la plupart des organes et systèmes de l'organisme. Les hémorragies peuvent évoluer en des péricardites, des œdèmes pulmonaire, des ulcères hémorragiques, etc, que les auteurs ont effectivement observés pendant leurs expérimentations.
- 2) Plus grande est la dose et plus vite survient la mort chez les animaux.
- 3) Plus longue est l'évolution de la maladie et plus marqués sont les dommages et le nombre des lésions hémorragiques.




Foto. 1: — Hemorragji masive e nyjave limfatike mezenteriale.



Foto. 2. — Hemorragji masive e zorrës së hollë, që ka kapur pjesërisht edhe mezenterin.



Foto 3. – Hemorragji masive e serozës së stomakut, që ka kapur edhe shtresat e tjera, kryesisht në kurvaturën e madhe në murin posterior.



Foto 4. – Hemorragji masive e stomakut, që ka kapur kryesisht mukozën me plikat e saj. Në disa zona ka vatra të theksuara hemorragjike me zhdukje të plikave të mukozës.



Foto 5. – Mëlçia paraqet zona hemorragjike kapsulare me ngjyrë kafe të errët e alteruar me zona të tjera me ngjyrë rozë.



Foto 6. – Hemorragji masive në indin dhjamor, që mbulon veshkën si edhe hemorragji subkapsulare.



Foto 7. – Hemorragji kryesish në aurikulen e djathtë si edhe një zonë në formë shiriti në miokardin e ventrikulit të djathtë.



Foto 8. – Vatra hemorragjike subpleurale në lobin e sipërmë të pulmonit.




Foto 9. – Vatra hemorragjike në pulmone.



Foto 10. – Vatra hemorragjike subkapsulare e veshkës.




Foto 11. — Vatra hemorragjike në miokard.




Foto 12. — Nekrozë e hepatociteve.

ANESTEZIA ME TIOPENTAL PËR TË OPERUARIT NË ORGANE TË BARKUT NË KIRURGINË EKSPERIMENTALE

— POLIZOJ SHQINA — MIHAL PRIFTI — QIRJAKO NAÇI —

(Instituti Kërkimor i Mjekësisë Ùshtarake — Tiranë)

Në punimet kërkimore kirurgjikale eksperimentale, problemi i anestezisë në të dëmtuarit rrezor ka një rëndësi të veçantë. Për këtë qëllim, shumica e autorëve (2, 3, 8) përdorin preparate barbiturike, të tjerë (7) rekamandojnë gërshtëmin e këtyre me Diazepam.

Punimet e shumta eksperimentale dëshmojnë se të gjithë llojet e njohura të narkozës, po të përdoren përpëra fillimit të sëmundjes së rrezes, nuk ndikojnë në rrjedhjen e saj (3). Në lidhje me përdorimin e preparateve barbiturike gjatë sëmundjes së rrezes ka një sasi të madhe punimesh eksperimentale, të cilat vërtetojnë se këto preparate kanë cilësi të njohura mbrojtëse kundër dëmtimeve rrezore (8, 12).

Në eksperimentet tona prej disa vjetësh po përdorim anestezit endovenozë me Tiopental, Rruga intraperitoneale (1) për metodikën që po paraqesim është e papërdorshme në kirurgjinë eksperimentale të organeve të barkut.

Qëllimi i këtij punimi është të paraqesim metodikën, arritjet si dhe standartizimin e dozave të këtij anesteziku në eksperimentet tona, të kryera në organet e barkut në kafshë të rrezatuara.

MATERIALI DHE METODIKAT

Eksperimentet janë kryer në kafshë (gen) me moshë rrëth 2 vjeç, me peshë mesatare 10.5 kg. Kafshët u ndanë në dy grupe. Në grupin e parë 21 kafshë u plagosën në bark me armë zjarri të kalibrit të vogël dhe pas kësaj u operuan; ndërsa në grupin e dytë 50 kafshë u rrezatuan me dozë 400 r, pas kësaj u plagosën dhe u operuan.

Pra në materialin që po paraqesim analizohet anestezia në 71 eksperimente të kryera në organet e barkut, si paraqiten në pasqyrën nr. 1.

Pasqyra nr. 1

Lloji dhe sasia e eksperimenteve

| Nr. rend. | Anestezia është përdorur për: | Numri i rasteve |
|-----------|-----------------------------------|-----------------|
| 1 | Rezekcion ose suturim të stomakut | 25 |
| 2 | Rezekcion ose suturim të zorrëve | 42 |
| 3 | Rezekcion zorre e splenektomi | 3 |
| 4 | Histerektoni | 1 |
| | Gjithsej | 71 |

Të gjithë eksperimentet janë kryer nën narkozë endovenozë fraksionuar) me tretësirë Tiopentali natriumi 2.5% dhe 0.1%. Tretësirë janë përgatitur në çast.

Premedikimi është bërë 30 minuta përpara fillimit të anestezisë tretësirë Morphini hydrochloridi 2% – 1 ml. tretësirë Atropin su 0.1% – 1 ml.. Të dyja bëhen në muskula.

Teknika e anestezisë. – Pasi kafsha është lidhur në tavolinën e operacionit, për të mos u rrezikuar nga ndonjë kafshim i rastit, tretësirë e parë e injektojmë në venën e kërcirit të njërsë nga anësitë e prap në të cilën është bërë trikotomia dhe është shtrënguar me tub gome të vizualizuar më mirë venën. Bëjmë punksionin e venës dhe gjatë -25 sekondave injektojmë nga tretësira e parë (2.5%) një dozë të a derisa kafsha të flerë dhe të jenë ulur reflekset korneale e pupilare.

Në këtë kohë hiqet gjilpëra nga vena e kërcirit dhe kafshës i pet pozicioni i duhur sipas llojit të eksperimentit që do të bëjmë; rastin tonë kafsha shtrihet në shpinë. Mandje punktojmë venën e lëcirit të anësisë së përparme dhe në të vazhdojmë perfuzionin pikant me tretësirën e dytë (0.1%) derisa të përfundojë ndërhyrja kirurgjikë.

Zgjim i kafshës nga narkoza bëhet gradualisht disa orë pas fillimi saj. Në shumicën e rasteve, për të shpejtuar zgjimin kemi përdorur trishtë Benegrid sipas nevojës.

REZULTATET E EKSPERIMENTEVE DHE DISKUTIMI I TYRE

Në eksperimentet tona, anestezia është realizuar vetëm me Tiopental, dhënia e të cilit është bërë e fraksionuar në këtë mënyrë: nga trosira e parë është dashur mesatarisht 17.6 mg/kg peshë trupore dhe gjaka ardhur pas 40-50 sekondash nga çasti i injektimit dhe ka vazhdisa minuta, kohë që është e mjaftueshme për rregullimin e kafshës në tavolinën e operacionit, për përgatitjen e fushës operatore dhe influençat e sistemit të perfuzionit për dhënien e tretësirës së dytë, në tila kemi përdorur mesatarisht 21.1 mg. kg. peshë trupore për çdo ndërhyrje kirurgjikale. Për çdo eksperimentim gjithsej është dashur mëtarisht 38.7 mg/kg peshë trupore. Kjo dozë është e përafertë edhe më dhënat e autorëve të tjerë (2).

Irigimin e tretësirës së dytë e kemi bërë duke llogaritur nga 30 në një minutë, në vartësi të studit të narkozës dhe reagimet që bën kanë gjatë eksperimentit. Në rastet kur kafshët kanë reaguar ndaj traumatorëve, kemi shpeshtësuar dhëni e pikave të tretësirës së dytë.

Në këtë mënyrë vazhdojmë anestezinë, duke pasur parasysh dhënia e dozës së dytë e shton së tepërmë efektin narkotik të dozës mëparshme të dhënë përnjëherësh (4, 5). Dihet se tiopentali, pasi i është qarkullimin e gjakut, shpërndahet në të gjitha indet e trupit. Aftësia ka ai të shkrihet me dhjamrat e lejon atë që të futet shpejt (me herë) në të gjitha indet, por meqënëse truri furnizohet me më shumë gjak arterial, rrjedhimisht dhe përqëndrimi i barit në të bëhet më i lartë. Zgjatja e frenimit qëndror varet nga rishpërndarja e barit nga trurët organet e brendshme (viscerale) dhe në indet e trupit. Kështu pas doze të vetme, përqëndrimi i Tiopentalit, përsa i përket trurit, bie shumë të pakthyeshme.

dhe frenimi qëndror dalëngadalë zhdukjet, pra zgjimi pas disa minutash vjen jo nga prishja apo eliminimi i tij nga organizmi, por është pasojë e zvogëlimit të përqëndrimit të tij në tru nga që shpërndahet në indet e tjera. Në rastin e kafshëve tona, pas injektimit të dozës së parë, gjumi vazhdoi 7-13 minuta.

Në rast se do të vazhdohet administrimi i Tiopentalit me perfuzion, përqëndrimi i tij do të bëhet i barabartë në të gjithë indet e organizmit. Në këtë gjendje, zgjimi do të kondicionohet jo më nga rishpërndarja e Tiopentalit nga truri në indet e tjera, por nga metabolizimi i tij në mëllçinë e zezë (6).

Për vlerësimin e efektivitetit së narkozës jemi orientuar nga reagimet e bëra në kafshë ndaj dhembjes së shkaktuar nga plagosja apo ndërhyrja kirurgjikale, konkretisht kontrollojmë ritmin e pulsit dhe të frymëmarjes, T A, reaksionet korneale e pupilare si dhe relaksimin e muskujve.


Në përgjithësi reagimet e kafshëve, gjatë eksperimentit, kanë qënë në vartësi të sistemit të tyre nervor. Në grafikët Nr. 1, 2, 3 paraqesim ndryshimet e parametrave puls, frymëmarrje dhe T A. Sikurse rezulton nga këto grafikë, në 68 raste nuk kemi pasur ndryshime të rëndësishme të këtyre parametrave; përvèç kësaj muskulatura e trupit të kafshëve ka qënë e relaksuar mirë. Duke qënë se këta tregues nuk ndikohen shumë nga traumat gjatë eksperimentit, kjo flet për kushtet e mira të kësaj narkoze.

Në dy kafshë ndodhi rrallim i frymëmarrjes. T A ra dhe reflekset e syrit (korneali e pupilari) u zhdukën krejtësisht. Këto ndërlikime erdhën si pasojë e mbidozimit të preparatit nga dhënia e shpejtë e tij; ato u mënjanuan me ndërprerjen e menjëershme të perfuzionit të Tiopentalit, me oksigjenimin e kafshës si dhe duke përdorur tretësirë Bemegridi, i cili është antidot i më i mirë në rastet e helmimit akut me barbiturikë (9, 11).

Gjatë eksperimenteve kemi pasur vetëm një rast ngordhje nga helmimi me Tiopental; kafsha ngordhi gjatë injektimit të tretësirës së parë ende pa e plagosur dhe pa filluar ndërhyrjen kirurgjikale, prandaj në mendojmë se ngordhja u shkaktua nga dhënia e shpejtë që çoi në mbidozim të preparatit në sistemin nervor, i cili, në këtë kushte, shkakton frenim të theksuar të qendrave me rëndësi jetësore (10), prandaj në këtë lloj narkoze duhet të tregohet kujdes i veçantë dhe të respektohen me rreptësi rregullat e parandalimit të ndërlikimeve të narkozës. Në këtë rast, megjithëse u morën masa energjike reanimatore, aksidenti shkaktoi humbje të pakthyeshme.

Në periudhën pas operatore, gjatë ditës së parë, kafshët në përgjithësi dukeshin të loddura, apatike, orientoheshin me vonesë dhe reagonin me përtësë, por këto kaluan shpejt.

Këto dukuri klinike kanë qënë më të shprehura në grupin e kafshëve të rrezatuara, megjithëse plagosja dhe ndërhyrja kirurgjikale u kryen me të njëjtën metodikë në të dy grupet. Në dy raste u vërejt gjumë i thellë dhe i zgjatur qysh në trajtim me Bemegrid, por gjendja e tyre u normalizua. Në 4 raste vumë re humbje të ekuilibrit, që kaloi pa ndonjë trajtim të veçantë. Kjo lloj patologjë u vërejt ditën e parë pas eksperimentit; të nesërmen këto kafshë nuk e kishin këtë çrrëgullim, megjithëse nuk iu bë ndonjë trajtim i veçantë.



PRFUNDIME

1) Anestezinë endovenoze me Tiopental ne e konsiderojmë si «anestesi e zgjedhur» për punën kërkimore kirurgjikale eksperimentale të organeve të barkut në kafshë të rrezzatuara (qen).

2) Narkoza endovenoze me Tiopental, sipas metodikës së pëershkruar, është e thjeshtë në përdorim, me leverdi ekonomike, sepse nuk kërkon aparaturë ose pajisje të vegantë, nuk angazhon shumë personel dhe narkotiku është me kosto të ulët. Përparësi të kësaj narkoze ne konsiderojmë fillimin e menjëherëshëm, zgjatjen e drejtuar dhe zgjimin e shpejtë.

BIBLIOGRAFIA

- 1) Adamsons R., Equit S.: The relative importance of sutures to the strength of healing wonds under normal and abnormal conditions. *Surg. Gyn. Obstr.* 1963, 117, 396.
- 2) Altura B., Mazzia V.: Microcirculatory approach to vasopressor therapy in intestinal ischemic shock. *Amer. J. Surg.* 1966, 111, 186.
- 3) Berkuton A. N.: Hirurgičeskaja obrabotka ran pri kombinirovanih porashenija. *Boeno. Med. Zhurnal* 1956, 1, 19.
- 4) Brunner E.: Anesthesia 203-204. Në *Text-book of Surgery*. Philadelphia 1972.
- 5) Gaçe P. e bp.: Kirurgjia e përgjithshme. Tirane 1973, Vol. I, 191.
- 6) Guadagni P.: Current surgical diagnosis and treatment. California 1977, 176.
- 7) Henry X.: L'anesthésie générale du lapin en recherche chirurgicale digestive. *Journal de chirurgie (Paris)* 1977, 4, 437.
- 8) Hromov B. M.: Kombinirovaniye ilucevije porazhenija. Moskva 1959.
- 9) Kokalari P. e bp.: Farmakologjia. Tirane 1974, 52.
- 10) Preza B.: Toksikologjia klinike. Tirane 1973, 407.
- 11) Roçi P., Sima Z.: Udhëzues i specialiteteve farmaceutike. Tirane 1973, 72.
- 12) Simeone F.: Atomic bomb injuri Medical injures. *JAMA* 1951, Vol. 147, 1658.

Summary

THIOPENTAL ANESTHESIA IN OPERATIONS ON THE ABDOMINAL ORGANS IN EXPERIMENTAL SURGERY

Intravenous thiopental anesthesia applied in the fractional method in 71 experiments on dogs treated with radiations for surgical interventions on abdominal organs is discussed. In 68 of the dogs, the pulse, blood pressure and breathing were little affected by the anesthesia.

In view of the results obtained by this type of anesthesia, the authors recommend it for experimental work in the field of abdominal surgery.

Résumé

INTERVENTIONS ABDOMINALES PAR L'ANESTHÉSIE AU THIOPENTAL DANS LA CHIRURGIE EXPÉRIMENTALE

Dans cette communication il est question de l'application de l'anesthésie intraveineuse au Thiopenthal à travers la méthode fractionnée dans 71 essais chez des chiens irradiés pour l'intervention chirurgicale dans les organes abdominaux. Au cours de ces expérimentations la pulsation, la pression artérielle et la respiration chez 68 chiens n'ont été que légèrement influencées.

Compte tenu des résultats obtenus avec ce type d'anesthésie, les auteurs du présent article recommandent son application à des fins expérimentales dans le domaine de la chirurgie abdominale.

**TE DHENA PRAKTIKE DHE EKSPERIMENTALE MBI PERDORIMIN
E JOSHEZAVE ME FOSFUR - ZINK NE LUFTEN KUNDER
BREJTESAVER**

— LLAZI ANDREA — MISTO ÇOLI —

(Instituti i Kërkimeve Mjekësore Ushtarak — Tiranë)

Në literaturën mjekësore nga shumë autorë (3, 4, 5) theksohet roli që luajnë brejtësit si rezervuarë, burim dhe përhapës të infeksionit për shumë sëmundje gjitëse dhe parazitare, si p.sh. tulareminë, murtajën, leptospirozat, tifomurin etj. dhe, nga ana tjetër, si dëmtues të ekonomisë, që dëmtojnë prodhimet ushqimore, drithërat në arë, depot e ushqimit, vesh-mbathjes, rrjetin telefonik, mallrat industriale etj.

Duke pasur parasysh sa më sipër del nevoja e domosdoshme të përcaktohen mjetet më të efektshme të luftës kundër këtyre dëmtuesve si dhe përdorimi racional i mjetave të luftimit në kushtet e vendit tonë.

Vendimet historike të Partisë dhe veganërisht ato të Plenomit të XI të KQ të PPSH dhe Kongresit të 7-të të PPSH, na orientojnë që në themel, të shërbimit shëndetësor të qëndrojnë masat profilaktike. Lidhur me këto orientime dhe mësimë edhe në luftën kundër brejtësave, përparsi duhet t'u jebet masave profilaktike, në të cilat përfshihen masa sanitaro-higjenike dhe masa sanitaro-teknike, duke siguruar mbrojtjen e lokaleve nga depërtimi i brejtësave, mbajtjen e pastërtisë kudo e kurdoherë, ruajtjen e prodhimeve ushqimore dhe të burimeve të ujit, sigurimin e mbeturinave ushqimore në vende ose enë të posaçmë, prerja e shkurreve ose ferrave përreth qendrave të banuara, depove etj. si dhe zënia e të gjitha vrimave me çimento e copza xhami në të gjitha lokalet.

Në vendin tonë gjenden këta lloj brejtësash (3):

1) Sinantrop, ku përfshihen speciet *Rattus Norvegicus* (miu i hirtë), *Rattus-rattus* (miu i zi) dhe *Mus-musculus* (miu i shtëpisë). Këta brejtësa jetojnë në qendrat e banuara.

2) Asinantrorp, ku përfshihen speciet *Apodemus sylvaticus* (miu i pyjeve), *Apodemus tauricus*, *Apodemus Flavicollis* (miu me gushë, të verdhë e miu i vogël), *microtus* (miu i tokës). Këta brejtësa jetojnë në fusha, pyje, pranë rrjedhjes së ujrave dhe futen në qendrat e banuara rastësisht. Në raste invazioni mund të hidhen nga agresorët gjatë përdorimit të armës bakteriologjike.

Në punimin që po paraqitim duam të përcaktojmë efektin raticid të fosfurit të zinkut në kushtet tona, duke e përdorur në formën e joshëzave helmuese. Fosfuri i zinkut është një raticid, i cili, duke u marrë brejtësit me anën e joshëzave helmuese, pënn veprimin e acidit klor-

hidrik të stomakut, çliron hidrojenin fosforik; ky shkakton hel akut në sistemin nervor qëndror dhe qarkullimin e gjakut. Reakështë ky:



Lidhur me dozën, autorë të ndryshëm (2, 3, 5) jepin të dhën ndryshme. Kështu p.sh. disa rekomandojnë përdorimin e fosfurit të gut në doza 1-15 gr. për 100 gram prodhime ushqimore, që, pavarë nga sasia e ngrënë e ushqimit, miu të marrë dozën vdekje-prurëse. I autorë rekomandojnë dozën 3-5-6 gr., të cilën e kemi preferuar edhe Gjithashu ne kemi pasur parasysh të përcaktojmë joshëzat që dëpëdoren në vartësi të natyrës së lokalit, përqëndrimin e tyre si afatin e përdorimit optimal të tyre.

Për kryerjen e eksperimenteve në laborator përdorëm 36 min bardhë (*Mus-musculus*), 18 minj të kanaleve (*Rattus norvegicus*) 18 minj të laboratorit (*Rattus-Rattus*). Minjtë e vegjël u morën me pafersisht 40 gram, ndërsa minjtë e mëdhenj u morën me peshë afers 200 gram.

Fosfurin e zinkut e përdorëm:

a) në formën e joshëzave me miell gruri, vaj vegjetal ose gjipas kësaj recepture:

Të dhëna praktike dhe eksperimentale mbi përdorimin e joshëzave kundër brejtësave

| Miell gruri | Vaj ose gjalpë | Fosfur-zink | Ujë |
|-------------|----------------|-------------|-----|
| 92 | 5 | 3 | 50 |
| 90 | 5 | 5 | 50 |
| 85 | 5 | 10 | 50 |
| 80 | 5 | 15 | 50 |

b) Grurë i përgatitur i përzjerë me 2% solucion amidon dhe fosfur zink sipas teknikës së njohur.

c) Grurë i përgatitur si në pikën «b» por i parafinuar.

Minjtë u vendosën në kafaze të veçantë dhe pasi u lanë 48 orë ushqim, në mënyrë që konsumimi i joshëzës të ishte i detyruar, në tүnë respektivisht sasira të caktuara të joshëzave 5 gr., 2 gr. dhe 0.5 për çdo mi, sipas përqëndrimeve të provës me fosfurin e zinkut.

Për të dy grupet e minjve (si për të vegjëlit, ashtu dhe për mëdhenjtë) si bazë u muar doza vdekje-prurëse e fosfurit të zinkit 150 mgr/kg. peshë nga koncentrati 3%, që është plotësisht e mjafshuesh të jepë vdekjen e plotë.

Rezultatet tonë: — Nga provat laboratorike të kryera minjtë, duke përdorur joshëzë të përgatitura me 15, 10, 5, dhe 3% foszinku, me përbajtje përkrahësish 300, 200, 100; 80 dhe 60 mgr/l peshë për minjtë e vegjël dhe 750, 500, 250, 200 dhe 150 mgr/kgr. pes-

për minjtë e mëdhenj, rezultoi se në të gjithë përqëndrimet, ngordhja u arrit 100% në kohën 12-24 orë pas ngrënies së ushqimit (*shih pasqyrën nr. 1*).

Iabela №1

Prova biologjike në laborator në minjtë e vegjëllimus) për përcaktimin me të efektshëm të Zn_3P_2 në Joshez

| Nr. Brejtësive
më përsëri | Peshë e
brejtësise | Peshë e
Joshezit
me gr./m² | % e Zn_3P_2 që u përdoruan | | | | | mortallitet
më ore | % e
mortallitet | |
|--|-----------------------|----------------------------------|--|-----|-----|----|----|-----------------------|--------------------|--|
| | | | 15 | 10 | 5 | 4 | 3 | | | |
| <i>Përbajtja e Zn_3P_2 në mgr</i> | | | | | | | | | | |
| 3 | 40 | 2 | 300 | - | - | - | - | 12 | 100 | |
| 3 | 40 | 2 | - | 200 | - | - | - | 12 | 100 | |
| 3 | 40 | 2 | - | - | 100 | - | - | 12 | 100 | |
| 3 | 40 | 2 | - | - | - | 80 | - | 14 | 100 | |
| 3 | 40 | 2 | - | - | - | - | 60 | 14 | 100 | |
| K3 | 40 | 2 | - | - | - | - | - | - | - | |

Prova biologjike krahasuese në minjtë RATI për përcaktimin e koncentrimit të Zn_3P_2 në Joshez

| Nr. brejtësive
më përsëri | Peshë e
brejtësise | Peshë e
Joshezit
me gr. | % e Zn_3P_2 që u përdoruan | | | | | mortallitet
më ore | % e
mortallitet | |
|--|-----------------------|-------------------------------|--|-----|-----|-----|-----|-----------------------|--------------------|--|
| | | | 15 | 10 | 5 | 4 | 3 | | | |
| <i>Përbajtja e Zn_3P_2 në mgr</i> | | | | | | | | | | |
| 3 | 200 | 5 | 750 | - | - | - | - | 12 | 100 | |
| 3 | 200 | 5 | - | 500 | - | - | - | 12 | 100 | |
| 3 | 200 | 5 | - | - | 250 | - | - | 12 | 100 | |
| 3 | 200 | 5 | - | - | - | 200 | - | 12 | 100 | |
| 3 | 200 | 5 | - | - | - | - | 150 | 14 | 100 | |
| K3 | 200 | 5 | - | - | - | - | - | - | - | |

Për përcaktimin e dozës minimale të përdorimit të fosfurit të zinkut në joshëz dhe për të arritur një rezultat të efektshëm pa konsumuar sasira të mëdha fosfur zinku në joshëz, ne zvogëluam sasinë e joshëzës, duke ruajtur përqëndrimin. Në këto raste minjve ne u vendosëm jo më 2 gr. apo 5 gr. joshëz, por 0.5 gr., e vlefshme për derativimin e lokaleve për m^2 me përbajtje respektive të fosfurit të zinkut 75, 50, 25 dhe 15 mgr, si për minjtë e vegjël ashtu dhe për mëdhenjtë.

Duke ndjekur vdekshmërinë në kohë, sipas pasqyrës nr. 2, del se minjtë e vegjël ngordhën për 12-36 orë, ndërsa minjtë e mëdhenj për 16-72 orë.

Tabela N^o 2

Prova biologjike për përcaktimin e dozës letale në përdorimin praktik

| Nr. brejtësive
në provë | Pashë e
Bretësirë | Pashë e
Joshëzave/gjëm | % e Zn ₃ P ₂ që u përdor | | | | | Mjedisë
ore me
mortalitet | % e
mortalitet | |
|--|----------------------|---------------------------|--|----|----|----|----|---------------------------------|-------------------|--|
| | | | 15 | 10 | 5 | 4 | 3 | | | |
| Përmbytja e Zn₃P₂ në m.g.r. | | | | | | | | | | |
| 3 | 40 | 0.5 | 75 | - | - | - | - | 12 | 100 | |
| 3 | 40 | 0.5 | - | 50 | - | - | - | 14 | 100 | |
| 3 | 40 | 0.5 | - | - | 25 | - | - | 18 | 100 | |
| 3 | 40 | 0.5 | - | - | - | 20 | - | 24 | 100 | |
| 3 | 40 | 0.5 | - | - | - | - | 15 | 36 | 100 | |
| K3 | 40 | 0.5 | - | - | - | - | - | - | - | |

Prova biologjike për përcaktimin e dozës letale në përdorimin praktik.

| Nr. brejtësive
në provë | Pashë e
Bretësirë | Pashë e
Joshëzave/gjëm | % Zn ₃ P ₂ që u përdor | | | | | Mjedisë
ore me
mortalitet | % e
mortalitet | |
|---|----------------------|---------------------------|--|----|----|----|----|---------------------------------|-------------------|--|
| | | | 15 | 10 | 5 | 4 | 3 | | | |
| Përmbytja e Zn₃P₂ m.g.r. | | | | | | | | | | |
| 3 | 200 | 0.5 | 75 | - | - | - | - | 16 | 100 | |
| 3 | 200 | 0.5 | - | 50 | - | - | - | 24 | 100 | |
| 3 | 200 | 0.5 | - | - | 25 | - | - | 36 | 100 | |
| 3 | 200 | 0.5 | - | - | - | 20 | - | 52 | 100 | |
| 3 | 200 | 0.5 | - | - | - | - | 15 | 72 | 100 | |
| K3 | 200 | 0.5 | - | - | - | - | - | - | - | |

Sipas të dhënave të pasqyrës nr. 2 del se joshëzat përbajnjë shufishin e dozës letale për minjtë e vegjël, ndërsa për minjtë e mëdha përbajnjë dozën minimale letale deri në 2.5 fishin.

Nga këto të dhëna rezultoi se minjtë e vegjël, duke marrë josh me fosfur zink 3% në sasi 15 mgr/kg peshë ngordhën pas ngrënies joshëzave plotësisht për 36 orë, ndërsa po kjo dozë e përdorur për një e mëdhenj jep ngordhshmëri të plotë pas 72 orësh.

Gjatë provave në laborator, në përgatitjen e joshëzave, vumë rrej joshëzat e përgatitura sipas pikës «a» konsumoheshin mirë nga brejtësia e parë, efekti maksimal i ngrënies së tyre ishte deri në 7 ditë. Pas ditën e parë, efekti maksimal i ngrënies së tyre ishte deri në 7 ditë. Pas tës së shtatë, ato nuk konsumoheshin më nga brejtësia, kurse joshëzat e përgatitura sipas pikës «b» konsumoheshin mirë deri në dy muaj; joshëzat e përgatitura sipas pikës «c» të parafinuara e ruanin efektin e ngrënieshëmrisë mbi tre muaj.

Për të nxjerrë të dhëna të përpikta mbi praktik të joshëzave të përgatitura me fosfur zink dhe për të ndihruar rëjësitë e reparteve, kaluan nga rezultatet e punës laboratorike në provat e terrenit.

Në provat e terrenit kemi pasur parasysh të dhënat e disa autorëve (3, 5), që rekomandojnë përdorimin e joshëzave nga 3-15%, duke llogaritur 0,5 gr. joshëzë për M². Gjithashu në mjediset ku nuk ka njerëz, si depo veshmbathje, gazerimi etj. preferuam përdorimin e grurit të helmuar me fosfur zinku me përqëndrim 4%. Ndërsa në të gjitë rastet e tjera përdorëm joshëza të përgatitura me miell gruri, vaj ose gjalpë dhe fosfur zinku në dozat 3, 5 10 dhe 15%. Në disa lokale që parashikuam vendosjen e joshëzave u bënë kapje minjsh me çarqe për të krijuar një ide mbi densitetin e popullatës së brejtësave.

Në të gjithë mjediset, joshëzat u vendosën tre muaj pas heqjes së çarqeve, në këtë mënyrë, sipas të dhënavë të literaturës, popullata e brejtësave është përafërsisht e pandryshuar.

Vrojtimet tonë mbi konsumimin e joshëzave me fosfur zinku i përkasin një periudhe tre vjeçare dhe përfshijnë 78 eksperimente praktike. Rezultatet përfundimtare paraqiten në pasqyrën nr. 3.

Tabela N^o 3

Rezultatet mesatare të provave në terren mbi konsumimin e joshëzave në Zn₃P₂

| Lloji | % e Zn ₃ P ₂ të përdorur në joshëz | | | | |
|-------------|--|----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|
| | 3 | 4 | 5 | 10 | 15 |
| Lokalit | % mësuar
e konsumit
joshëz | % mësuar
e konsumit
joshëz | % mësuar
e konsumit
joshëz | % mësuar
e konsumit
joshëz | % mësuar
e konsumit
joshëz |
| Fjetina | 3 66.3 | - | - | 5 69 | 4 39.7 |
| Iep V-mbath | 9 73.6 | 6 68 | 6 53.4 | - | - |
| Iep gazarë | 1 73 | 1 875 | 2 75.2 | 1 70.8 | - |
| Tuneli | 3 70 | - | - | 1 79 | 1 71 |
| Ofrisina | - | 2 78 | 1 85.5 | 2 62.5 | 2 76.5 |
| Spitalë | 2 31.5 | - | 4 67.2 | 1 50 | 4 34.75 |
| Zyra | 1 39 | - | - | 1 25 | - |
| Rk-Hapje | 1 53 | 3 84.3 | - | 1 74 | - |
| 3az Lundi | - | 2 87 | - | - | - |
| Anije | - | - | 3 84.6 | - | - |

Nga të dhënat e konsumit mesatar të joshëzave në mjediset e ndryshme rezultoi se: në depo veshmbathje e gazerimi konsumohen më tepër joshëzat që përbajnjë 3% fosfur zinku, e barabartë kjo me 73-73.6% të konsumit. Në fjetina konsumohen më mirë joshëzat që përbajnjë 5% fosfur zinku e barabartë kjo me një konsum 69%, ndërsa joshëzat që përbajnin 10 e 15% fosfur zinku konsumoheshin më pak nga brejtësia. Në depo pa ushqime u konsumuan më mirë joshëzat e përgatitura me grurë të helmuar me 4% fosfur zinku dhe dhanë një

konsum 84.3%, ndërsa në depot e gazermimit 87.5%. Në anije radë dokë përdorëm vetëm grurë të helmuar të përgatitura me 4% foszinku. Nga vrojtimet tona në këto mjjedise, rezultoi një konsumim 84-87%. Të dhënët paraqiten në pasqyrën nr. 3.

Sic shihet në pasqyrë, rezultatet më të mira sigurojnë përdorimin joshzave që përmbajnë 30% dhe 50% fisfur zinku. Ndërsa në mjetin ku lejohet të përdoret gruri i helmuar jep efekt më të mirë përqëndrues 40% i fosfurit të zinkut.

PERFUNDIME

1) Fosfuri i zinkut rezulton të jetë një raticid i efektshëm në lumen e brejtësave të gjinisë *Rattus* dhe mus në përqëndrimin 3-5%. Përqëndrimet më të larta se 5%, konsumi i tij nga brejtësit është i vogël rrjedhimisht edhe zhdukja e tyre është më e kufizuar.

2) Sasia optimale e vendosjes pér deratizimin e mijediseve të mbyra në formën e joshëzave të përgatitura me miell rezulton 0.5 gr. M². Doza vdekje-prurëse pér mus musculus rezulton 6 mgr/kg peshëndërsa pér Rattus-rattus e Rattus Norvegicus 30 mgr/kg peshë. Në rast e parë, ngordhja e plotë sigurohet pas 36 orëve, në rastin e dytë 72 orëve.

72 oreve.
3) Joshëzat e përgatitura me grurë të helmuar me ose pa paraf konsumohen nga brejtësit deri në 3 muaj, ndërsa joshëzat e përgatit me miell konsumohen deri në 7 ditë.

4) Në të gjitha mjediset, ku lejohet përdorimi i joshëzave të përgatitura me grurë rezultatet më të mira janë arritur në përdorimin kohë të gjatë (deri 3 muaj) të 4% të fosfur zinkut të veshur me parafinë.

Dorëzuar në Redaksi më 20 qershor 1

BIBLIOGRAFIA

- 1) — Arma bërthamore dhe mbrojtja kundër saj. Tiranë 1969.
 2) Jazikov D. : Derratizacia. B. M. E., 1958, Vol. 8, 1066:
 3) Kerro A. : Epidemiologjia e përgjithshme e speciale. Tiranë 1972, Disp
 e parë, 159.
 4) — Udhëzim i Ministrisë së Shëndetësisë mbi D.D.T. Tiranë 1973, 96.
 5) Voskov V. J. : Dezinfektacia dezinsektacia i derratizacia. 1956, 608.

S u m m a r y

EXPERIMENTAL AND PRACTICAL RESULTS IN THE USE OF ZINK-PHOSPHIDE BAITS IN THE CONTROL OF RODENTS.

Laboratory tests on mice were carried out using baits prepared with 15, 5, and 3 percent zink-phosphide, corresponding approximately with 300, 200, 80 and 60 mg/kg body weight for mice and with 750, 500, 250, 200 and 150 mg/kg body weight for rats. The result was that all the above concentrations caused death within 1

24 hours in 100 percent of the animals. By reducing further the dose of the bait, the mice died within 12 to 36 hours and the rats within 16 to 72 hours.

The results of the experiment show that

- Zink phosphide is an efficient ratticide in concentrations of 3-5 percent. Higher concentrations reduce the consumption of the baits and the baits and the effect of the conyrol of rodents.

— Baits prepared with poisonde grain, with or without paraffine, are acceted by the rodents for three months, while baits prepared with flour are effective for only 7 days.

Résumé

DONNÉES PRATIQUES ET EXPÉRIMENTALES SUR L'EMPLOI DES APPATS AU ZINC-PHOSPHITE DANS LA LUTTE CONTRE LES RONGEURS

Des essais de laboratoire ont été effectués avec des souris en employant à cette fin des appâts préparés à 15, 10, 5 et 3% de zinc-phosphite, correspondant approximativement à 300, 200, 100, 80 et 60 mg/Kg. de poids pour les souris et à 750, 500, 250, 200, et 150 mg/Kg. de poids pour les rats. Résultats: les concentrations mentionnées plus haut ont provoqué la mort de cent pour cent des animaux dans un intervalle de temps de 12 à 24 heures. En diminuant la dose de l'appât, les souris sont morts au bout de 12-36 heures et les rats au bout de 16-72 heures.

Ces résultats montrent que le zinc-phophite est un raticide efficace dans la lutte contre les rongeurs dans une concentration de 3 à 5%. Les concentrations supérieures à 5% ne donnent pas de bons résultats, du fait que les rats ne mangent pas l'appât et le raticide perd son effet. Par ailleurs, les appâts prêts préparés avec des grains de froment empoisonnés avec de la paraffine ou sans celle-ci sont consommés par les rongeurs jusqu'à 3 mois, alors, que les appâts préparés avec de la farine ne sont consommés que jusqu'à 7 jours.

KUMTESA

NJE RAST ME INSULINOMË I OPERUAR ME INTERES DIAGNOSTIK E TERAPEUTIK

BESIM ELEZI, HEKTOR PEÇI, HODO ÇELA, SHAHIN KADARE, MANUEKE-

Insulinoma është një tumor adenomatoz i qelizave beta të pankreasit. Duke prodhuar insulinë me sasi të madhe, ajo shkakton kriza hipoglicemie episodike spontane. Megjithëse insulinoma është tumori më i shpeshtë i qelizave ishullore, përsëri ajo mbetet një patologji e rrallë. Insulinoma ndeshet më shpesh midis moshës 35-55 vjeç; rastet nën moshën 15 vjeç janë shumë të rralla dhe 25% e të sëmurëve kanë një histori familjare për diabetin e sheqerit. Qysh nga operacioni i parë, i kryer për një tumor të pankreasit, të shoqëruar me hiperinsulinizëm më 1927. e deri në vitin 1958 në literaturë janë raportuar 766 insulinoma, nga të cilat 753 janë operuar (4). Një autor (9) ka vënë re se 10% të rasteve të tij kanë qënë malinj.

Në vitin 1978 kemi pasur rastin e një të sëmure me insulinomë të diagnostikuar në shërbimin e endokrinologjisë të spitalit klinik nr. 1 dhe të operuar në klinikën e III të spitalit klinik nr. 2. Kjo patologji e rrallë simulon shumë sëmundje dhe sindroma klinike, që, po të diagnostikohet me kohë, me gjithë vështirësitet që ka gjatë dhe pas operacionit, mund të shërohet plotësisht me gjetjen dhe heqjen e tumorit.

E sëmura S. SH. vjeç 42, dërgohet nga rrathi i Gjirokastrës në shërbimin tonë. E sëmura paraqet shenja hipoglicemie probabël nga hiperinsulinizmi për përcaktim diagnoze.

Sëmundja i kish filluar qysh në vitin 1977, me ndjenjë të fiki dhe errësimë episodike të vetëdijes, me djersitje të përgjithshme, marrje mëndsh, dhembje koke, dobësi fizike e mungesë përqendrimi, që e linin të sëmurën me gjendje shpirtërore të deprimuar. Me kalimin e kohës, gjendja vinte duke u rënduar. E sëmura filloj të ankonte për turbullim të pamjes, shikim të dyfishtë të objekteve, njolla të errta para syve, si dhe për turbullime nervore periferike me ndjenjë mpirjeje të anësive, që, në disa raste, përfshinin të gjithë trupin. Nga mjekët neurologë, ankesat e të sëmurës konsideroheshin me karakter funksional.

Në maj 1977, në mëngjes esëll, e sëmura pati një dhembje të fortë koke, të shoqëruar me djersitje të përgjithshme, të dridhura deri në konvulsione, që zgjatën 4-5 orë. Atake të tillë mëngjezore të sëmurës iu përsëritën çdo 10-20 ditë, derisa në maj të vitit 1978 shtrohet në spitalin e rrithit (në repartin e neurologjisë) me vetëdije të humbur dhe hemiparezë të anës së djathjtë. Turbullimet nervore qëndrore me hiperrefleksi osteotendinoze, me prani të Babinskut të paraprirë me atake konvulsive të përsëritura, u interpretuan për një atak epileptik. Por një-

kohësht u vu re se e sëmura kishte glicemi të ulët 30-50 mlg% dhjetra fitimin e saj, rolin kryesor e luanin perfuzionet e vazhdurave të glukozit.

Në shërbimin e endokrinologjisë në Tiranë u vunë re gjithash tu amengjerez me humbje të vetëdijes, që kalonin duke i bërë perfume glukozë në venë. Në ekzaminimin klinik, përvëç shenjave të përgjishme dhe atyre nervore (neuro-vegetative e qëndrore) nuk u vurën turbullime kardiovaskulare, respiratore e gastrointestinale. Gjithash sëmura nuk kishte turbullime endokrino-metabolike. Ajo nuk ishte dhe nuk kishte turbullime të sferës gjenitale, madje vitin e kalu bë ndërprerja terapeutike e një shtatzënie 12 javëshe.

Në ekzaminimet plotësuese, përvëç hipoglicemive mëngjëzore të nuk u vu në dukje shmangje nga norma. Vetëm radioskopia gastronome vuri në dukje një zgjerim vertikal të U-së duodenale, që nuk iustifikua gjatë laparatomisë.

Në kërkimet biologjike për vërtetimin e hiperinsulinizmit parasysh pasojat metabolike të hiperinsulinizmit, kryesisht rënia e cemive. Gjatë ankesave për dobësi trupore si dhe gjatë atakeve rënda me humbje të vetëdijes, glicemitë mëngjerezore tregojnë se, në micën e rasteve, ato janë nën 50 mg\% , kështu p.sh. glicemitë esëllë në orët e ndryshme të ditës për disa ditë rresht paraqiten si më posh

8.5.1978 50, 60, 45, 45, 30 mg⁰/₀
 9.5.1978 25, 30, 140, 230 mg⁰/₀ (gjatë perfuzionit me glukozë
 10.5.1978 50, 25, 45 mg⁰/₀
 30.5.1978 67, 120, 40 mg⁰/₀
 2.6.1978 50, 60, 55 mg⁰/₀

Në provën e ngarkesës me glukozë të marrë nga goja (1 gr. glu për kg/peshë trupore) u vu re se rënia e glicemisë ishte e shpejtuar në minutën e 90-të keqësoi gjendjen e të sëmurës me një hipoglicem rëndë.

Glicemi në mg% 50, 160, 120, 40
 Koha në minutë 0,0 30, 60, 90

Të dhënët që ne dispononim, sidomos nivelet e ulta të glicemikave atakat hipoglicemike, dinamika e glicemisë me ngarkesë orientoninë gnozën përmë tepër drejt një tumori të qelizave ishullore të kreasit.

Më 10.6.1978 e sëmura transferohet në klinikën e III te spitalit për ndërhyrje kirurgjikale.

Më 15.6.1978 e sëmura merret në operacion me diagnoze «istmë». Para, gjatë dhe pas operacionit, e sëmura mori perfuzione të kozës. Me anestesi të përgjithshme andotrakeale eter, oksigjen e relaksante bëhet laparatomë mediane superiore e zgjatur majtas, bursa omentale dhe revizionohet pankreasi dhe zonat e mundshme lokalizimit ektopik të tumorit të dyshuar. Në buzën e poshtme të bëhet pankreasit preket dhe shihet një masë e vogël sa një lajthi me nukleotidë të errët e inkapsuluar dhe pjesërisht e eksteriorizuar, serozi, me disa vaza të vogla të tejdukshme në sipërfaqe. Tumorenklohet me lehtësi dhe defekti serotizohet. Në bursën omentale

dy drena gome në afërsi të zonës së tumorit të hequr. Shtresat qepen. Si gjatë operacionit, ashtu dhe gjatë zgjimit nuk pati ndërlikime.

Pas operacionit, e sëmura u trajtua me antibiotikë sedativë dhe perfuzione të glukozës. Tri ditë pati temperaturë të lartë dhe 5 ditë temperaturë subfebrile. Për 10 ditë rrrohën disa sekrecione serosanguinolente nga drenat me prejardhje ndoshta nga pankreasi, pasi u shoqëruan me një macerim të lëkurës për rreth. Glicemja, e ndjekur rregullisht çdo 4 orë gjatë ditëve të para, u normalizua ditën e 10-të, pas një ngritje të pakët deri në shifrat $178 \text{ mg}^{\circ}/\text{o}$. Pas ndërprerjes së perfuzioneve të glukozës, glicemja, u ul në $100 \text{ mg}^{\circ}/\text{o}$. Në këto shifra dhe më ulët glicemja qëndroi edhe në ekzaminimet e mëpastajme. E sëmura dolli nga spitali e stabilizuar. Në këtë gjendje u gjet edhe në kontrollin e bërë më vonë.

DISKUTIM

Problemet e diagnostikimit dhe mjekimit të insulinomës janë komplekse: klinike, biologjike, etiologjike, terapeutike. Simptomatologja kushtëzohet nga hiperinsulinizmi dhe karakterizohet nga mbizotërimi i shenjave neuropsikike. Kjo bën që këta të sëmurrë, në shumë raste, të trajtohen gjatë në klinikat neuropsikiatrike. Subjektet me adenomë ishullore, vëren një autor (9), fillimisht vizitohen nga neuropsikiatritët dhe mbeten të sëmurrë të këtyre specialitetëve për muaj apo vite. Simptoma të tjera me karakter nga më të ndryshmet të bëjnë të gabosh apo të vonohet vënia e diagnozës.

Siq u pa nē anamnezë, rasti ynë ishte një subjekt që pér më tepër se një vit qéndroi e u trajtua pa sukses pér sémundje neurologjike. Kur sémundja mbetet e pa diagnostikuar pér një kohë të gjatë, pas disa vjetëve mund të shfaqen pasojat neurologjike të karakterit kronik. Të tilla mund të jenë: sindrome pseudo-bulbare, ekstra-piramidale, koreo-atetozike. Në këtë drejtim duhet të na térheqin më tepër vëmëndjen tri she-nia kryesore:

- Neuropatia hipoglicemike sensitive e anësive.
 - Amiotrofia distale e shoqëruar me parestesi (reflekset janë të ruajtura dhe elektromiograma e tipit neurogjen).
 - Gjendja psikike me prishje të fakulteteve intelektuale, që mund ta coinë deri në demencë.

Sipas një autorit (3), megjithëse shenjat më të shpeshta që vihen re janë turbullimet okulare, psikike, konvulsionet dhe koma, gabimisht këto raste mund të trajtohen për sëmundje të aparateve të ndryshme.

Për turbullime digestive: ndjenjë urie të shoqëruar me dhembje që kalojnë me të ngrënë, që simulojnë dhembjet pseudoulceroze. Në disa raste është vënë re, në mënyrë paradoksale, se mungon dëshira për të ngrënë, shfaqen gromësira, nauze, të vjella e hematemezis.

Për turbullime kardiovaskulare mjaft polimorfe: kriza takikardie, dhembje prekordiale, shpesh me karakter angjinoz të palidhura me efortin, turbullime të ritmit, tromboza të koronareve, anomali të EKG-ve.

Për turbullime respiratore: bradipne, kriza astmatike, hemoptizi, edemë pulmonare akute.

Për turbullime endokrino-metabolike: obezitet me origjinë nga ushqimi

mi, rrallë obezitet endokrin, azospermji, turbullim të menstruacion shqërim me tumore të tjera endokrine (tiroide, hipofizë, paratiro Këto shenja mund të gjenden tek i njëjtë person gjatë ecurisë së së ndjes ose të shkëputura.

Punimet klasike të Conn si dhe të autorëve të tjera (1, 8) mbi moret hipoglicemizuese ekstra-pankreatike kanë ndihmuar shumë në ferencimin e formave të ndryshme të hipoglicemisë. Sipas një ai (7), shkaqet e hipoglicemive spontane mund të radhitën si më posht (7), shkaqet e hipoglicemive spontane

Të lidhura me tumore të qelizave Beta

- Tumore të qelizave beta
- Hiperplazi e qelizave?
- ndjeshmëri ndaj leucinës

Shkaqe të tjetra

- Sëmundje të heparit (përfshi forma të glikogjenozave e gala zemisë)
- Hipopituitarizëm
- Sëmundja Addison
- Tumoret mezoteliale
- Hipoglicemitë infantile
- Hipoglicemitë nga alkooli
- Hipoglicemia funksionale – për hipoglicemitë post-rezekcion-verkuli.

Diagnoza diferenciale e tyre do të jetë hapi i parë i rëndësisë për të përcaktuar drejt trajtimin. Për insulinomën, triada simptomatil Whipple (2) duhet të jetë një kusht gati i domosdoshëm për të vendosur imazhin kirurgjikal tek të sëmurët. Rikujtimi i elementeve të kësaj triade do të ishte i dobishëm për të rritur vigjilencën dhe përpikmë diagnostike:

I) Atake të «shokut insulinik», që vijnë pas gjendjes së urisë ushtrimeve fizike dhe shfaqen me shenja neuropsikike ose vaskulare.

II) Glicemia gjatë atakut ose 24 orë pas ngrënies duhet të jetë $50 \text{ mg}/\text{dl}$.

III) Simptomat duhet të lehtësohen menjëherë pas dhënies së kozës nga goja ose në venë.

Të tre këto elemente janë vënë re edhe tek e sëmura jonë. Përvënë në dukje këto simptoma mund të jetë e nevojshme kërkimë gjicemisë pas ushtrimeve fizike, lënje me dietë të caktuar apo në ndje agjërimi të zgjatur. Në rastin tonë nuk u desh lënia për tri ditë dietën e rekomanduar nga Conn (7) me 1200 kalori (50 gr. glucide, 80 proteinë) dhe as agjërimi për 72 orë (vetëm me kafe e çaj pa shëqer) praktikuar nga disa autorë (9), sepse gjicemitë përgjithësisht qëndrojnë ulja dhe për të ruajtur vetëdijen e të sëmurës duhej të vazhdohej perfuzione glukoze.

Gjatë kërkimeve në dinamikë të gjicemisë (prova e hiperglicemisë provokuar), mund të studjohet edhe dinamika e insulinosekrecionit adenoma me metodën imunoradioaktivë.

Insulinemia bazale përgjithësisht gjendet e lartë ose përkrahësisht e lartë (5), sepse edhe kur gjendet në shifra rreth normës, në krahasim me gjicemitë shumë të ulta, përsëri ajo është e lartë. Sipas një autorit (3), insulinemia bazale, 40 mikro-unite për ml/plazëm, mund të jetë normale për një gjicemi $100 \text{ mg}/\text{dl}$, por shumë e lartë për një gjicemi $50 \text{ mg}/\text{dl}$. Kur nuk ka mundësi për përcaktimin e insulinemisë, mund të mjaftohemi me të dhënat e gjicemive në dinamikë, por ajo duhet bërë pasi subjekti të vendoset me një dietë të caktuar për tri ditë (me 350-400 gr. karbohidrate) dhe matjet e gjicemive (çdo 30 minuta) të vazhdojnë për më tepër se 4 orë, sipas disa autorëve (3) deri më 6 orë.

Studimi dinamik i insulinosekrecionit mund të bëhet me provën e tolbutamidit në venë (1 gr. të shkrirë në 20 ml. uje distile); me glukagon (1 mg. në muskul ose në venë); me aminoacide (leucinë 0,15 gr. për kg/peshë trupore në venë), të cilat konsiderohen të rëndësishme përvénien, e diagnozës në hipoglicemitë organike.

Për diagnostikën topike të tumoreve, arteriografia selektive ka saktësuar shumë përcaktimin e lokalizimit të tumoreve, duke e bërë më të përpiktë edhe ndërhyrjen (4). Ndërkaq, shintigrafia me lëndë radioaktive e pankreasit le për të dëshiruar, sepse tumoret përgjithësisht janë në përmësa në më pak se 2 cm.

Për ndërthurjen e problemeve diagnostike e mjekuese, që shtrypnë një insulinomë, flet në mënyrë të tèrthortë edhe statistika përbledhëse e disa autorëve (4). Sipas këtyre të dhënavëve, nga 453 të sëmurë të operuar, në 165 prej tyre nuk është gjetur tumori gjatë operacionit të përfunduar me rezekzion të verbër distal të pankreasit. Në 36 pjesë të rezekuara është gjetur tumori i fshehur në parenkimë, ndërsa në 30 të sëmurë të operuar, adenoma është gjetur në ndërhyrjen e dytë ose të tretë. Në 99 të sëmurë nuk është gjetur fare tumor, megjithëse gjysma e tyre janë konsideruar si të shëruar ose të përmirësuar. Një rast i tillë është raportuar në vendin tonë (2). Në këtë rast, hiperinsulinizmi u trajtua me sukses me rezekzion korporokaudal të pankreasit, pa identifikuar tumorin në të.

Në rastin tonë, edema lokalizohej në bishtin e pankreasit, që, sipas një autorit (6), përbën lokalizimin më të shpeshtë. Tumori kishte përmësa $1,4 \times 1 \text{ cm}$. me formë deri diku vezake, i rrethuar me një kapsulë fibroze të pa infiltruar në tërë vazhdësimin e tij. Në prerje masa kishte ngjyrë të verdhë në kafe.

Mikroskopikisht, formacioni tumoral përhëhet nga qeliza të ngjashme me qelizat ishullore pankreatike, të vendosura në formë folesh, me strukturë të qartë acinare. Grupimet e qelizave tumorale rrethohen nga një kapsulë fibro-konjunktivale, që, në disa zona, paraqitet e infiltruar nga qelizat tumorale, që nuk paraqesin atipizëm.

Nga ana morfollogjike nuk është e mundur të bëhet një dallim i prerë midis insulinomave malinje dhe beninje, sepse edhe karcinoma insulinarë paraqet një shkallë të ulët atipizmi dhe infiltrimi të qelizave tumorale dhe ruptura e kapsulës nuk është provuar të jetë një kriter i besueshëm malinjiteti. Diagnoza e karcinomës nuk duhet vënë në qoftë se mungojnë prova të qarta të pranisë së metastazave ose të invadimit lokal të lëndës pankreatike. Në një studim të bazuar në afro 400 raste, një autor (6) ve në dukje mospërputhjen e diagnozës histologjike.

patologjike me ecurinë klinike në 45 të sëmurë, që morfologjikisht isë malinje, por klinikisht beninje. Në këtë studim nuk përmenden ato rreth që klinikisht ishin malinje, por morfologjikisht beninje.

Përcaktimi i ecurisë biologjike të insulinomës vetëm me vlerë min histologjik, në shumicën e rasteve, është i pamundur. Gjithashtu është tepër i vështirë, në mos i pamundur, dallimi morfologjik i insulinomave alfa dhe beta qelizore. Ngjyrimi me aldehid fuksinë mund të ndihmojë, por jo gjithnjë.

Sic del nga përshkrimi i historisë së sëmundjes, përgatitja preoperatore, teknika kirurgjikale, ecuria dhe ndjekja pas operacionit është bërë sipas kërkave të rastit dhe situatave të krijuara dhe nuk jep veçanti të rendësishme përfundimtare.

E vlen të theksohet edhe një herë domosdoshmëria e një drezhi eficent të llozhës pankreatike përfundimtare apseset dhe fistulat pankreatike. Bashkëpunimi i ngushtë me endokrinologun, mbikqyrja vazhdueshme klinike dhe biokimike si dhe dhënia pa ndërprerje dhe pas nevojave e perfuzioneve të glukozës janë kushte të rendësishme të siguruar suksesin. Diagnostikimi i hershëm mund të kryhet lehtë qoftë se mjekët do të njohin elementin themelorë të klinikës së kësaj sëmundje. Tumoret multiple dhe sidomos lokalizimet ektopike të që përbëjnë rrëth 9% të rasteve, mund të vështirësojnë diagnozën traoperatore dhe zgjedhjen e taktilës së drejtë. Pankreatektomia e porokaudale e verbër duhet të gjiej zbatim gjithnjë e më të pakët përmirësimin e diagnostikës topike preoperatore me anë të angiografisë.

Dorëzuar në Redaksi më 10 shtator 1979.

BIBLIOGRAFIA

- 1) Dorf G. et coll.: Hypoglicémie sévère au cours d'une maladie de Wlensti. Le diabète 1973, 21, 3, 137.
- 2) Gaçja F., Bala A., Doçi S., Zogu V., Thanasi B.: Punime kirurgjikale. Tiranë 1977, III, 12.
- 3) Linquette M. et coll.: Hyperinsulinismes. Précis d'endocrinologie 1973, 676.
- 4) Maingot R.: Abdominal operations. Apperilon century Crofts 1969, 743.
- 5) Plauchu M. et coll.: Etude au long cours des sécrétions insuliniques dans les observations d'adénome langerhansien. Le diabète 1972, 2, 61.
- 6) Robins S. L.: Pathology. W.B. Saunders 1967, II, 980.
- 7) Skjoldborg H. and coll.: Diagnosis and treatment of Pancreatic beta-cell tumor. Surgery annual 1975, 10017, 219.
- 8) Teitelbaum H. et coll.: Tumeur hypoglycémique extra-pancréatique associée à un néosiodioblastome pancréatique. Le diabète 1969, 4, 251.
- 9) Williams R. H.: Hypoglycemia and hypoglycemas. Textbook of endocrinology. Philadelphia 1968, 827.

Summary

AN OPERATED CASE OF INSULINOMA AND ITS DIAGNOSTIC AND THERAPEUTIC INTEREST

The paper describes the case history, the examinations and successful operation of a 40 year old woman who for the previous two years had been treated for a neuropsychic illness.

The macroscopic and microscopic examinations identified an adenoma in the caudal part of the pancreas. After the operation the patient became well, her blood sugar returned to normal and remained normal for the three years of observation after the operation.

Résumé

UN CAS D'INSULINOME OPÉRÉ ET L'INTÉRÊT QU'IL PRÉSENTE DU POINT DE VUE DIAGNOSTIQUE ET THÉRAPEUTIQUE

Dans cette communication, les auteurs décrivent l'historique de la maladie, le mode d'examen utilisé pour établir le diagnostic et l'intervention chirurgicale qui a donné des résultats satisfaisants chez une femme âgée de 40 ans, qui pendant deux ans avait été traités pour une maladie neuropsychique.

Les examens macroscopiques et microscopiques ont montré une adénome dans la partie caudale du pancréas. Après l'opération, la patiente s'est rétablie et la glycémie est rentrée dans la norme, ce qui a été relevée même au cours d'un contrôle trois ans après l'opération.

从以上分析可知，本研究中所用的量表具有良好的信效度，可以用来评估我国大学生的自我效能感。

卷之三

and the other two were the same as the first. The last was a small, dark, irregularly shaped mass, which was easily separated from the others.

and presented to the public and children. This is a great opportunity for our community to come together and support our local schools.



Foto 1. — Grupe qelizash tumorale të vëndosura në formë grupesh të vogla alveolare, të ndara nga stromë e pakët fibroze mjaft e vaskularizuar




Foto 2. — Po ajo pamje. Zmadhim më i fugishëm.




Foto 3. – Dallohet mirë kufiri midis indit tumoral dhe indit normal pankreatic. Në këtë të fundit vihen re fenomene të atrofisë kompresive.




Foto 4. – Pamje nga zona e kapsulës fibroze e infiltruar nga grupet e qeliz tumorale.

NJË RAST BAKTERIEMIE NGA SHIGELLA SONNEI

— DHIMITËR KRAJA — VIOLETA MOSKO — ATHINA GOROSHIANI —

(Spitali Klinik nr. 4 dhe Laboratori Bakteriologjik i spitaleve)

Disenteria bakteriale zakonisht i përqëndron dëmtimet anatomo-patologjike në pjesët e fundit të zorrës së trashë. Por shigelat nuk shkaktojnë gjithmonë të njëjtin kuadër morfollogjik dhe klinik. Për më tepër, lezonet anatomo-patologjike nuk vendosen gjithnjë në këtë pjesë të traktit tretës. Kështu nuk janë të rralla rastet, sidomos në moshat e vogla, kur preket edhe zorra e hollë (3,5,6,12), ose kur mund të mungojnë fare lezonet e zorrës (3). Prandaj sot, për të cilësuar shfaqjet e ndryshme patologjike të shkaktuara nga këto enterobakterie përdoret termi shigelozat (8, 11).

Klasifikimi i enteropative bakteriale, sipas mikroboeve shkaktarë dhe mënyrave të vendosjes, zhvillimit dhe zgjidhjes së infeksionit, i përmbledh shigelat në grupin e dytë të tij, domethënë në ata mikrobe, që, pasi formojnë një lidhje sipërfaqësore me mukozën e zorrës, arrijnë të depërtojnë pastaj brenda qelizave. Pasi shumëzohen e invadojnë *lamina propria mucosa* e shigelat fillojnë të japin dëmtimet karakteristike, ulcerat superficiale të zorrës (12). Kjo konsiderohet dhe thellësia madhe që mund të arrijnë shigelat gjatë depërtimit të tyre në orga nizmin e njeriut.

Në raste të rralla, lezonet mund të prekin edhe shtresën muskulare të zorrës, që është karakteristike për formën difterike të kolitit shigelozik (4); të arrijnë deri në serozë e të shkaktojnë perforacione të murit të këtij organi (forma ulçeronekrotike) (3,7). Mund të vërehen edhe dëmtime të limfonodulave mezenteriale (3), ku një autor (cituar nga 9) ka izoluar shigela.

Për shigelozat karakteristike është mungesa e bakteriemisë (2, 3, 6, 7, 14). Madje shumica e autorëve (5,6,7,8,12) nuk flasin fare për bakteriemi nga shigelat edhe kur përshkruajnë ndërlikimet e ndryshme të shigelozave. Mekanizmi patogenetik i shigelozës ekstra-intestinale mendohet të jetë toksik apo toksiko-alergjik. Përkundrazi ka mundësi që gjatë kësaj sëmundje të depërtojë në gjak një mikrob tjetër si p.sh. aerobakteri (8), që bëhet shkak për lindjen e një infeksioni të kryqëzuar (3), që rëndon gjendjen.

Megjithatë zbulimi i shigelave në gjak mund të jetë i mundshëm (2,8,9,10,11,13), pavarësisht se konsiderohet si një ngjarje absolutisht e jaشتëzakonshme (6).

Në këtë punim do të vemë në dukje këtë mundësi të shigelave, duke i ilustruar edhe me rastin e ndjekur prej nesh. Nga gjaku i një të së-murë, në Laboratorin Bakteriologjik të Spitaleve, u izolua shigela Sonnei.

PARAQITJA E RASTIT

E sëmura L. G., vjeç 55, pensioniste (arsimtare), shtrohet në spilin nr. 4 më 7 tetor 1978 me diagnozë gastroenterit akut me kartelë nukleike nr. 2614.

Anamneza e sëmundjes: prej rrith para një muaji ndjente dokdhembje spastike të pa lokalizuara në një vend të barkut, herë pas kish diare me mukus të alternuar me kapsllék si dhe temperaturë vazhdueshme subfebrile. Për këto shqetësimë ish trajtuar si një kronik post dizenterik me mexaform, sulfaguanidinë, vitamina dhe trip duke pasur një farë përmirësimi. Ditën e shtrimit pati acarinë gjendjes: temperaturë deri në 38.3°C , të vjella ushqimore dhe më vështirësi i biliare si dhe disa shkarkime diaroike me pak mukus pa gjak.

Anamneza e jetës: kishte kaluar sëmundjet e fëminisë pa ndërli me. Një vit e gjysëm më parë ka qenë e shtruar për dizenteri bakter klinikisht. Nga spitali dolli në gjendje të mirë shëndetësore. Pas muajsh iu shfaqën shenjat e para të një koliti, për të cilin ishte mjek me tetraciklinë, kloramfenikol, rovakol, laksative me një farë për rësimi.

Në spital, nëpërmjet ekzaminimit objektiv u hasën këto ndryshat patologjike: gjuha e veshur, pak e thatë, me disa çarje transvers ulje të respiracionit në bazën e mushkërisë së djathë, ku dëgjohej zhurma të ngjashme me krepitacionet; barku pak meteorik, pa shëtëritimit peritoneal; zmadhim i kufijve të mëlçisë (sipër deri në bu e poshtme të brinjës së V në vijën medioklavikulare, poshtë arr 2,5-3 cm, nën harkun brinjor), që paraqitej me konsistencë të shtuar pak e dhembshme në prekje, koloni në përgjithësi i dhembshëm gpalpimit të tij, me gurgullima, pjesa zbritëse e tij dhe sigma i spastike.

Të dhënët laboratorike: Eritrocitet 4.560.000, Hb 70% , sediment mm/orë, Leukocitet 9200 (segmente 72% , eozinofile 1% , bazofile shkopinj 2% , limfocitet 13% , monocite 10%), disa neutrofile ki granulacione toksike. Fosfatazo alkaline 4,4 u, fibrinogenemia 660 m mukoproteinat 256, acidi sialik 42; në elektroforezën e proteinave serumit u vërejt ulje e albuminave deri në 51% dhe rritja alfa-2 bulinave deri në 14% .

Ekzaminimet ndihmëse: radioskopia e kraharorit tregoni ngjallat të të dy diafragmave me zvogëlim të ekskursionit të tyre, sk gastrointestinale vinte në dukje një transversoptoze dhe segmenti kontrastit, pa leziona të mukozës dhe me evakuacion normal; re romanoskopia paraqiste ndryshime të konsiderueshme: deri në 25 vëreheshin vaza të trashura, mikroulceracione, granulacione të vteku-tuk sufuzione hemorragjike të mukozës apo zona të zbehta atrofë edemë e pakët rrith ulceracioneve.

Meqë në qendër të kuadrit klinik qëndronte një gjendje sep e shprehur nga një temperaturë të zgjatur (skica nr. 1), kujdes i vëç iu kushtua kulturave bakteriale. Kështu koprokulturat, urokulturat bilikultura rezultuan negative, ndërsa hemokultura vuri në dukje shigella Sonnei.


Paraqesim metodikën e punës të përdorur për izolimin dhe id-

fikimin e këtij mikrobi: u mbollën 7 ml. gjak në 70 ml. bujon në kushte sterile. Terreni i mbjellë u vendos për inkubim në temperaturën 37°C dhe u kontrollua çdo ditë për rritje. Në ditën e pestë, vumë re se ai paraqitej i turbulltë, për këtë arsyе u kalua në terrenin DC, Kristenzen, Hajni dhe agar 2% . Pas 20 orë inkubimi në terrenin DC, lëxuan kulturë të pastër në koloni të dyshimta për shigela. Edhe në terrenin Hajni vumë re karakteristika, që flisin gjithashtu për shigela. Kristenzeni rezultoi negativ. Meqë izolimi i shigelave në gjak është jashtëzakonisht i rrallë, u vazhdua studimi bakteriologjik deri në përfundim. Prandaj nga agarkultura u bë aglutinimi në xham më serumë aglutinante me të gjitha llojet e shigelave. Rezultoi se shtami i dyshimtë të aglutinojë shumë mirë me serumet aglutinante për shigella Sonnei. Më tej puna u vazhdua me përcaktimin e vetyve biokimike të shtamit në fjalë (shih skicën nr. 2). Në bazë të të dhënave biokimike dhe sérologjike u konkludua se shtami ishte shigella Sonnei i variantit shigela Sonnei, që zberthejnë ksilozën. Këtij shtami iu bë prova e ndjeshmërisë ndaj gjashëtë antibiotikëve (tetraciklinës, streptomicinës, kloramfenikolit, neomicinës, kanamicinës, eritromicinës) me metodën e disqeve të imprenjuar. Të dhënët e antibiogramës treguan se shtami ishte rezistent ndaj të gjithë antibioticëve të provuar.

Më vonë të sëmurës iu shfaqën dhembje të forta në epigastër dhe në hipokondrin e djathtë, që kishin karakter shpues dhe ishin të vazhdueshme. Pas konsultës me kirurgun, e sëmura transferohet në spitalin klinik nr. 2 ku i bëhet laparotomia meqë u mendua se ndodheshim përparrë një patologji mundësish malinje të heparit. Biopsia tregoi se kishim të bënim me një adenokarcinomë multiple të këtij organi.

Skica nr. 1

Grafiku i temperaturës gjatë qëndrimit në spital



Skica nr. 2

Karakteristika biokimike të shigela Sonnei në përgjithësi (a) dhe ato të shtë izoluar nga hemokultura (b).

| | Glukoz | Mannit | Laktоза | Sacharоза | Dulcitet | Adonit | Inositol | Glykozid | Arabinose | Xylose | Rhamnose | Salicina | Indol | Citrat | Citrat | Citrat | Citrat | Citrat |
|---|--------|--------|---------|-----------|----------|--------|----------|----------|-----------|--------|----------|----------|-------|--------|--------|--------|--------|--------|
| a | + | + | + | + | - | - | - | + | - | + | - | - | - | [+] | + | + | + | + |
| b | + | + | + | + | - | - | - | + | + | + | - | - | - | - | + | + | + | |

+ : pozitiv pas 8 ditësh

[+] : reakcion i dobët

DISKUTIM

Rasti paraqet interes të veçantë klinik dhe bakteriologjik, sepse çon se mund të kemi septicemi të shkaktuar nga shigelat.

Ritheksojmë se shigelemia është një dukuri jashtëzakonisht e rrëpor jo e pamundshme.

Burimet e literaturës, që flasin për tejkalimin e barierës intestinale ana e shigelave janë të rrallë dhe të paktë. Por më tepër pjesa e madhe e autorëve, që trajtojnë këtë çështje, nuk paraqesin rastet tyre, por citojnë studjues të tjera (2,8,9,10,11,13).

Studimi i shigelemisë ka përfshirë edhe eksperimentimin në kafalaboratorike. Kështu nëpërmjet inokulimit të sasive të mëdha të shigelave tek kafshët, rezistencë e të cilave ish ulur më parë, u arriti kryhej depertimi i këtyre enterobaktereve në gjak. Një gjë e mund të ndodhë edhe në organizmin e njeriut (8).

Kështu një autor (cituar nga 9) i ka zbuluar shigelat në nyjet e kafalaboratorike, shpërtkë dhe mëlci. Tre autorë të tjera i kanë gjetur në mënyrën e rruget biliare (cituar nga 14), po ashtu dhe në urinë, ku është izoluar shigela Flexner (2). Demostrimi i shigelave në organet e brezheve të kufomave dizenterike duhet kuptuar si një imigrim i tyre gjagonisë (10). Prandaj hemokulturat pozitive rezultojnë të tilla shpesh tek të sémurët me dizenteri akute të formës së rëndë. Mund të kemi shigelemi edhe pas kalimit të fazës akute të dizenterit bakteriale. Kështu dy autorë (cituar nga 13) kanë izoluar në gjak shigela Sonnei tek një i sémurë 25 vjeçar, që kishte kaluar dizenteri. Hemokultura rezultoi pozitive 8 ditë pas daljes nga spitali me këporkultura negative. Gjithashtu një autor (cituar nga 14) flet për bakteriemi nga shigelat dhe në mungesë të shenjave intestinale. Kuq het se përqindja e pozitivitetit të hemokulturave për shigela është shumë. Kështu një autor (cituar nga 11) yuri rë tre raste me septicemë shigelat gjatë ndjekjes së mbi 500 fëmijëve të shtruar në spital.

Tek e sémura e ndjekur nga ne, shigelemia u shfaq tek një e sémurë që, mesa duket, vuante nga një dizenteri bakteriale kronike e riakutizuar. Për këtë bazohemi në kalimin rrëth një vit e gjysëm më parë të një dizenterie akute (me shfaqje të plotë të sindromës lokale dhe asaj të përgjithshme, me ecurinë dhe përgjigjen terapeutike tipike për këtë sémundje), në shfaqjen e shenjave të kolitit kronik rrëth dy muaj më vonë, në ekzaminimin rontgenologjik të tregonte një kolit spastik si edhe në të dhënët endoskopike karakteristike për një dizenteri kronike, siç e ve në dukje edhe një autor tjetër (4).

Shkaku i depërtimit në gjak të shigelave nuk është i qartë. Megjithatë tek ky rast ishin të pranishëm dy kushte, që mund të ndihmonin deri diku shpjegimin e kësaj ngjarjeje: koliti kronik me mikroulceracione dhe adenokarcionomale multiplex hepatis. Njihet roli i rëndësishëm i sémundjeve të mëlcisë dhe të atyre malinje në uljen e rezistencës së përgjithshme të organizmit. Gjithashu dihet se hasja e bakteriemive, sidomos prej gram negativeve, gjatë këtyre sémundjeve, është e lartë. Edhe nga shumë autorë vlerësohet roli i fuqisë mbrojtëse të organizmit në drejtim të shfaqjes së shigelemisë. Kështu, flitet për septicemë nga shigela Flexner gjatë një leukopenie të rëndë tek një neonat dhe për një gjendje septike të shkaktuar nga salmonela Schwartzengrund dhe shigela Boydii tek një subjekt me hemoglobinopati patologjike nga prania e HBc dhe me 12.3% të hemoglobinës fetale alkali-resistente (1,8).

Mbi pasojat e shigelemisë flitet pak, ndoshta edhe pse kjo është e rrallë. Shumica e anatomopatologëve nuk kanë parë alteracione të veçanta të organeve, siç ngjet p.sh. në tifon abdominale edhe kur ka ndodhur depërtimi i shigelave në vazat e gjakut apo ato limfatike (2, 5). Kështu në 1130 ekzaminime nekroskopike të kryera në subjekte të vdekur nga shigeloza, një autor (cituar nga 9) nuk ka parë formim të abceseve. Po kështu, gjatë ekzaminimit të 91 kufomave (fëmijë të vdekur nga dizenteria), një autor tjetër (5) nuk ka hasur lezione të kësaj natyre. Megjithatë janë parë meninxite purulente (8) dhe pneumoni primare (7).

Tek rasti i paraqitur në këtë punim, po të kihet parasysh grafiku i temperaturës, bie në sy se shigelemia përkon me atë pjesë të kurbës, ku temperatura nga subfebrile bëhet septike. Nga ana klinike, në këtë fazë, e sémura rëndohet si pasojë e shfaqjes së një gjendjeje toksiko-septike. Dihet se tumoret e mëlcisë mund të shoqërohen me temperaturë subfebrile apo febrile (1). Me përdorimin e ceporinës dhe gentamicinës vumë re uljen e temperaturës në subfebrile, siç ishte paraizoimit të shigelave nga gjaku. Duke dashur të bëjmë një lidhje midis këtyre dy të dhënavë, mendojmë se në rritjen e temperaturës (pjesa e mesme e grafikut) mund të ketë ndikuar edhe endotoksinemia shigeloze, si pasojë e shkatërrimit të këtyre mikrobeve në gjakun qarkullues. Roli i këtyre toksinave bakteriale në intoksikacionin e përgjithshëm. Roli i këtyre toksinave bakteriale pranohet nga të gjithë autorët. Nga këto gjatë dizenterisë bakteriale pranohet nga se sémura ka pasur një septicemi nga shigela Sonnei.

BIBLIOGRAFIA

- 1) Adhami J. E.: Tumoret e mëlcisë. Traktati i sëmundjeve të brendshme. Tii 1974, vol. II, 154.
- 2) Aschoff K.: Dysenterie. Pathologische Anatomie. Jena 1928, 880.
- 3) Bekteshi S.: Enteriti nga shigelat. Pediatria. Tiranë 1974, vol. I, 334.
- 4) Bitri P.: Dyzenteria bacilare. Pathologjia morfologjike. Tiranë 1966, 591.
- 5) Bitri P.: Patmorfogjeneza e dizenterisë në fëmijë. Tiranë 1973, 79.
- 6) De Rittis F.: Disenteria bacilare. Manuale di patologia medica (Campana Torino 1971, Vol. II, 337.
- 7) Dushniku N.: Dyzenteria. Sëmundjet infektive. Tiranë 1976, Vol. II, 9.
- 8) Ferrarini E.: Shigelosi. Giorn. Mal. Inf. Parass. 1974, 26, I, 35.
- 9) Johmann-Hegler-D'Amato: Trattato delle malattie infettive. Disenteria. Mil 1939, 661.
- 10) Klempner G.: Dysenterie. Neue Deutsche Klinik. Berlin 1932, 641.
- 11) Knapp G.: Shigellosen. Infektionen des Gastro-Intestinaltraktes. Editiones Re 1978, 201.
- 12) Pulo J., Kraja Dh.: Një rast i disenterisë bakteriale akute flexneri, që sim në fillim në gjendje gripale të zgjatur. Buletini i UT — Seria shkencat r kësore 1978, 2, 59.
- 13) Slopek S.: Enterobakteriaceae Infektionen (Sedlak-Rische). Leipzig 1968, 3
- 14) Wildfuhr G.: Medizinische Mikrobiologie, Immunologie und Epidemiologie. Lei 1959, Vol. I, 458.

Summary

A CASE OF SHIGELLA SONNEI BACTERIEMIA

The paper describes the pathologic changes caused by shigella. It points out that they are not always identical and discusses briefly the pathogenesis. It is a characteristic of shigellae that they do not usually cross the vascular barrier and do not cause bacteremia.

But in some rare, exceptional cases blood cultures may result positive for these organisms. The paper illustrates this possibility with a personal case in which *Shigella sonnei* was isolated from the blood.

The paper describes the method used for the isolation and identification of the strain, which resulted a xylose-fermenting variant. It points out that shigellae can penetrate the blood stream in unusually severe cases, but also after recovery from bacterial dysentery. In the described case the patient was suffering from chronic dysentery complicated by a septic state, to which may have contributed an accompanying liver adenocarcinoma.

Résumé

UN CAS DE SHIGELLA SONNEI BACTERIEMIA

Dans cet article il est question des modifications pathologiques provoquées par la shigellose, qui, selon l'avis des auteurs, ne sont pas toujours identiques. Ensuite les auteurs s'occupent de la pathogénèse de la shigellose et soulignent le fait que les shigella ne pénètrent pas généralement dans l'organisme humain et ne provoquent pas la bactériémie. Les hémocultures sont rarement positives. En effet les auteurs décrivent un cas dans lequel ils ont isolé le bacille de Sonnei. Ils ont employé à cette fin une méthode qui leur a donné une souche de *Shigella Sonnei*, appartenant à la variante qui désagrège la xylose.

Selon les auteurs, on rencontre la shigellose dans les formes aiguës, graves de la dysentéry chronique ou après celle-ci. En effet dans le cas qu'ils décrivent, la malade souffrait d'une dysentéry chronique, qui s'est compliquée d'un état septique, à la manifestation de laquelle a contribué peut-être dans une certaine mesure la présence d'un adéno-cancer du foie.

PROBLEME AKTUALE TË MJEKËSISE

ANTAGONISTËT E RECEPTORËVE H₂-HISTAMINIKË, VEPRIMI FARMAKOLOGJIK DHE PËRDORIMI KLINIK

— PROF. JOSIF E. ADHAMU —

(Klinika e II e Sëmundjeve të Brendshme)

I. — RECEPTORËT HISTAMINIKË

Receptor mund të konsiderohet si një molekulë, si një pjesë e saj ose si një grup molekulash, që bëjnë pjesë në një substrat biologjik, me të cilin molekula e medikamentit duhet të bashkëreagojë për të pasur një veprim farmakologjik (11). Sikurse receptorët adrenergjikë, ashtu dhe ata histaminikë nuk janë njësi anatomike ose histologjike, por manifestime biokimike, që zhvillohen në nivelin e membranës qelizore.

Për të folur për një veprim receptorështë e nevojshme që të kemi agonistë selektivë, domethënë lëndë që stimulojnë receptorët dhe antagonistë selektivë ose lëndë që blokojnë vetë receptorët, në rast të kundërtë kemi të bëjmë me veprimejospecifike të membranës ose ndryshime të permeabilitetit etj.

Kohët e fundit ka tërhequr vëmëndjen mundësia e qenies së të ashtuquajturave «organe receptorë aksesorë» ose «shtojca», të cilët janë të rëndësishëm veçanërisht në rastet kur midis agonistëve dhe antagonistëve nuk ka një identitet struktural të qartë (76).

Me zbulimin e antihistaminikëve klasikë, në vitin 1937, filloi të flitet edhe për receptorët histaminikë. Por në studimet e mëvonshme u pa se disa nga veprimet e histaminës, veçanërisht ai mbi ngacmimin e sekrecionit gastrik, nuk blokoheshin nga antihistaminikët të zbuluar deri atëherë (11). Kjo bëri që në vitin 1966 të ndahen receptorët histaminikë (4) në receptorë H₁ (ata që blokoheshin nga antihistaminikët klasikë) dhe receptorë jo H₁ (ata që nuk blokohen prej tyre). Në vitin 1972 (13) këto të fundit u quajtën receptorë H₂ histaminikë dhe u përcaktuan agjentët agonistë dhe antagonistë të tyre. H_1, H_2

Përsa i perket përhapjes së receptorëve histaminikë, eshtë gjetur se përveç tre lokalizimeve klasike: 1) qelizave parietale (oksintike) të stomakut; 2) uterusit të miut dhe 3) atriumeve të zemrës së kavies, ka dhe shumë sektorë të tjerrë, ku ngacmimi i receptorëve H₂ shkakton veprime pozitive ose negative (11). Këto veprime ndonjëherë mund të tregojnë të ngjashëm me ato të receptorëve H₁, herë tjetër të kundërtë. Përsaj kësaj, receptorët H₂ duket se janë heterogjenë dhe kanë një cilësisë së vetë receptorëve, prandaj nga pikëpamja sasiore iu përgjigjen në mënyrë të ndryshme agonistëve të ndryshëm. Kështu disa

Aftësia e antagonistëve të receptorëve H_2 për të frenuar sekrecionin gastrik të stimuluar nga pentagastrina na bën të mendojmë se *gastrina* vepron nëpërmjet çlirimt të histaminës endogjene. Fakti që «*in vivo*» sekrecioni i stimuluar nga acetil-kolina është më rezistent kundrejt antagonistëve të receptorëve H_2 sesa sekrecionet e stimuluar nga histamina dhe pentagastrina, le të mendohet se në mukozën gastrike ekzistojnë receptorë kolinergjikë, që nuk blokohen nga antagonistët e receptorëve histaminergjikë H_2 . E dhënë më doza-të mjaftueshme për të frenuar sekrecionin gastrik, cimetidina nuk jep manifestime anësore mbi aparatin kardiovaskular dhe sistemin nervor central (61).

Në dritën e njohurive të sotme është e pamundur të përcaktohen me përpikmëri mekanizmat molekulare që rregullojnë prodhimin e aciditit klorhidrik në mukozën gastrike, por megjithatë duket i padiskutueshëm roli i disa agjentëve, midis të cilëve ngre peshë sistemi i nukleotideve ciklike.

Studimi i specifitetit dhe e përhapjes së adenilciklazës në mukozën gastrike të kavies ka treguar se kjo ciklazë stimulohet jo vetëm nga histamina, por edhe nga dimapriti, që, siç e kemi përmëndur, është një ngacmues specifik i receptorëve H_2 . Cimetidina e blokon në mënyrë selektive aktivizimin enzimatik të shkaktuar nga histamina dhe dimapriti, por nuk e frenon shtimin e adenilciklazës së prodhuar nga epinefrina dhe prostaglandina E_2 , të cilat janë frenuese të acidit gastrik. Kjo bën të mendohet se sekretagogët histamina dhe dimapriti veprojnë mbi sisteme ciklazash, të varura nga struktura membranash të ndryshme nga ato mbi të cilat veprojnë epinefrina dhe prostaglandina (30).

Gastrina është një sekretues i fuqishëm i acidit gastrik, kurse acidifikimi në atriumin normal është mekanizmi fidbek kryesor, që frenon çlirimt e gastrinës. Mendohet se në të sëmurët me ulcer duodenal, ky mekanizëm frenues mund të çrrregullohet. Kështu në njerëzit e shëndoshë ka një raport të drejtpërdrejtë midis pH intragastrik dhe nivelit të gastrinës në serum, gjë që mungon në të sëmurët me ulcer duodenal.

Niveli serik i gastrinës nuk ndryshon gjatë përdorimit të menjëherëshëm të cimetidinës ose kur ajo përdoret për 4 deri 6 javë (7, 18, 25). Edhe mjekimi i zgjatur më tepër se tre muaj me cimetidinë nuk e rrit prodhimin bazal të gastrinës, me përjashtim të rasteve kur gjenden ndryshime të mëdha të pH bazal antral (71).

Të sëmurët me ulcer duodenal kanë prirje të prodhojnë sasi të mëdha acidi gastrik bazal, kurse cimetidina, si antagonist i receptorëve H_2 -histaminikë, e frenon këtë sekrecion si ditën ashtu dhe natën (12, 15, 20, 25).

E dhënë më 200-400 mg. per os, domethënë 1-2 tableta, cimetidina e ul prodhimin mesatar të acidit gastrik në 87-88%. Ulja më e theksuar shihet 2-4 orët e para pas pjesë së preparatit, por veprimi është më i madh mbi përqëndrimin e acidit, sesa mbi volumin e sekrecionit gastrik (9).

Cimetidina, e marrë nga goja, është një preparat antisekretor fuqishëm, që e frenon shumë sekrecionin acid dhe e ul aciditetin intragastrik si në njerëzit e shëndoshë, ashtu dhe në ata me ulcer duodenal. Doza optimale prej 1 gr. në ditë ka veprim të barabartë me 2.4 mg.

atropinë në ditë (65). 400 mg. cimetidinë, të marrura në mbrëmje para gjumit, kanë veprim frenues maksimal mbi prodhimin e aciditetit gastrik gjatë natës (14).

Ka autorë (34) që duke dhënë nga 1.6 gr. cimetidinë në 24 orë për 6 javë kanë gjetur një ulje të theksuar të mesatares së prodhimit të acidit, e cila vazhdoi të mbetet e ulur edhe dy javë pas ndërprerjes së preparatit.

Në trajtimin e ulcerit duodenal, cimetidina është efektive dhe jep rezultate të ngjashme si vagotomia gastrike proksimale (1). Cimetidina është një frenues i fortë i sekrecionit gastrik të stimuluar nga histamina, pentagastrina, insulina, kofeina ose ushqimet. Përgjigja sekretore e stomakut kundrejt ushqimeve kontrollohet nga dy rrugë kryesore: *rruga vagale* dhe *ajo hormonale*. Ngacmimi *vagal* bëhet me anën e hipoglicemisë insulinike ose nëpërmjet «ushqyerjes së rremë», domethënë duke i dhënë të sëmurit një ushqim për ta përtypur dhe pastaj ta pështyjë pa e gjelltit (53). Cimetidina e ul aciditetin e stimuluar nga insulinë deri në 98% (12).

Rruga hormonale bëhet me anën e *gastrinës* ose preparatit analog sintetik *pentagastrinës*. Cimetidina nuk ka veprim mbi nivelin serik bazal të gastrinës, por frenon në mënyrë të dukshme sekretimin e acidit gastrik të stimuluar nga pentagastrina (1, 12, 15, 18, 21, 25, 69).

Përsa i përket histaminës, megjithëse roli që ajo luan nuk është sëqaruar plotësisht, sot është e sigurtë se ajo merr pjesë në mekanizmin fiziologjik të sekretimit gastrik. Si antagonist i receptorëve H_2 – histaminikë, cimetidina e frenon sekrecionin e acidit gastrik të ngacmuar edhe nga histamina (21, 25, 53, 69). Ajo e ul aciditetin si në njerëzit e shëndoshë, ashtu dhe në ata me ulcer duodenal deri në 93.9% të tij dhe e ul aciditetin gjatë natës, duke e ngritur pH në rreth 6-7 (12). Cimetidina pengon shtimin e joneve të hidrogjenit (H^+) dhe volumin e sekrecionit gastrik të prodhuar nga përdorimi i kafeinës tek të gjithë rastet e vrojtuar. Me gjithë përdorimin e kafeinës, prurja acide, që shihet pas përdorimit të cimetidinës, është zakonisht më i ulët se niveli bazal (28).

Për të përcaktuar aftësinë vepruese të cimetidinës, elementi kryesor nuk është doza e përdorur sesa niveli që ajo arrin në gjak. Përdorimi i cimetidinës gjatë ngrënies e vonon rezorbimin e saj.

Veprimi i cimetidinës mbi sekretimin e pepsinës është më pak i qartë se ai mbi sekrecionin acid. Megjithatë është vënë re se përqëndrimi i pepsinës gjatë përdorimit të cimetidinës pëson një ulje të lehtë (1, 53).

Një veprim tjetër i cimetidinës është edhe ai mbi sekretimin e faktorit intrinsek. Siç dihet, në njerëz, faktori intrinsek sekretohet nga qelizat parietale të stomakut. Pentagastrina dhe histamina, të dhëna në doza që shkaktojnë prodhim maksimal të sekrecionit acid, stimulojnë edhe sekretimin e faktorit intrinsek.

Cimetidina ka një veprim të theksuar frenues mbi volumin, aciditetin dhe prodhimin e acidit, por nuk ka aftësi vepruese të madhe mbi kulmin e përqëndrimit, kulmin e prodhimit ose kohën e përgjigjes së sekretimit të faktorit intrinsek nga stimulimi me pentagastrinë. Kështu përdorimi klinik i cimetidinës nuk besohet të shpjerë në një varférin

të organizmit nga vitamina B₁₂ me pasoja hematologjike dhe neurologjike (23).

Boshatisja e rezervave të faktorit intrinsek në qelizat parietale, nën veprimin e pentagastrinës, para përdorimit të cimetidinës, si dhe përgjigjet e tyre kundrejt stimujve të përsëritura më vonë, tregojnë se cimetidina nuk ka asnjë veprim mbi sintezën e faktorit intrinsek (25).

Përsa i përket sekretimit të pankreasit ekzokrin eshtë vërtetuar se përdorimi i cimetidinës për 28 ditë me dozë 1 gr. në ditë në të sëmurë me ulçer duodenal, nuk e ndryshon sekrecionin ekzokrin të këtij organi (32, 53). Po ashtu dhënia e cimetidinës 400 mg. per os dy orë para sondimit duodenal dhe kërkimi i sekrecionit pankreatik pas injektimi të shpejtë i-v të sekretinës dhe pankreoziminës, nuk vuri në dukje asnjë ndryshim të rëndësishëm, lidhur me volumin, koncentrimin, prodhimin e bikarbonateve, amilazës, lipazës, tripsinës dhe kimotripsinës (38). Ka mendime se preparati mund të përdoret në mjekimin e pankreatitit kronik ku ndihmon për një përdorim më të mirë të ekstrakteve pankreatike zëvëndësuese (32). Ai nuk e ndryshon pH intraduodenal dhe nuk ka asnjë veprim mbi prurjen totale të acideve biliare (53). Cimetidina nuk e ndryshon as sekretimin e lipazës, tripsinës dhe acideve biliare pas ngrënies (55).

Ekziston një hipotezë, sipas së cilës ndryshimi i barierës mukoze të stomakut shprehet me një zgogëlim të diferençës së potencialit të mukozës gastrike, gjë që lejon një shpërhapje retrograde të shtuar të joneve H⁺; kësaj i atribuohet shkaku kryesor i lezonave të mukozës. Cimetidina e shton diferençën e potencialit të mukozës gastrike dhe ndihmon në riparimin e dëmtimeve qelizore të shkaktuara nga aspirina. Me ndryshim prej preparateve antikolinergjikë, cimetidina nuk e ul presionin e sfinkterit ezofageal të poshtëm dhe nuk e ndryshon funksionimin e tij normal. Ai nuk ndikon as mbi shpejtësinë e zbrazjes së stomakut (53).

Gjatë përdorimit nga goja, cimetidina absorbohet mirë, por një sasi e madhe e dozës së saj nxirret e pandryshuar me urinë edhe kur përdoret me rrugë intravenoze (47). Gjysëm jeta e saj në gjak eshtë rreth 90% e tyre. Përvec kësaj u vu re se të sëmurët që marrin cimetidinë konsumojnë shumë më pak preparate antiacide sësa ata me placebo (16). Rezultatet e mjekimit ndryshojnë sipas autorëve nga 85% të cikatrizuar me cimetidinë dhe 25% me placebo (45), përkatësisht 72% dhe 29% (10), deri në 85% me cimetidinë dhe 60% me placebo (70).

Ka autorë (58) që lidhin rezultatet e mjekimit me zgjatjen e tij në kohë; kështu duke dhënë doza më të larta: 4 herë nga 400 mg. cimetidinë në ditë, pas dy javësh mjekimi u shëruan 30% e rasteve të vërtetuar endoskopikisht, pas 6 javësh u shëruan 60%, kurse pas 12 javësh 90% e tyre. Përvec kësaj ata vunë re se dy javët e para rezultatet e mjekimit me cimetidinë nuk kishin ndryshime të mëdha me ata që u mjkuan me placebo, diferençë e cila rritet pas 6 dhe 12 javësh. Krejt ndryshe nga këto, autorë të tjerë (35) kanë gjetur se shërimi i të sëmurëve me ulçer duodenal të mjekuar me cimetidinë dhe me placebo ishte i ngjashëm pas 6 javësh, kurse diferenca më të mëdha midis dy grupeve u gjetën pas dy javësh mjekimi. Veç kësaj u pa se në të sëmurët e shtruar në spital, përqindjet e shërimit ishin më të larta se në ata që mjekoheshin ambulatorisht.

Në të sëmurët me insuficiencë renale, që bëjnë hemodializa të rregullta, përdorimi i cimetidinës me dozë 200 mg dy herë në ditë bën që përpqendrimi i preparatit në gjak të jetë i përshtatshëm, pa pasur rrezik akumulimi. (27). Kjo ka rëndësi të madhe, pasi në të sëmurët me insuficiencë renale që bëjnë hemodializa të rregullta dhe në ata me transplantime, incidenca e ulçerave peptike eshtë e lartë. Prej këtej kuptohet se përdorimi i antagonistëve të receptorëve H₂ – histaminikë, siç eshtë cimetidina, mund të lozë një rol në trajtimin e ulçerave peptike të shfaqura gjatë insuficiencës renale.

III. – PËRDORIMI I ANTAGONISTËVE TË RECEPTORËVE H₂ – HISTAMINIKË NË KLINIKË

Absorbimi digjestiv shumë i mirë lejon që zakonisht cimetidina të jepet nga goja në formë tabletash prej 200 mg secila. Doza ditore mesatare eshtë 1,0 gr. Për shkak të gjysëm jetës së saj përkrahështë të shkurtër, doza ditore ndahet në katër pjesë: tri herë nga një tabletë jetë pas ngrënies së mëngjezit, drekës e darkës, kurse dy tabletat e tjera i jepen të sëmurit para se të flerë. Kjo dozë mund të shtohet në qoftë se i sëmuri paraqit një sekrecion acid shumë të lartë.

Ulceri duodenal: në krizat ulçeroze akute cimetidina jepet me 1,0 gr. ditën për katër javë ose mund të zgjatet edhe 6 javë. Shqërimi me antikolinergjikë eshtë i padobishëm dhe rrezikon të japë manifestime anësore. Kurse preparatet antiacide si kripërat e aluminit mund të përdoren veçanërisht në ditët e para kur të sëmurit i kanë mbetur ende disa dhëmbje.

Në studime të verbta të dyfishta janë mjekuar të sëmurë me ulçer duodenal me cimetidinë nga goja ose me placebo (kapsula lakoze me pamje të njëjtë). Ekzistenza dhe përmasa e ulçerit kontrolloheshin endoskopikisht me fibrogastroскоп para mjekimit dhe çdo javë gjatë mjekimit. Zvogëlimi i përmasave ishte shumë më i shpejtë në ata që merrnin cimetidinë sësive placebo me probabilitet gabimi përkatësisht $P < 0.001$ dhe $P < 0.0005$ (15, 39). Veç kësaj u vu re se të sëmurët që marrin cimetidinë konsumojnë shumë më pak preparate antiacide sësive ata me placebo (16). Rezultatet e mjekimit ndryshojnë sipas autorëve nga 85% të cikatrizuar me cimetidinë dhe 25% me placebo (45), përkatësisht 72% dhe 29% (10), deri në 85% me cimetidinë dhe 60% me placebo (70).

Ka autorë (58) që lidhin rezultatet e mjekimit me zgjatjen e tij në kohë; kështu duke dhënë doza më të larta: 4 herë nga 400 mg. cimetidinë në ditë, pas dy javësh mjekimi u shëruan 30% e rasteve të vërtetuar endoskopikisht, pas 6 javësh u shëruan 60%, kurse pas 12 javësh 90% e tyre. Përvec kësaj ata vunë re se dy javët e para rezultatet e mjekimit me cimetidinë nuk kishin ndryshime të mëdha me ata që u mjkuan me placebo, diferençë e cila rritet pas 6 dhe 12 javësh. Krejt ndryshe nga këto, autorë të tjerë (35) kanë gjetur se shërimi i të sëmurëve me ulçer duodenal të mjekuar me cimetidinë dhe me placebo ishte i ngjashëm pas 6 javësh, kurse diferenca më të mëdha midis dy grupeve u gjetën pas dy javësh mjekimi. Veç kësaj u pa se në të sëmurët e shtruar në spital, përqindjet e shërimit ishin më të larta se në ata që mjekoheshin ambulatorisht.

Nën veprimin e cimetidinës zhduken edhe dhembjet epigastrike. Sekretimi gastrik acid bazal ose pas stimulimit maksimal me pentagastrinë pakësuhet shumë brenda 28 ditësh mjekimi. Por ndryshe nga këto nuk u panë ndryshime të gastremisë bazale dhe të masës së qelizave parietale (44). Autorë të tjerë (29) kanë studjuar densitetin dhe volumin e qelizave parietale të mukozës së stomakut në krasasim me volumin e gjendrave të saj para dje 30 ditë pas mjekimit me 1,0 gr. cimetidinë ditën; duke marrë nga 8 biopsi (para e ditën e 30) në nivelin e trupit

të stomakut (zona e Polacek e Ellison) gjetën një zvogëlim të densitetit dhe të volumit të qelizave parietale.

Në studime të tjera të verbta të dyfishta, ku diagnoza vërtetohej me fibrogastroskopi dhe përqindjet e shërimit ishin përkatësish 72% me 34% për cimetidinën e placebo, ndërsa zhdukja e dhëmbjeve ulçeroze nuk ndryshonte shumë nga njëri grup në tjetrin, por konsumi i preparateve antiacide ishte më i madh në të sëmurët e mjekuar me placebo sesa ata me cimetidinë (3).

Përsa i përket zgjatjes së mjekimit ka autorë në literaturë që thonë se cimetidina në ulcerin duodenal duhet të vazhdohet 8 javë, pasi rritet përqindja e cikatrizimit të ulcerit nga 73% pas 4 javësh në 90% pas 8 javësh. Kur ka mundësi ekzaminimesh radiologjike dhe endoskopike, terapia me cimetidinë duhet të vazhdohet deri në cikatrizimin e ulcerit (63).

Përsa i përket terapisë së shkurtër 7 ditore me 1.0 gr. ditën cimetidinë mund të përdoret si një ndihmëse e dobishme në periudhën para-operatore (73). Sidoqoftë, cikatrizimi i ulcerit nuk e zgjidh përfundimisht sëmundjen ulçeroze, pasi pjesa më e madhe e të sëmurëve pësojnë recidiva brenda një viti. Recidiva mund të mjekohet me një cikël tjetër cimetidine. Në raste të tilla mundësitätë e shërimit janë të njëjtë ose pak më të dobta sesa rezultatet e arritura me ciklin e parë (8). Në gjendjen e sotme të njojurive, ulceri duodenal i pandërlikuar mund të konsiderohet si indikacioni më i zgjedhur për cimetidinën. Por ka edhe autorë që kanë arritur rezultate shumë të mira edhe në disa raste ulçerash penetrante. Në pamundësi për të përdorur endoskopinë, duhet bazuar në kriteret diagnostike më specifike, si p.sh. mbi *nishën* dhe jo mbi *deformimin e bulbit* të vënë në dukje gjatë ekzaminimit radiologjik (8).

Me qëllim që të mënjanohen recidivat e sëmundjes pas ndërprerjes së cimetidinës, ka mendime për përdorimin e preparatit vazhdimisht së cikatrizimit (16, 40, 46, 64, 75). Lidhur me këto, mendohet se një doza mbajtëse (16, 40, 46, 64, 75). Lidhur me këto, mendohet se një dozë 400 mg e njëhershme e dhënë në mbrëmje mbron një lloj si dy dozë 400 mg secila; ky mjekim duhet të zgjatet të paktën për 6 muaj, sepse pas 6 muajve të parë recidivat ulen shumë dhe sëmundja stabilizohet (40). Për përdorimin e cimetidinës me ulcer flasin edhe shumë autorë të tjerë (2, 26, 36, 62, 66 etj.).

Nga të dhënët e deritanishme duket se nuk është vërtetuar ekzistencë e dukurisë së rikthimit (rebound) pas ndërprerjes së preparatit (64).

Ulceri gastrik — Para se të fillojë mjekimi duhet të vërtetohet natyra bënijë e ulcerit, jo vetëm radiologjikisht dhe me fibrogastroskopi, por edhe histologjikisht me biopsi të shumta, pasi cimetidina mund të cikatrizojë edhe një kancer ulceriform.

Cikatrizimi i një kanceri të tillë e pengon mjekun ta dërgojë të sëmurin për ndërhyrje kirurgjikale, por çdo vonesë në këtë drejtim shpërndanë shfaqjen e metastazave.

Studime të verbra të dyfishta kanë vërtetuar efikacitetin e cimetidit në edhe në ulcerin gastrik (6, 33, 50, 75). Zgjatja e mjekimit luhatë midis 6 dhe 12 javësh, sipas përmasave të ulcerit, të cilat janë shumë të ndryshme në stomak (40).

Ulceri peptik anastomotik pas gastrektomisë. — Ky shfaqet kujt gjatë ndërhyrjes kirurgjikale nuk është pakësuar sa duhet sekrecion

acid i stomakut. Mund të jetë pasojë e një indikacioni jo të përshtatshëm për *vagotomi hiperselektive*, *vagotomi trunkulare* jo të plotë ose *gastrektomi* të pjesshme të pa shoqëruar me *vagotomi*. Përdorimi i cimetidinës e cikatrizon ulcerin në shumicën e rasteve. Kur paraqitet nevoja për një ndërhyrje të dytë kirurgjikale, cimetidina duhet vazhduar deri në çastin e ndërhyrjes.

Me dozë 1.6 gr. ditën për 8 javë, cimetidina e ul sekrecionin basal dhe atë të stimuluar dhe i shëron ulcerat në 90% të tyre të vërtetuarëndoskopikisht (52).

Antagonistët e receptorëve H₂ – histaminikë në hemorragjitet gastro-intestinale. — Terapia e përdorur deri më sot, shpeshherë, është e paftë të ndalojë hemorragjitet e shkaktuara nga dëmtimet erozive akute të pjesës së sipërme të tubit tretës, në të sëmurët që vuajnë nga sëmundje të rënda të mëlcisë. Prej këtej duket se acidi gastrik është një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e këtyre dëmtimeve, prandaj u mendua të përdoren antagonistët e receptorëve H₂ – histaminikë — *metiamidi* dhe *cimetidina* për profilaksinë dhe ndalimin e hemorragjive gastrointestinale të këtyre të sëmurëve.

Të bazuar mbi këto, disa autorë (57) mjekuan 25 të sëmurë me metiamid ose cimetidinë në mënyrë profilaktike me 150 mg intravenoz, duke i përsëritur në rast nevoje, me qëllim që pH intragastrik të mbahej rrëth 5. Nga ky grup pati hemorragji vetëm një i sëmurë, ndërsa nga 21 raste kontrolli të pa mjekuar me këto preparat, hemorragjia u shfaq në 11 veta. Po kështu 12 të sëmurë me hemorragji gastrointestinale, nga të cilët 4 hemorragji të rrufeshme nga insuficiencia hepatike, 2 me hepatit alkoolik të rëndë dhe 6 me cirroza të dekompenzuara, të cilët paraqitnin erozione të vërtetuarë fillimisht me endoskop, u mjekuan me cimetidinë 150 mg. i-v çdo 6 orë ose 1 gr. ditën nga goja, të ndarë në 4 doza. Hemorragjia ndaloj në të gjitha rastet brenda 12 orësh, por me ndalimin e mjekimit u rishfaq në 3 veta. Me rifillimin e cimetidinës u ndëpre në dy prej tyre.

Në raste të tilla, masat e tjera, duke përfshirë edhe infuzionin e pitresinës në arterien mezenteriale në mënyrë selektive, janë shpesh të paefektshme, kurse aciditeti gastrik lot një rol themelor në patogjenezën e këtyre dëmtimeve të tubit tretës. Kështu përdorimi i antagonisteve të receptorëve H₂ – histaminikë përbën një metodë të thjeshtë dhe efektive si për parandalimin, ashtu dhe për mjekimin e hemorragjive gastrointestinale në sëmundjet e rënda të mëlcisë.

Ka autorë (59) që mendojnë se mjekimi me cimetidinë mund të përdoret jo vetëm në hemorragjitet e erozionet e mukozës, por dhe në ato të ardhura nga varicet e ezofagut, pasi refluksi i lëngut gastrik është në ezofag mund të kontribuojë në patogjenezën e hemorragjive.

Ka raste kur dëmtimet akute hemorragjipare të mukozës gastro-duodenale shfaqen edhe në prani të një sekrecioni acid shumë të pakët. Në të sëmurë të tillë rekombinohet që cimetidina të shoqërohet me preparatet antiacide për ta rritur pH gastrik deri në neutralizim të tij (8).

Autorë të tjerë (42) cimetidinën e kanë përdorur për të ndaluar hemorragjitet nga ulcerat gastroduodenale, si dhe për të parë incidenten përsëritjes së hemorragjive dhe kanë gjetur ndryshime në krasatit të sëmurët, tek të cilët kanë përdorur placebo.

Cimetidina ka vend të përdoret në mjekimin e hemorragjive nga ulcerimet dhe erozionet e ezofagut, stomakut e duodenit, veçanërisht në të sëmurët me kushte që predispozojnë për hemorragji ose ku sëmu ndje të tjera shqëruese apo mjekim me preparate të tjera e rritin rishkun e kirurgjisë. Por nga ana tjetër duhet thënë se cimetidina është e pamundur të japë efekt në hemorragjitet e shkaktuara nga ulcerat që kanë dëmtuar vaza të mëdha (24). Për aftësinë vepruese të cimetidinës në hemorragjitet gastrointestinale flasin edhe shumë autorë të tjerë (40, 59, 68, 75 etj.).

Sindroma e Zollinger - Ellison. — Manifestimet funksionale dhe ndërlikimet e rënda të sindromës Zollinger-Ellison janë të lidhura me hipersekretimin e acit, që vjen si pasojë e prodhimit të shtuar të gastrinës nga masa tumorale.

Diagnoza e kësaj sindrome bazohet kryesisht mbi rritjen e përqen-
drimit të gastrinës në serum, hiperekreacionin e acidit klorhidrik *gastrik*
dhe ulçerat gastroduodenale të para me fibrogastroskopi. Deni këto vit-
e fundit, mjekimi simptomatik i kësaj sindrome ishte gastrektomia tjet-
tale, kurse sot mjekimi kirurgjikal mund të kufizohet në heqjen e tum-
rit pankreatik (40, 74). Heqja e *gastrinomës* është më e lehtë kur ai ven-
ndoset jashtë pankreasit. Në raste të tilla, ulja e gastrinemisë tregon se
operacioni ka pasur sukses, kurse ulçerat gastroduodenale zhduken me
cimetidinë brenda 8 javësh (31).

Në tre të sëmure me këtë sindromë, që secili paraqiste ulçera të shumta të vendosura në duoden, regjionin prepilorik dhe në stomak mjejkimi me cimetidinë 1-1,4 gr. ditën bëri që ulçerat të shërohen brenda 3-5 javësh, shumica e tyre brenda 3 javësh (74). Pas mjejkimit, sekretimi i acidit gastrik u ul shumë, por përqëndrimi i gastrinës në serum nuk pësoi ndryshime të mëdha.

Autorë të tjera (17) gjatë mjekimit të 5 të sëmürëve me sindrom Zollinger-Ellison me cimetidinë 0,8-2,0 gr. ditën, në 2 prej tyre vunë nje «frenim sekretor të zgjatur», i cili vazhdoi edhe 42 ditë dhe 90 dit pas marrjes së cimetidinës. Në studime të verbta të dyfishta është vë në re se cimetidina është shumë më me aftësi vepruese sesa placebo (75). Por rezultatet nuk janë të mira në të gjitha rastet. Kështu ng 8 raste të mjekuara me cimetidinë 1,2 gr. ditën për 14 deri 195 ditë, r 2 të sëmürë patën rezultate shumë të mira, në 3 përmirësim të pjet shëm kalimtar, kurse 3 të fundit nuk patën efekt (18).

Refluks gastro-ezofageal. — Shenjat klinike dhe démtimet e mukozës ezofagut janë të lidhura më shpesh me refluksin acid. Mjekimi muri bëhet duke neutralizuar lëngun gastrik me antiacide ose duke frenuar sekrecionin. Por duhet pasur parasysh se në këto raste antikolinergjik janë të kundërindikuar pasi relaksojnë sfinkterin e poshtëm të ezofagut dhe ngadalësojnë zbrazjen e pilorit. Në raste të tillë mund të përdoret cimetidina nga 1,0 gr. ditën per os për disa javë (40). Cimetidina është përdorur jo vetëm në refluksin ezofageal pa démtime të mukozës, por edhe në raste të shoqëruara me ezofagit. Kështu nga 30 të sëmurë mjekuar me 1,6 gr. ditën cimetidinë brenda 4 javësh, ezofagoskopia vjetore se u shëruan 68% e tyre (56). Në ezofagitet me démtim potencial rendë, siç janë stenoza, brakiezofagu ose kanceri sekondar mbi mukozë.

gastrike heterotopike, mjekimi ndihmon, por nuk duhet zgjatur ndër hyrja kirurgjikale (40).

IV. — MANIFESTIMET ANËSORE TË ANTAGONISTËV TË RECEPTOREVE H₂ — HISTAMINIKE.

Të dhënë eksperimentale kanë treguar se cimetidina ka toksicitet akut të ulët, kurse doza të përsëritura në qen mbi 12 muaj kanë dhënë vetëm takikardi. Doza të larta deri 504 mg./kg peshë në qen kanë shkaktuar *ndryshime degenerative* në mëlçi me transaminaza të larta para ngordhjes dhe rritje të fosfatazës alkaline. Përveç mëlcisë janë prekur edhe veshkat, ku është shfaqur një *nefrozë tubulare* (54). Dëmtimi të tillë kanë vënë re edhe autorë të tjerë, por nuk kanë parë veprime toksike mbi palcën e kockave në kafshë eksperimentale (20), as agranulocitozë ose ndryshime të tjera hematologjike në njerëz (10, 33, 74). Eshëtë përshkruar edhe ndonjë rast leukopenie ose neutropenie gjatë i jekimit me cimetidinë, por nuk është bindëse, pasi ky preparat është përdorur në dy të sëmurë me agranulocitozë nga metiamidi dhe evolacioni ka qënë i mirë (40).

Gjatë përdorimit të cimetidinës në njerëz, në një përqindje të rasteve mund të vihet re një ngritje tranzitore e transaminazave, e cila rrallë herë mund të bëhet shkak për ndërprerjen e preparatit. Për ndryshime të tillë flasin mjaff autorë (10, 49, 52, 62, 75), por të dhënët ndryshojnë sipas autorëve dhe ka prej tyre që nuk kanë gjetur ndryshime të provave funksionale të mëlcisë (33) ose të tjerë (75), që kanë vënë re ngritje të tyre jo vetëm nga cimetidina, por edhe nga placebo. Edhe përsa i përket rritjes së kreatininës në serum, të dhënët ndryshojnë sipas autorëve. Kështu ka autorë (17, 33) që gjatë mjekimit me cimetidinë nuk kanë gjetur rritje të kreatininës, acidit urik dhe as të uresë në plazëm, kurse të tjerë (10) kanë vënë re një rritje të pakët e tranzitore të kreatininës në rrëth 20% të të sémurëve. Të tjerë (75) është lidhja rritjen e kreatininës me dozat e larta të cimetidinës. Kështu në 3 të sémurë me ezofagit, që merrnin nga 1,6 gr. cimetidinë, kreatinemia u rrit në 3 raste (56), kurse nga 80 raste me ulcer duodenal që merrnin nga 1,0 gr. ditën për 4 javë, kreatinemia u rrit vetëm në një rast (3). Kujdes i veçantë duhet treguar në të sémurët me insuficiencë renale.

Prandaj mjeku para se té fillojë një mjekim me cimetidinë duhet té vleresojé gjendjen e insuficiencës renale dhe shkallén e démtimit té parenkimes hepaticë (8), pasi cimetidina sekretohet shumë në bilë dhe nxirret jashtë me rrugët urinare. Në meshkuj mund té gjendet *gjinekomasti* dhe *galaktore*. Kështu disa autorë (37) nga 7 té sémurë, që mjekoheshin me 1,6 gr. cimetidinë ditën, gjetën 2 raste me gjinekomasti e galaktore dhe asnjë rast té tillë tek té sémurët që mjekoheshin me 1,0 gr. ditën. Niveli plazmatik i *prolaktinës* u gjet i rritur në gjithë té sémurët e grupit té parë në fund té mjekimit; por vlera té dukshme mbi kufit e hormës u vunë re vetëm në 2 rastet që paraqitnin gjinekomasti. Këto simptoma u zhdukën plotësisht pas ndërprerjes së mjekimit. Kjo tregon se ka një lidhje midis gjinekomastisë e galaktoresë, që pasojnë mjekimin me cimetidinë dhe shtimit té vlerave té prolaktinës. Veprimi mbi

prolaktinën duket se varet nga doza e cimetidinës, por mekanizmi mbetet pér tu sqaruar.

Ka dhe të dhëna kur të sëmurit i shfaqet gjinekomasti nën vëprimin e cimetidinës, por niveli plazmatik i prolaktinës mbetet normal (48).

Testosteroni plazmatik nuk ndikohet nga antagonistët e H₂-histaminës (62). Kështu në 4 meshkuj, që mjekoheshin me 1.6 gr. cimetidinë ditën pér kohë të gjatë, 3-7 muaj, u vu re një zmadhim i mamelavë, të cilat dukeshin më tepër si *mastite* sesa si *gjinekomasti*. Niveli i *testosteronit*, *hormonit luteinizues* dhe *hormonit folikulinostimulues* ishin brenda kufive normale në të gjithë rastet. Po ashtu nga 25 meshkuj me ulçer duodenal, që mjekoheshin prej 4 muajsh me cimetidinë 1,6 gr/ditën, në 5 prej tyre u shfaq gjinekomasti uni ose bilaterale, e cila u zhduk shpejt ndalimit të mjekimit. Gjatë përdorimit të cimetidinës, të gjithë tē sëmurët e kishin normal koncentrimin e *testosteronit* dhe *oestradiolit* në plazëm, po ashtu dhe atë tē prolaktinës plazmatike të përcaktuar në 2 raste (72).

Eksperimentet në qen kanë treguar se gjatë mjekimit me cimetidinë, pesha e prostatës zgogrohet, kurse në minj, rritja e prostatës dhe vezikulare seminale mbetet prapa, por kjo është reversibile (54).

Janë përshkruar edhe manifestime alergjike të lëkurës nga cimetidina, qofshin këto në formë urtikariesh (17) apo rash kutan, i shoqëruar me diare e hiperekzi ose të shoqëruara me edemë palpebrale (49).

Ndikimi mbi sistemin nervor qëndror mund tē manifestohet ndonjëherë me konfuzion mendor, që mund tē zgjatë disa ditë (40).

Kohët e fundit ka mendime se cimetidina mund tē ndryshojë proceset imunitare, pasi disa limfocite T përbajnjë receptorë H₂ pér histaminën, por kjo është e diskutueshme (40).

Pavarësisht nga këto manifestime anësore, të cilat janë të rralla e të lehta, zbulimi i antagonistëve të receptorëve H₂ histaminikë, përbën një armë të shëndoshë në luftën kundër sëmundjeve të tubit tretës, e cila kur përdoret me kujdes dhe atje ku duhet, jep rezultate shumë të mira.

Dorëzuar në Redaksi më 15 dhjetor 1979

BIBLIOGRAFIA

- 1) Adhami J. E.: Ulceri i stomakut dhe duodenit. Sëmundjet e brendshme për stomatologët. Tiranë 1979 (2).
- 2) Ash A.S.F., Schild H.O.: Receptors mediating some actions of histamine. Brit. Pharmacol. Chemother 1966, 27, 427. (4).
- 3) Attila P., Westermann E.: Effect of some imidazoline derivatives on the adenylylate cyclase activity of Guinea pig gastric mucosa in vitro. Arch. Pharmacol. 1976, 294, 12. (5).
- 4) Black J. W., Duncan W.A.M., Durant G.J., Ganellin C.R., Parson E.M.: Definition and antagonism of histamine H₂-receptors. Nature 1972, 236, 385 (13).
- 5) Bodenham G., Walan A.: Maintenance treatment of recurrent peptic ulcer by cimetidine. Lancet 1978, 1, 403. (16).
- 6) Bonfils S., Mignon M., Kloeti G.: Antagonistes des récepteurs H₂ à l'histamine et traitement médical du syndrome de Zollinger-Ellison. Semaine des hôpitaux 1978, 5-6-7-8, 309. (18).
- 7) Brimblecombe R.W., Duncan W.A.M., Durant G.J., Emmett J.C., Ganellin C.R., Parson E.M.: Cimetidine - a non-thiourea H₂-receptor antagonist. J. Int. Med. Res. 1975, 3, 86. (19).

- 8) Burland W.L., Duncan W.A.M., Hesselb T., Mills J.G., Sharpe P.C., Haggie S.J., Wyllie J.H.: Pharmacological evaluation of cimetidine, a new histamine H₂-receptor antagonist, in healthy man. Brit. J. Clin. Pharmacol. 1975, 2, 481. (21).
 - 9) Bourland W.L., Simkins, M.A.: Cimetidine. Proceedings of the Second international Symposium on histamine H₂-receptor antagonists. Excerpta, Medica, Amsterdam-Oxford 1977. (1, 6, 7, 9, 10, 14, 15, 17, 20, 22, 23, 24, 27, 33, 34, 35, 39, 41, 42, 45, 47, 50, 54, 56, 57, 58, 60, 62, 65, 69, 70, 71).
 - 10) Cano R. and Collab.: Cimetidine inhibits caffeine-Stimulated gastric acid secretion in man. Gastroenterology 1976, 70 (6), 1055. (28).
 - 11) Delchier J.C., Soule J.C., Bader J.P.: La cimétidine: I. Pharmacologie clinique et toxicité. Nouvelle Presse Médicale 1978, 7, 1735. (36).
 - 12) Druguet M., Lambert R.: La prescription de la cimétidine. Lyon Médicale 1978, 240, 18, 401. (40).
 - 13) Francavilla A., Pansini F., Panella C., Mossini F., Bertaccini G.: Effect of histamine and 5-methylhistamine on HCl and cyclic AMP output in human gastric juice. Rendic. Gastroenterol 1976, 8, 1 (43).
 - 14) Gray G.R., Smith I.S., Marckenzie I., Gillespie G.: Long term cimetidine in the management of severe duodenal ulcer dyspepsia. Gastroenterology 1978, 74, 397. (46).
 - 15) Hall W. H.: Breast changes in males on cimetidine. New England J. Med. 1976, 15, 841. (48).
 - 16) Izuka H., Adachi K., Halprin K.M., Levin V.: Histamine (H₂) receptor-adenylate cyclase system in pig skin (epidermis). Biochimica et Biophysica Acta 1976, 437, 150. (51).
 - 17) Laboratoires Smith Kline et French: Tagamet (Cimétidine). L'antagoniste des récepteurs H₂. Paris 1979. (53).
 - 18) Longstreth G.F., Go V.L.W.: Postprandial gastric, pancreatic, and biliary response to histamine H₂-receptor antagonists in active duodenal ulcer. Gastroenterology 1977, 72, 9. (55).
 - 19) Lucchelli P. E.: Cimetidina. Farmacologia e Clinica. Atti del simposio di Taormina, Milano 1978, (3,8,11,12,25,26,29,30,31,32,37,38,44,45,49,52,59,61,63,64,68,73).
 - 20) Richardson C.T.: Effect of H₂-receptor antagonists on gastric acid secretion and serum gastrin concentration. Gastroenterology 1978, 74, 366 (66).
 - 21) Rouff H.J., Sewing K. Fr.: Adenylate cyclase of the dog gastric mucosa: stimulation by histamine and inhibition by metiamide. Naunyn-Schmiedeberg's Arch. Pharmacol. 1976, 294, 207. (67).
 - 22) Spence R. W., Celestin L. R.: Gynaecomastia associated with cimetidine. Gut 1979, 20, 154. (72).
 - 23) Van Den Brink, F. G., Liem E. J.: pD₂, pA₂ and pD_{2'}- Values of a series of compounds in a histaminic and cholinergic system. Eur. J. Pharmacol 1977, 44, 251. (76).
- Shënim: Bibliografia e plotë gjendet pranë Redaksisë.

Summary

ANTAGONISTS OF THE H₂-HISTAMINIC RECEPTORS

In the first part the author speaks about the histaminic receptors H₁ and H₂, and in the second he describes the antagonists of the receptors H₂ and their action in vivo and in vitro, particularly that of Cimetidine (Tagamet).

In the third part he concentrates on the use of cimetidine in the clinic: in acute crises of duodenal ulcer, in relapses of gastric ulcers, in gastrointestinal he-

morrhages, in the Zollinger-Ellison syndrome and in the gastro-oesophageal reflux. In the fourth part he describes the side effects of cimetidine.

The author has utilized 76 sources from the literature, but for the bibliography he mentions 23 authors.

Résumé

LES ANTAGONISTES DES RÉCEPTEURS H₂- HISTAMINIQUES

Dans la première partie de cette communication l'auteur parle des récepteurs histaminiques H₁ et H₂, et dans la deuxième partie il décrit les antagonistes des récepteurs H₂ et leur action in vivo et in vitro, et en particulier de la Cimetidine (Tagamet). Alors que dans la troisième partie, il illustre l'usage de la Cimetidine dans la clinique, soit dans les crises aiguës de l'ulcère duodénal, dans les récidives de l'ulcère gastro-duodénal, dans les hémorragies gastro-intestinales, dans le syndrome de Zollinger-Ellison et dans le reflux gastro-oesophagien. Dans la quatrième partie de son étude, il décrit les effets collatéraux de la Cimetidine.

En dernier lieu il convient de relever que l'auteur a utilisé 76 sources littéraires, mais dans la bibliographie il n'en a mentionné que 23.

PERMBAJTJA

| | Faqe |
|---|------|
| Iril Pistoli: Të pasqyrojmë më thellë orientimin profilaktik të shëndetësisë sonë në punën mësimore dhe shkencore | 3 |
| Spase Trimçev: Tuberkulozi i llozhës parotide | 7 |
| Rifat Shkodra: Të sëmurët me pneumopati të epidemive gripale të shtruar gjatë viteve 1970-1976 | 15 |
| Cesk Rroku Engjëll Telegrafi: Trombembolizmi pulmonar | 25 |
| Rahim Gjika: Vdekshmëria perinatale në lindjet binjake | 35 |

HIGJIENË DHE EPIDEMIOLOGJI

| | |
|---|----|
| Minelli Papajorgji: Dinamika e florës dermatofitike të vendit tonë për periudhën 1967-1979 | 43 |
| Manho Nakuci — Paulina Gjuraj — Petrika Troja — Liri Kasa: Mikroflora e infeksioneve piogjene në lëkurë dhe ndjeshmëria e tyre ndaj antibistikëve | 55 |
| Eduart Kakarriqi — Aspasia Bifsha: Niveli i mbrojtjes ndaj fruthit në vite pas aplikimit të vaksinës së gjallë shumë të dobësuar | 63 |

STOMATOLOGJI

| | |
|--|----|
| Trëndelina Fico — Ruzhdije Qafmolla: Mjekimi ortopedik i parodontopative me protezat-shinë | 77 |
| Zhani Qirko — Dhori Pojani — Perlat Skëndo: Trajtimi i kistave folikulare në kufi ose me penetrim në sinuset maksilarë | 83 |

EKSPEIMENTALE

| | |
|--|-----|
| Spiro Mehilli — Agja Ruka: Ndryshimet patanatomike në sëmundjet akute të rrrezes në eksperiment | 91 |
| Polizoj Shqina — Mihal Prifti — Qirjako Naçi: Anestezia me tiopental për të operuarit në organe të barkut në kirurgjinë eksperimentale | 99 |
| Llazi Andrea — Misto Çoli: Të dhëna praktike dhe eksperimentale mbi përdorimin e joshëzave me fosfur-zink në luftën kundër brejtësave. | 195 |

KUMTESA

| | |
|---|-----|
| Besim Elezi, Hektor Peçi — Hodo Çela — Shahin Kadare — Manueke: Një rast me insulinomë i operuar me interes diagnostik e terapeutik | 113 |
| Dhimitër Kraja — Violeta Mosko — Athina Goroshiani: Një rast bakteriemie nga Shigella Sonnei | 121 |

PROBLEME AKTUUALE TË MJEKËSISE

| | |
|---|-----|
| Josif E. Adhami: Antagonistët e receptorëve H ₂ -histaminikë, veprimi farmakologjik dhe përdorimi klinik. | 129 |
| — Aktivitete shkencore | 143 |

SOMMAIRE

| | Page |
|--|------|
| Ciril Pistoli: Traduisons plus à fond dans notre travail éducatif et scientifique l'orientation prophylactique donnée à notre santé | 110 |
| Spase Trimgev: Tuberculose de la loge parotidienne | 112 |
| Rifat Shkodra: A propos des pneumonies provoquées par les épidémies de grippe des années 1970-1976 | 115 |
| Cesk Rroku — Engjell Telegrafi: Thrombo-embolie pulmonaire | 125 |
| Rahim Gjika: Mortalité pré-natale chez les jumeaux | 135 |

HYGIENE ET EPIDEMIOLOGIE

| | |
|---|----|
| Minella Papajorgji: La dynamique de la flore dermatophytique de notre pays dans la période 1967-1979 | 43 |
| Manthro Nakuçi — Paulina Gjuraj — Petrika Troja — Liri Kasa: La microflore des infections pyogènes de la peau et la sensibilité des organismes à l'égard des antibiotiques | 54 |
| Eduart Kakariqi — Aspasia Bifsha: Les niveaux de protection contre la rougeole relevée des années après l'introduction de l'immunisation au moyen d'un vaccin antirougeole vif très accentué | 63 |

STOMATOLOGIE

| | |
|---|----|
| Trëndelina Fico — Ruzhdije Qafmolla: Le traitement orthopédique des parodontopathies par des goutières | 77 |
| Zhani Qirko — Dhori Pojani — Perlat Skëndo: Traitement des kystes folliculaires à proximité ou à l'intérieur des sinus maxillaires | 83 |

TRAVAUX EXPERIMENTAUX

| | |
|--|-----|
| Spiro Mëhilli — Agja Ruka: Modification anatomo-pathologiques dans les maladies expérimentales de l'irradiation aiguë | 91 |
| Polizoj Shqina — Mihal Prifti — Qirjako Naçi: Interventions abdominales par l'anesthésie au Thiopental dans les chirurgie expérimentale | 99 |
| Llazi Andrea — Misto Çuli: Données pratique et expérimentales sur l'emploi des appâts au zinc-phosphite dans la lutte contre les rongeurs | 113 |

COMMUNICATIONS

| | |
|---|-----|
| Besim Elezi — Hektor Peçi — Hodo Çela — Shahin Kadare — Manueke: Un cas d'insulinoma opéré et l'intérêt qu'il présente du point de vue diagnostique et thérapeutique | 121 |
| Dhimitër Kraja — Violeta Mosko — Athina Goroshiani: Un cas de shigella sonnei bactériémia | 121 |

PROBLEMES ACTUELS DE LA MEDECINE

| | |
|--|-----|
| Josif E. Adhami: Les antagonistes de récepteurs H ₂ -histaminiques | 123 |
| — Activité scientifique dans la faculté de médecine | 141 |

CONTENTS

| | Page |
|---|------|
| Ciril Pistoli: To reflect more deeply the prophylactic orientation of our health service in our academic and research work | 3 |
| Spase Trimçev: Tuberculosis in the parotid gland | 7 |
| Rifat Shkodra: Patients with pneumopathy due to influenza during the epidemics of 1970-1976 | 15 |
| Cesk Rroku — Engjell Telegrafi: Pulmonary thromboembolism | 25 |
| Rahim Gjika: Perinatal death rate among twins | 35 |

HYGIENE AND EPIDEMIOLOGY

| | |
|--|----|
| Minella Papajorgji: Dynamics of the dermatophytic flora in Albania in the period 1967-1979 | 43 |
| Manthro Nakuçi — Paulina Gjuraj — Petrika Troja — Liri Kasa: The flora of pyogenic skin infections and the sensitivity of the organisms of antibiotics | 55 |
| Eduart Kakariqi — Aspasia Bifsha: Levels of protection against measles years after the introduction of immunization by a very attenuated live measles vaccine | 63 |

STOMATOLOGY

| | |
|---|----|
| Trëndelina Fico — Ruzhdije Qafmolla: Orthopedic treatment by prosthesis of parodontopathies | 77 |
| Zhani Qirko — Dhori Pojani — Perlat Skëndo: Treatment of follicular cysts touching or penetrating into the maxillary sinuses | 83 |

EXPERIMENTAL WORKS

| | |
|--|-----|
| Spiro Mëhilli — Agja Ruka: Pathologic changes in experimental acute radiation disease | 91 |
| Polizoj Shqina — Mihal Prifti — Qirjako Naçi: Thiopental anesthesia in operations on the abdominal organs in experimental surgery | 99 |
| Llazi Andrea — Misto Çuli: Experimtal and practical results in the use of zinc-phosphide baits,in the control of rodents | 105 |

COMMUNICATIONS

| | |
|--|-----|
| Besim Elezi — Hektor Peçi — Hodo Çela — Shahin Kadare — Manueke: An operated case of insulinoma and its diagnostic and therapeutic interest | 113 |
| Dhimitër Kraja — Violeta Mosko — Athina Goroshiani: A case of shigella Sonnei bactériémia | 121 |

CURRENT PROBLEMS IN MEDICINE

| | |
|---|-----|
| Josif E. Adhami: Antagonists of the H ₂ -histaminic receptors | 129 |
| — Scientific activities at the faculty of medicine | 143 |

AKTIVITETE SHKENCORE

Gjatë vitit të fundit, pranë Këshillit Shkencor të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës janë mbrojtur një numër disertacionesh, të cilët përbajnjë studime me vlerë teorike dhe praktike për mjekësinë tonë socialiste.

Këtu po botojmë nga një përbledhje të shkurtër të përbajtjes të disave prej tyre.

STUDIM EKSPERIMENTAL – KLINIK MBI APLIKIMIN E 10 MIKROMETODAVE NË GJAKUN KAPILAR

Më 30 janar 1979 SIRI LESKOVIKU mbrojti disertacionin me titull: «STUDIM EKSPERIMENTAL-KLINIK MBI APLIKIMIN E 10 MIKROMETODAVE NË GJAKUN KAPILAR». Problemet që trájtohen në këtë temë kanë pasur si qëllim përdorimin e mikrometodave në qdo laborator kliniko-biokimik të vendit tonë, pa qënë nevoja për pajisje dhe mjetë speciale të kushtueshme, duke përcaktuar në një sasi sa më të vogël gjaku kapilar një numër sa më të madh analizash biokimike.

Mikrometodat biokimike të paraqitura janë përshtatje dhe modifikime që u ka bërë autori metodave ekzistuese referente, që kérkojnë venoz, duke i aplikuar pér kushtet e laboratoreve tonë. Ato janë përdorur në gjakun kapilar, gjë që lejon pér t'u bërë dozimi i substancave biokimike apo metabolitëve të tyre edhe në rastet kur marrja e gjakut nga venat është e vështirë.

Në teknikat e mikrometodave, autori ka mënjanuar qëndrimin e gjakut në termostat pér të lëshuar serum, e cila kérkon një kohë rrëth një ore, kështu që aplikimi i tyre, në rastet urgjente, është me leverdi.

Përdorimi i këtyre mikrometodave do të gjejë zbatim të gjërë dhe në mjekësinë eksperimentale. Sot me metodat ekzistuese biokimike nuk mund të studjohet plotësisht metabolizmi i substancave apo ndryshimet biokimike në sëmundjet e shkaktuara në kafshët e vogla eksperimentale si lepuj, minj, kavie etj., gjë që nuk lejon të arrihen konkluzione të drejta shkencore, ndërsa me mikrometodat që paraqiten në këtë punim, një gjë e tillë është e mundshme të kryhet.

Materiali i studjuar ka të bëjë me eksperimentimin e 10 mikrometodave biokimike, që përdoren më shpesh në praktikën e përditshme kliniko-biokimike, siç janë proteinemia totale, urea në gjak, kreatininemia, glicemja, S G O T, S G P T, bilirubinemia natremia, kalemia dhe niveli i protrombinës.

RËNDËSIA E FUNKSIONIT BIOPSIK TË MËLCISË NË VLERËSIMIN E HEPATITEVE

Më 25 shkurt 1979 GOJART CERGA mbrojti disertacionin me titull «RËNDËSIA E FUNKSIONIT BIOPSIK TË MËLCISË NË VLERËSIMIN E HEPATITEVE». Studimi është bërë në bazë të një metodike të paraçaktuar për pesë vjet (1973-1977).

Për qëllimet e këtij punimi janë shfrytëzuar materialet e marrura për punksion biopsi nga mëlcia dhe të sjella në shërbimin e anatomisë patologjike të spitaleve, nga klinika e dyte e sëmundjeve të brendshme (spitali nr. 1), nga klinika e spitalit nr. 3, 4, nga Instituti i kërkimeve shkencore ushtarake dhe nga spitali i rrethit të Sarandës.

Në një kapitull të veçantë, në këtë studim jepen disa të dhëna të përgjithshme mbi historikun e punksion biopsisë në botë dhe në vendin tonë, mbi reaksionet dhe ndërlirimet që mund të hasen gjatë kësaj procedure, mbi përdorimin e punksionit biopsik të mëlcisë në klinikë si dhe mbi mënyrën e interpretimit të punksionit biopsik të mëlcisë.

Vendin kryesor në këtë punim e zenë kapitujt mbi hepatitin viral dhe hepatitin kronik. Në material interpretohen të dhënat personale, duke i krahasuar ato me shumë autorë të tjera, prej 226 burimesh. Materiali paraqitet i ilustruar gjérësisht me pasqyra e grafike si dhe me mjaft mikrofotografi të një cilësie të mirë.

EPILEPSITË NË KLINIKËN E NEUROLOGJISË DHE NË RRETHIN E TIRANËS (Studim Klinik, elektrik dhe depistues)

Më 27 shkurt 1979 ALI KUQO mbrojti disertacionin me titull «EPILEPSITË NË KLINIKËN E NEUROLOGJISË DHE NË RRETHIN E TIRANËS» (studim klinik, elektrik dhe depistues).

Në bazë të një metodike shkencore, autori analizon 570 të sëmurë, të shruar në klinikën e neurologjisë me epilepsi qyshe nga viti 1955 deri më 1977. Këta 570 të sëmurë autori i analizon sipas viteve, seksit, profesionit, formave klinike, etiologjike etj. Ai pëershruan mjaft veçori që ka ndeshur gjatë përvojës së tij lidhur me klinikën dhe që i ilustron me shëmbuj konkretë.

Në një kapitull më vete, autori analizon 1000 raste studimi klinik-elektrik, të ndjekur në qendrën të dispanserizmit të epilepsive pranë spitalit. Edhe këto raste analizon disa veçori, që dallojnë nga rregulli i përgjithshëm. Këto të dhëna janë mjaft të vlefshme për mjekun praktik të përgjithshëm dhe, në mënyrë të veçantë për specialistët neurologë. Po në këtë kapitull analizohen me imtësi 100 raste të zgjedhur e të plotësuar më mirë me të dhënat paraklinike.

Në disertacion vlerësohen drejt ekzaminimet paraklinike si elektro-encefalografia, pneumoencefalografia, arteriografia, arteriografija, gamaencefalografia etj.

Një kapitull i veçantë i kushtohet mjekimit të epilepsive, ku autori jep përvojën e tij me të dhëna statistikore dhe rekomandime për mjekimin e drejtë të epilepsive. Autori jep të dhënat e depistimit të epilepsive në 26.010 banorë të rrethit të Tiranës, ku rezulton një përqindje relativisht e ulët e epilepsive në krahasim me vendet e tjera

jepen të dhëna për parandalimin dhe riaftësimin e këtyre të sëmurëve. Për ndjekjen e epileptikëve, autori propozon një skemë konkrete për punonjësit që duhet të aktivizohen në këtë depistim.

Për përpunimin e disertacionit, autori ka shfrytëzuar 174 burime.

PNEUMONITË FETO-NEONATALE

Më 29 mars 1979 Shyqyri Subashi mbrojti disertacionin me titull «PNEUMONITË FETO-NEONATALE». Disertacioni shtjellohet në pesë kapituj. I gjithë studimi është mbështetur në nekropsitë e fëmijëve të lindur vdekur dhe të të porsalindurve të bëra në shërbimin e Anatomisë Patologjike të Tiranës për periudhën 1975-1977, dhe metodikën e punës. Autori diskuton rezultatet dhe shpeshtësinë e pneumonive fetoneonatale dhe vartësinë e saj nga prematuriteti, seksi, mosha e fëmijës dhe disa rrethana epidemiologjike, duke këmbëngulur për epideminë e gripit të vitit 1976, të shkaktuar nga virusi A/Port Chalmers.

Autori trajton tiparet e përgjithshme morfollogjike të pneumonive fetoneonatale dhe kriteret kryesore diagnostike. Ai jep format makroskopike të këtyre pneumonive. Në një kapitull të veçantë autori jep format e pneumonive fetoneonatale, duke i ndarë në parimin morfollogjik të gërshetuar me atë patogenetik, ku del se forma më e shpeshtë është ajo aspirative, kurse forma septike është mjaft e rrallë. Në fund autori diskuton kombinimin e pneumonive fetoneonatale me sëmundjet e tjera të kësaj moshe dhe shenjat kryesore të këtyre pneumonive. Në punimin e këtij disertacioni autori ka shfrytëzuar 196 burime dhe e ka ilustruar me shumë diapositive dhe grafike të ndryshëm.

SIALOLITIAZA

Më 29 mars 1979 SAMEDIN GJINI mbrojti disertacionin me titull: «SIALOLITIAZA» (sëmundje e gurëve të gjendrave e kanaleve të pësh-tymës).

Në bazë të analizave spektrokomike dhe kimike që ka bërë autori del se në shfaqjen e kësaj sëmundje nuk luajnë rol faktorë të tillë të marrë veçmas si klima, uji, mënyra e të ushqyerit etj.

Autori pëershruan veçoritë klinike të sëmundjes në vartësi të lokalizimit të gurit, gjë që ka rëndësi për vendosjen e diagnozës klinike.

Klasifikimi i propozuar nga autori për këtë sëmundje është original dhe i lehtë për tu përdorur në praktikën e përditshme nga ana e mjekëve.

Në këtë punim, autori i ka dhënë rëndësi diagnozës diferencale, duke pëershruar se me cilat sëmundje mund të gabohet më shpesh kjo nosologji, pasi gabimet diagnostike ende qëndrojnë në shifra të larta. Sipas studimit del se vetëm në rreth 25% të rasteve vihet diagnoza e përpiktë në vizitën e parë tek mjeku.

Autori ka pëershruar më mirë metodikën e ekzaminimit të gjendrave për vendosjen e një diagnoze të herëshme dhe të përpiktë.

Një kontribut të mirë autori ka dhënë dhe në përcaktimin e atyre metodave të mjekimit, që janë më rezultative, duke rekomanduar ato metoda kirurgjikale, që janë më të efektshme. Njëkohësisht autori për

herë të parë ka pëershkruar metodën e ekstirpimit kirurgjikal të gurit nga gjendra në rrugë intraorale, duke përcaktuar dhe indikacionet për një ndërhyrje të tillë.

Ky punim është një material i vlefshëm për mjekun stomatolog dhe mjekët e profileve të tjera si otojatër, kirurgë, infekzionistë, pediatër etj., pasi i ndihmon pér t'u njojur me këtë sémundje të shpeshtë të gjëndrave të kanaleve të pështymës dhe i orienton ata në praktikë pér vendosjen e diagnozës së herëshme dhe të përpiktë pér të parandluar ndërlifikimet e mundshme që vijnë prej saj dhe trajtimet e għabuara.

TETANOSI, ASPEKTE EPIDEMIOLOGJIKE, IMUNOLOGJIKE DHE PROFILAKTIKE

Më 6 shtator 1979 JOLANDA KOÇI mbrojti disertacionin me titull «TETANOSI, ASPEKTE IMUNOLOGJIKE DHE PROFILAKTIKE». Në këtë disertacion trajtohen aspektet imunologjike të tetanosit në vendin tonë. Është diskutuar teorikisht dhe me të dhëna të shumta profilaktike e tetanosit, duke e paraqitur atë si një problem shoqëror, që mund të zgjidhet me anë të vaksinimit në masë dhe jo me anën e mjeteve të profilaksisë individuale.

Duke analizuar me hollësi biopreparatet antitetanike që prodhohen në vendin tonë, si anatoksina tetanike e lëngët, anatoksina tetanike e purifikuar e absorbuar, bivaksina diftero-tetanike, bivaksina tifo-tetanos dhe trivaksina diftero-tetano-pertusike, në punim vihen në dukje një-kohësisht cilësitetë e tyre përsa i përket padëmshmërisë dhe efektit imunogjen.

Vlera e këtyre biopreparateve është studjuar si në laborator ashtu dhe në terren (në kontigjente të ndryshme njerëzish si fëmijë, punëtorë bujqësie, ushtarë, gra shtatzëna etj.), duke vlerësuar skemat e imünizimit me këto preparate në kushtet tonë dhe duke vënë në dukje rëndësinë e respektimit rigoroz të tyre, në mënyrë që të arrihet realizimi me sukses i vëksinimit aktiv të të gjithë populsisë.

Në fund autorja ve në dukje se me anën e një organizimi të mirë dhe zbatimi praktik të vaksinimit antitetanik në masë, ka mundësi të arrihet ulja e sémundshmërisë së tetanosit brenda një kohe të shkurtër deri në zhdukjen e tij në një të ardhme jo të largët.

NDIKIMI I UJIT MINERAL TË LESKOVIKUT DHE DISA NXITESVE NATYRALE NË VEPRIMTARINË SEKRETORE TË STOMAKUT DHE ULCERAT EKSPERIMENTALE

Më 18 tetor 1979 SEZAI BRAHO mbrojti disertacionin me titull: «NDIKIMI I UJIT MINERAL TË LESKOVIKUT DHE DISA NXITËSVE NATYRALE NË VEPRIMTARINË SEKRETORE TË STOMAKUT DHE ULÇERAT EKSPERIMENTALE» (i dyti i këtij lloji në vendin tonë). Autori ka studjuar ndikimin e ujit mineral të Leskovikut mbi veprimtarinë e stomakut për të përcaktuar indikacionet dhe kundërindikacionet e nërdorimit të tij në sëmundjet e stomakut.

Materiali është paraqitur në 6 kapituj, të ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë flitet për të dhëna të përgjithshme për ujrat minerale (farmakologjia, fiziologjia dhe vjetitë e tyre fiziko-kimike), interpretimi i përbërjes fiziko-kimike të ujit mineral të Leskovikut si edhe mekanizmat e veprimit farmakologjik të ujrave minerale mbi aparatin tretës.

Në pjesën e dytë flitet mbi veprimitarinë fiziologjike të stomakut, roli i nxitësve natyralë (gastrinës, histaminës dhe acetilkolinës) në sekretimin gastrik si edhe mekanizmat e përgjithshme të frenimit.

Autori përkruan rezultatet e eksperimenteve mbi sasinë e lëngut të stomakut, vlerat e aciditetit, pepsinës dhe përbërësve organikë dhe joorganikë si dhe rezultatet e mjekimit profilaktik të ulcerave eksperimentale.

Në fund, autori arrin në përfundimin se uji mineral i Leskovikut éshtë një ujë termal, sulfuror i dobët, kloruror, hidrokarbonat, sulfat, natrik, magnezian, ferror, hipoton. Ai vepron mbi stomakun, duke ulur sasinë e lëngut gastrik acidin klorhidrik të lirë e total dhe pepsinën. Ky ujë rrit nivelin e përqëndrimit të natriumit dhe kalciumit dhe ul nivelin e kaliumit rrit nvelin e polisaharideve dhe ul nivelin e proteinave.

Duke u bazuar në këto shenja eksperimentale, autori rekomandon përdorimin e këtij uji mineral në mjekimin e ulqerave të stomakut e duodenit, mjekimit të gastriteve hiperacide dhe gjendjeve të tjera që shodërohen me hiperaciditet.

PROCESET INFLAMATORE AKUTE ODONTOGJENE NE REGJIO- NIN E GOJES, NOFULLAVE E FYTYRES

Më 10 nëntor 1979, ISUF KASAPI mbrojti disertacionin me titull: «PROCESET IFLAMATORE AKUTE ODONTOGJENE NË REGJIONIN E GOJËS, NOFULLAVE E FYTYRËS». Këtë punim autor i ka bazuar në përvojën e fituar në praktikën e tij ambulatore dhe të shtruarit në spital në periudhën 1971-1976.

Autori jep metodën e mjekimit dhe masat parandaluese, që kanë një vlerë të madhe teorike dhe praktike jo vetëm për mjekun stomatolog, por edhe për një burim konsultimi edhe për mjekun e përgjithshëm. Në këtë studim, një vend të rëndësishëm u kushtohet formave klinike të proceseve inflamatore sipas lokalizimit anatomotopografik, i veçorive klinikë të proceseve inflamatore akute odontogjene në raport me përdorimin e antibiotikëve si edhe i profilaksinë dhe mjekimit të proceseve inflamatore akute odontogjene.

Sipas autorit, proceset inflamatore akute odontogjene zenë 6.7% e të gjithë vizituarve dhe 34.1% e të gjithë të operuarve në shërbimin e kirurgjisë stomatologjike ambulatorore, për të cilat ishin dhënë 51.7% e të gjithë raporteve tâ pushimit. Në shumicën e rasteve, proceset inflamatore akute odontogjene, si më rastet ambulatorore, dhe të shtruar ishin në moshë të re. Abceset e flegmonet odontogjene në indet e buta dhe hapësirat përrreth nöfullave të shtruar kryesisht në spital përbën 82.6%, ndërsa me osteomielite të nöfullave 17.7% të rasteve.

Nga të dhënat e të sëmurëve, sipas autorit, proceset inflamatore akute odontogjene, duke përbërë urgjenca kirurgjikale, metoda kryesore e mjekimit të tyre ka qënë ajo kirurgjikale me incision ose heqje të dhëmbit shkaktar, që në të sëmurët ambulatorë u krye në 75.6% të tyre, ndërsa në ata të shtruar në spital në 90.4% të të sëmurëve.

PËRGATITJA E PLASTMASAVE ELASTIKE DHE PËRDORIMI I TYRE NË STOMATOLOGJI

Më 21 nëntor 1979 FOTO TOTI mbrojti disertacionin me titull: «PËRGATITJA E PLASTMASAVE ELASTIKE DHE PËRDORIMI I TYRE NË STOMATOLOGJI». Ky punim është një studim eksperimentalo-klinik. Në të bëhet fjalë për plastmasat në përgjithësi, që përdoren në stomatologji si dhe për plastmasat elastike në veçanti. Autori bën fjalë për përgatitjen në vend me forcat tona të plastmasave elastike, që përdoren në stomatologji: të plastmasës elastike, që përdoret në endoprotezat e ndryshme dhe të asaj që përdoret në ektoprotezat ose epitezat e fytyrës. Autori përshkruan lëndët bazë, raportet midis tyre dhe teknologjinë e përgatitjes së këtyre plastmasave në kushtet e përgatitjes së përditshme stomatologjike.

Në pjesën klinike, autorri trajton mundësinë e përdorimit praktik të këtyre materialeve dhe rezultatet e arritura. Pjesa klinike e këtij punimi, ku verifikohen dhe cilësitë biokimike të këtyre materialeve bazohet në 83 proteza të vendosura në të sëmurë të ndryshëm, nga të cilët 62 endoprotezë dhe 21 epiteza të fytyrës. Po në këtë pjesë, autorri përshkruan teknikën që ka përdorur për përgatitjen e çdo lloj proteze si dhe kohën që nevojitet për çdo etapë pune për përgatitjen e tyre.

Për këtë punim, autorri ka përdorur 102 burime bibliografike. Gjithashtu autorri ka bashkëpunuar me kolegët e katedrës së ortopedisë stomatologjike të fakultetit të mjekësisë, me punonjësit e ndërmarrjes gomë-plastikës. Durrës e të plastmasës në Lushnjë e të sektorëve të tjerrë. Ky punim shërben si një shëmbollë kuptimplotë, që tregon përmbështjeten e gjithanshëm në forcat tona dhe bazën e shkëlqyer materiale të krijuar nga Partia dhe Pushteti Popullor, duke hapur horizonte të reja përkërkime të mëtejshme e më të thelluara në degën e stomatologjisë.

SËMUNDJA HIPERTONIKE

Më 25 nëntor 1979, PIRRO BURNAZI mbrojti disertacionin me titull: «SËMUNDJA HIPERTONIKE». Në të autorri trajton problemin e mjekimit me rezerpinë, rezultatet klinike dhe ndikimi në gjak mbi metabolizmin e lipideve, proteinave e lipoproteinave; rezultatet e largëta të mjekimit antihipertensiv mbi ecurinë e sëmundjes.

Në fillim autorri përshkruan rezultatet klinike të aftësise vepruese antihipertensive të rezerpinës në 300 të sëmurë me hipertension arterial esencial, të stadeve të ndryshme të sëmundjes (133 të statit të parë, 185 të statit të dyte dhe 84 të statit të tretë). Sipas

të dhënavë të autorit, mjekimi me rezerpinë arrin të ulë T.A (të dy) në stadin e parë deri në normë në 100% të rasteve dhe në të tretin vetëm në 35% të rasteve u arrit një ulje e lehtë e shifrave të tensionit arterial.

Duke u bazuuar në këto, autorri mendon se aftësia vepruese antihipertensive e medikamentit pakësor me zhvillimin e sëmundjes.

Autori ka studjuar 30 raste me kriza tipike të stenokardisë (para mjekimit) dhe pas mjekimit arrin në përfundimin se krizat e stenokardisë në këta të sëmurë nuk keqësohen nga mjekimi me rezerpinë, vetëm në raste të rralla dhe kjo ndodh sidomos në të sëmurët e moshuar; atëherë kur terapi me rezerpinë çon në ulje të shpejtë të shifrave të tensionit arterial (sikurse mund të ndodhë edhe me barnat e tjera antihipertensive). Pra kjo terapi nuk duhet të ndikohet në këta të sëmurë.

Në një kapitull tjetër, autorri analizon ndryshimet biokimike në gjak të lipideve, proteinave dhe lipoproteinave pasi mjekimi me rezerpinë.

Në kapitullin e fundit autorri trajton rezultatet e largëta të mjekimit antihipertensiv mbi ecurinë e sëmundjes hipertonike. Për këtë autorri ka bërë një studim të gjatë (nga viti 1958 deri më 1977), duke ndjekur e mjekuar 120 të sëmurë me tension arterial nga 95 deri 135 mmHg pa ndërlimje organike, të shtruar në spital. Nga këta, 60 të sëmurë janë mjekuar në rregull me barna të ndryshme antihipertensive dhe 60 të tjerë, duke mos u mjekuar praktikisht i kanë shërbyer për grup kontrolli.

Nga këto, autorri arrin në konkluzionin se sa më shpejt që të fillohen mjekimi antihipertensiv i rregulltë aq më të pakta janë ndërlirimet organike që shkaktojnë hipertensioni arterial.

Ky studim tregon gjithashtu rëndësinë e madhe praktike që ka ndjekja e një mjekimi të rregulltë antihipertensiv.

Në punimin e tij, autorri shftillon kriteret e mjekimit antihipertensiv në ditët tona, faktorët e mundshëm etiologjikë të sëmundjes dhe patogjenezën e saj sipas të dhënavë të viteve të fundit.

NDIKIMI I BIMËS TORILIS NODOSA NË VEPRIMTARINË E ZEMRËS, TË ENËVE TË GJAKUT DHE TË DISA PËRBËRËSVE TË GJAKUT

Më 20 dhjetor 1979 VASIL MICI mbrojti disertacionin me titull: «NDIKIMI I BIMËS TORILIS NODOSA NË VEPRIMTARINË E ZEMRËS, TË ENËVE TË GJAKUT DHE TË DISA PËRBËRËSVE TË GJAKUT». Bima *Torilis Nodosa* përdoret nga mjekësia popullore shqiptare përmjekimin e Verruke vulargjis, me rezultate të mira, duke e marrë nga goja.

Autorri ka kryer 1217 eksperimente në kafshët e laboratorit; në 200 bretkoca, në 82 minj, në 115 lepuj dhe në 5 mace. Nga këto eksperimente u vërtetua se kjo bimë shfaq: 1) efekt kronotrop negativ (ul rritmin e zemrës); 2) efekt sistolik (rrit forcën tkurrës të miokardit). Efekti

sistolik kundërshtohet nga jonet e potassiumit dhe forcohet nga jonet e kalciumit; 3) Dekokti i bimës së Torilisit tregon efekt hipotensiv (ul presionin e gjakut).

Efekti hipotensiv i marrë nga sasia 0,12 gr. për kg. peshë të Torilisit është i njëjtë me atë që merret nga 2 mgr për kg. peshë të klorhidratit të papaverinës.

4) Torilis nodosa jo vetëm që nuk dëmon elementet qelizorë të gjakut dhe proteinat e plazmës së gjakut, por, përkundrazi, shtron forcat imunobiologjike të organizmit.

5) Bima Torilis nodosa ka efekt helmues të vogël, sepse doza më e vogël ngordhëse (DL 50) për minjëtë e bardhë është 36.75 gr. për kg. peshë e dhënë me rrugë intraperitoneale dhe për lepujt është 2,8 gr për kg. peshë e dhënë me rrugë venoze.

Sipas autorit, doza mjekuese mesatare është 0,4 gr. për kg. peshë e dhënë me rrugë venoze. Kjo bimë ka një gjëresi të mirë mjekuese (1:5) dhe treguesi mjekues është 1:6.

Të bazuar në këto rezultate, autorri rekomandon të shihet mundësia e përdorimit të saj për qëllime mjekuese.

DËMTIMET AKSIDENTALE TË SYVE

Më 8 janar 1980 GJERGJI CEPA mbrojti disertacionin me titull: «DËMTIMET AKSIDENTALE TË SYVE». Në disertacioni përfshihet një studim kliniko-statistikor 10 vjeçar i traumave të syve, të mjekuar në klinikën okulistike të spitalit nr. 1 Tiranë.

Në pjesën e parë autorri shtjellon anatominë e syrit, pastaj kalohet në përshkrimin e traumave të syve dhe adneksive të tyre si në kohë paqe dhe në kohë lufte.

Në një kapitull tjetër, autorri bën studimin kliniko-statistikor për dhjetëvjeçarin 1965-1975, ku analizohen aksidentet e ndodhura në 1624 të sëmurë. Të sëmurët analizohen të grupuar për 807 perforacione, 628 goditje dhe 230 djegje të syve.

Sipas materialit të autorit, perforacionet e syve kapin 6.7% të shtrimeve, duke prekur në 80% të rasteve meshkujt. Autorri i gjen të dy shtë njëloj të dëmtuar. Nga analiza e rasteve del se në 45.2% të aksidenteve takohen tek fëmijët. Në moshën 21-30 vjeç, autorri ka takuar 17.2% të perforacioneve. Në dhjetëvjeçarët mbi 40 vjeç, numri i perforacioneve pakësohet së tepërm, duke prekur vetëm 5% të rasteve, gjë që autorri e lidh me përvojën në punë dhe rëndësishë së madhe që i jepet përdorimit të mjeteve mbrojtëse. Në 30% të rasteve, perforacionet autorri i ka takuar në punëtorët dhe vetëm në 15% në fshatarët. Autorri vë re së dëmtimet e syve takohen 4 herë më tepër në punëtorët se në fshatarët. Pas mjekimit, 70% të aksidentuarve kanë rifiutuar një pamje midis 0,6 dhe 1,0.

Në një kapitull më vete, autorri rekomandon mjekimin kirurgjikal të plagosjeve të syve, duke i kushtuar vëmëndje të veçantë përcaktimit dhe largimit të trupave të huaj nga syri. Ai përmënd plastikën orbitale Csapody, të cilën autorri e ka kryer për herë të parë në vëndin tonë, pas prodhimit të veglave përkatëse.

Punimi përmban mbi 110 fotografi, skica e grafikë, kryesisht origjinale. Gjithashtu autorri për herë të parë paraqit angjiografi me fluoreseinë të fundit të syrit në trauma të tij. Për këtë punim, autorri ka shfrytëzuar 140 burime.

SESION SHKENCOR I KATEDRËS SË BIOKIMI – FIZIOLOGJI – FARMAKOLOGJI

Më 22 mars 1980 zhvilloi punimet sesioni shkencor i katedrës së Biokimi-Fiziologji-Farmakologjisë, në kuadrin e jubileut të 35 vjetorit të Clirimit të Atdheut dhe të fitores së Revolucionit Popullor e të 100 vjetorit të lindjes së J.V. Stalinit si dhe të fushatës për zgjedhjet e 20 prillit.

Pas fjalës së hapjes nga shefja e katedrës A. Muçko, filloi referimi i temave.

Të gjitha punimet ishin punë kolektive të pedagogëve dhe laborantëve të katedrës.

Tema e parë me karakter ideologjik: «J. V. Stalin për shëndetin e popullit» nga Gj. Minga dhe Z. Zhegu. Në të paraqitej gjendja shëndetësore e masave punonjëse të proletarjatit në burgun e popujve të Rusisë cariste, si dhe theksi se kjo gjendje nuk mund të përmirësohej me asnjë reformë gjysmake, por vetëm me revolucionin proletar, ashtu siç e vërtetoi dhe koha. Në referat vihej në dukje preokupimi dhe kujdesi i J. V. Stalinit për shëndetin e punonjësve dhe për zhvillimin e shkencës mjekësore mbi baza të shëndosha materialiste dialektike, pas fitores së Revolucionit të Tetorit e deri në vdekjen e tij.

Tema «Të dhëna paraprake mbi ndikimin e ujit mineral të Bënjes në veprimin sekretor të stomakut» paraqitur nga A. Muçko fliste mbi të dhënat e para eksperimentale të kryera në qen me ujin mineral të Bënjes-Përmet, bazuar në një sërë analizash biokimike e klinike, të kryera me lëngun gastrik.

Me temën me titull «Studimi eksperimental i ujit mineral të Glinës në diurezë» u paraqitën gjithashtu të dhënat e fituara nga eksperimentet në kafshët e laboratorit.

Eksperimentet e kryera nga F. Mandro kishin për qëllim studimin e ndikimit mbi diurezën e ujit mineral Gлина – 2, burim i të cilit u shfaq pas tërmetit të dhjetorit 1976.

Në punimin e kryer nga D. Hasa, S. Leskoviku dhe V. Vreto jepejshin të dhëna paraprake «Mbi vlerat normale të trigliceridemisë e kolesterolinemisë tek dhuruesit e gjakut».

Në referatin e tij, R. Bregu foli mbi temën «Ndikimi i ujit mineral të Glinës në sekrecionin biliar», ku tregoi mbi rezultatet e punës eksperimentale të kryera në qen. Më pas u referua tema e K. Kallfës dhe Gj. Mingës me titull «Të dhëna paraprake mbi nivelin e kolesterolemisë së përgjithshme dhe raporteve të saj me moshën e grupet e gjakut tek njerëzit e shëndoshë.

Kolektivi i lëndës së biokimisë, duke ndier si detyrë morale të vetën mbledhjen dhe përpunimin të filluar së bashku me Dr. K. Kallfa, të cilin vdekja e ndau para kohe nga gjiri i shokëve, shpreh kështu vetëm një pjesë të vogël të respektit, që ky kolektiv ruan për Dr. Kozma Kallfën.

Sesionin e mbylli G. Boçari, i cili referoi dy temat: «Metodikat e shkaktimit të hiperlipemisë akute» dhe «Ndikimi i disa bimëve në procesin e koagulimit të gjakut dhe në lipidogramë». Në temën e dytë, G. Boçari sillte të dhëna paraprake, por mjaft interesante, mbi ndikimin e disa bimëve në tregues të ndryshëm të lipidogramës e koagulimit të kryera tek shpendët.

Punimet e sesionit shkencor u ndoqën me vëmëndje nga ana e pjesë-marrësve. Atje u bënë pyetje dhe diskutime të shumta për temat e referuara.

Ky sesion do të shërbejë si stimul për kolektivin e katedrës së biokimi-fiziologji-farmakologjinë, që në të ardhmen të organizohen sesione shkencore me një numër e larmi temash më të madh, për probleme që preokupojnë lëndët e veçanta dhe mjekësinë tonë.